

FARUK BEGOLLI

Ikonë e një kohe dhe e brezave të tërë

Aq i ri e aq i popullarizuar, në kohën kur Faruk Begolli kishte arritur në Beograd (viteve të gjashtëdhjeta) të provonte fatin e studentit të Akademisë, për t'u bërë artist, në atë mes ku bashkëvendësi i tij, Bekimi (Bekim Fehmiu) kishte bërë emër mbi dërrasa teatri. Bekimin e kishte inspirim, por me ndrojtje përballë tij meqë, reputacioni i Bekim Fehmiu, sikur ia ndërpriste hapat t'i afrohej, apo ndoshta i frikësohej takimit me të se mund të rrëronte adhurimin që e mbante...

Nga Ibrahim Kadriu



Zija Çela fitues i Çmimit "At' Zef Pllumi"

(fq. 11)

SHËNIME MBI LIBRAT

Arti i Naimit (Përgatiti: Mehmet Gëzhilli. Përkujdesja shkencore: Akad. Gjovalin Shkurtaj, Enciklopedia naimiane II, Akademia e Shkencave e Shqipërisë

Kryetema e sintezave shkencore për veprën e Naim Frashërit Nga Myrvete & Begzad Balii

(fq. 4)

Rafael Floqi "Noli dhe Konica nën dritën e 'Diellit'"

Një kontribut i vyer historik por për mbarë mërgatën shqiptare në SHBA

Nga Sokol Paja

Editor i gazetës "Dielli"

(fq. 8)

Dr. Ernest Nasto, NGA "QYTETI MBI KODËR" TEK
"AMERICA FIRST", Onufri 2026

Kujtime dhe jetë në një narracion të mirëfilltë letrar

Nga Skerdilajd Zaimi

(fq. 9)

Parathënia e vëllimit poetik
"Ëndërr e falur" të Resul Shabanit

Kush mund të falë një ëndërr?

Nga Visar Zhiti

(fq. 10)

Shënime për librin "Monologu i fustanit" të Luljeta Gërmenjit

Kujtime dhe jetë në një narracion të mirëfilltë letrar

Nga Katjusha Pogaçi

(fq. 11)

Raporti i njeriut me kohën dhe kujtimin në tregimin e Pashkut dhe krahasimi me Migjenin

Nga Noel Boci

(fq. 17)



Përtej kufijve, brenda shpirtit: veprat e artisteve shqiptare nga Mali i Zi

Nga Gjovana Dediq

Arti nuk krijohet në izolim, as në kufizim. Arti krijohet në hapësirat që takohen dhe krijojnë. Ajo gjindet në universin e individit dhe kolektivit, midis përvojës personale dhe kujtesës shoqërore, midis atij vendi që i përkasim dhe atyre vendeve që i imagjinojmë. Kur flasim për praktikën artistike të femrave, ajo hapësirë takimi fiton një identitet më të përfilltë. Përmes veprave artistike të femrave, hapen dimensionet e kujtesës, identitetit dhe pranisë në strukturat shoqërore dhe kulturore që shpesh i marginalizojnë ato.

(fq. 6)

Fjalë për originalitetin Nga Vangjush Saro

(fq. 12)

ANDREJ KURKOV

Turneu i Xhimi Hendriksit në Lviv

Fragment nga romani



(fq. 22)

BIBLIOTEKË

Stephen King

(fq. 13)

Hapi i pestë

Përktheu: Qerim Raqi

Flurans Ilia

(fq. 14)

Rekuem

Konstandin Dharmo

(fq. 18)

*Drejtperdrejt nga
pallati presidencial*

Taip Sulko

(fq. 20)

Shpirtëra të arratisur

Arben Meksi

(fq. 21)

Karikatura e së shtunës

Botim i ri nga Dituria. Përktheu: Agim Doksani

Vjen në shqip romani "Mrekullia e
madhe", shkruar nga Viola Ardone

Nga Ana Sheldia

(fq. 16)

Libri shqip në Amerikë

Dërgesa të shpejta
dhe të sigurta
me një klik

www.albibris.al



Aq i ri e aq i popullarizuar, në kohën kur Faruk Begolli kishte arritur në Beograd (viteve të gjashtëdhjeta) të provonte fatin e studentit të Akademisë, për t'u bërë artist, në atë mes ku bashkëvendësi i tij, Bekimi (Bekim Fehmiu) kishte bërë emër mbi dërrasa teatri. Bekimin e kishte inspirim, por me ndrojtje përballë tij meqë, reputacioni i Bekim Fehmiu, sikur ia ndërpriste hapat t'i afrohej, apo ndoshta i frikësohej takimit me të se mund të rrënonte adhurimin që e mbante, se, kush e di, mund të përballlej me ndonjë sjellje megalomanie të Bekimit dhe atë megalomani e llogariste si reaksion të famës së tij. Kështu i çmonte rrethanat në të cilat u gjend në atë mes ku i flisnin për Bekimin, si për artistin e madh, ndërkaq Faruk Begollit i pëlqente ta kishte model të udhëtimit të tij të mëtutjeshëm në profesionin e aktrimit. Me këso rezonimi, duke u mbështetur në propozimin e kushëririt Istref Begolli dhe të Ekrem Kryeziut, ishte lajmëruar në konkurs, duke u gjendur në mesin e pesëqind kandidatëve që e dëshironin profesionin e aktrimit në Akademinë e Arteve në Beograd. Para se të regjistrohej në Akademi kishte nisur studimet në dy fakultete tjera, pa ndonjë vullnet, në xehetari dhe në Fakultetin Ekonomik. Konkuron në Akademi. Nga ai numër aq i madh kandidatësh Faruku gjendet në mesin e dymbëdhjetëve më të mirëve, pranohet. Derisa ende ishte duke u marrë me shënime mbi literaturën më të përshtatshme, si paraprijëse për t'u ngarkuar teorikisht për profesionin e artistit, i ndodh përkëdhelja e parë, ajo e regjisorit të njohur Velko Bullajiq i cili, kur e sheh korridoreve të Akademisë bukuroshin nga Kosova, me lëvizje pak a shumë çapkëne, e thërret. E pyet prej nga kishte ardhur, përse kishte zgjedhur pikërisht këtë degë studimi dhe, mandej, i ofron të bënte një provë me të, për t'ia njohur afinitetet e aktrimit dhe..., siç thuhet, i qesh fati me të papriturën, me atë propozim konkret për të cilin moshatarët e tij as do mundnin të ëndërronin, e lëre më t'u sigurohej skena e lojës në film. Prova ishte aq bindëse, pa i lënë kurrfarë dileme ekipit i cili ishte zotuar t'i gjente fytyrat më të përshtatshme për projektin e filmit që, për temë, kishte ditët e luftës...

Faruk Begolli brenda vitit 1966 luan në filmat "Shikimi kah bebëzat e diellit" dhe në "Ëndrra". Ishte prova e parë e një studenti i cili, më tutje, do të kërkohej shumë si aktor; menjëherë në vitin në vijim (1967) do ta shohim te filmi "Mëngjesi" të Purisha Gjorgjeviqit. Në të njëjtin vit Bekimi, me karrierën e tij të shkëlqyeshme, interpreton rolin kryesor të "Mbledhësit e puplave" të Petroviqit, rol i cili ia hapi dyert drejt kinematografisë botërore... Tashmë arrijnë të bëhen më të kërkuarit, duke u mburr njëri me tjetrin. Në botën e artit, në raste, mosdurimet janë pjesë e natyrës që kushtëzohet nga reflekset e xhelozisë, për shembull. Te këta dy aktor, më vonë iu bashkohet edhe Enver Petrovci, triumfon ndjenja e të qenit shqiptar, andaj gëzimet i kanë të përbashkëta për çdo sukses; për sukseset e njëri- tjetrit ngrënë dollitë.

Faruk Begolli shfaqej me një biografi të çuditshme, me atë biografi të ditëve të para të jetës kur, komunistët e ardhur në pushtet me inercionin e shtypjes dhe shkatërrimit të çdo familjeje që kishte një pedigree bejlerësh... Ia ndërrojnë adresën e banimit. Në të vërtetë fillimisht ia vrasin babën, Sefedin Beun, në kohën kur Faruku ishte veç gjashtë muaj. Nëna e tij, me katër


FARUK BEGOLLI

Ikonë e një kohe dhe e brezave të tërë

Nga Ibrahim Kadriu

fëmijë, detyrohet të shkojë dhe të jetojë në katundin Baran deri në vitin 1952. Strehimi në ambientin e katundit ishte në kushte jashtëzakonisht të vështira... Faruku, prandaj, u rrit si munda, u shkollua si diti, mandej u nis rrugëve në hulumtim të njohurive akademike, duke qenë i dhuruar me talent dhe bukuri, që të dyja të vlefshme për artin e aktrimit.

Ai shfrytëzoi vlerën e talentit dhe me një vrap maratonisti e shohim tek shëtitë nga një film në tjetrin, shpesh duke mos pasur mundësi kohore për t'i pranuar të gjitha ofertat. Pas afirmimit me shpejtësi marramendëse, nuk bëhet fjalë vetëm për një realizim, brenda vitit, si normë konstante e aktorëve, duke çmuar të suksesshëm vetëm një film brenda vitit... Faruku vetëm gjatë vitit 1970 numëron pesë filma: "Dashuria e parë", "E dashura Irene", "Rekuijem", "Shprehite tona", "Muri i luleve", e kështu me radhë, për çdo vit me realizime të reja, duke e arritur numrin e përgjithshëm të realizimeve në 75, pa llogaritur rolet në teatër. Kjo domethënë se Faruku tërë jetën e ka kaluar në aktrim dhe, në dekadat e fundit, duke mbajtur katedrën e aktrimit, duke nxjerrë kuadro të reja të skenës; kuadro që sot në mënyrën më serioze po i japin sharmë krijimtarisë në skenë dhe në film. Në Fakultetin e Artit të Universitetit të Prishtinës Faruku, në detrinë e profesorit, nxori pesëmbëdhjetë breza aktorësh të rinj, duke punuar edhe në kushte të jashtëzakonshme, sidomos atëherë kur regjimi i Millosheviqit i largoi studentët nga objektet e tyre dhe vazhduan të mësojnë në podrume. Për figurën e tij do të thonë se ishte "ikonë e një kohe dhe e brezave të tërë".



merrte kohën aq të çmuar të aktorit të madh. Në këso rrethanash i vjen rasti ta ketë Bekim Fehmiun në rolin e reporterit, i cili do të zhvillonte intervistën me Farukun. Ndërkaq Faruku do të përgjigjej me një lloj shqetësimi të bukur, si fëmija i përkëdhelur para prindit autoritar, duke u shprehur se ishte i mundur nga emocionet pikërisht pse, Bekimi, i shfaqej para tij në rolin e reporterit...

Duke e njohur qëndrimin e Farukut para gazetarëve, ngurrimi para Bekimit ndodhte për shkak të vlerësimit aq të lartë që ai kishte për aktorin që, tashmë, ishte bërë me famë botërore. Konsiderata e Farukut për Bekimin ishte shumë e madhe, aq më tepër pasi Bekimi përcillte çdo lëvizje aktrimi të bashkëvendësit dhe nuk kursehej t'i ofronte lëvdatat për rolet e luajtura, që për Farukun ishte një shtytje e jashtëzakonshme drejt çarjes më tej të profesionit të aktrimit, duke u gjendur në shumicën e rasteve në rolet kryesore, jo vetëm në filmat e ashtuquajtur të vendit, por edhe në filma të tjerë, siç ishte angazhimi në ish BRSS, më saktë në Tashkent (në vitin 1972) ku qëndroi mbi gjashtë javë...

Në intervistën 15- minutash me rastin e kthimit të Farukut nga Moska, të realizohet më 1972 e shohim Farukun të fascinuar meqë, thoshte: "...një artist aq i madh bën intervistë me mua... jam tejet i emocionuar, prandaj më falni për gabimet që mund t'i bëjë gjatë përgjigjes..."

Ai takim ishte simbol i bashkërespektit, në të vërtetë ishte heqje e një lloj tëhuajsimi të imagjinuar nga Faruku, i cili, duke ia çmuar famën Bekimit në të njëjtën kohë e mendonte të largët, kurse Bekimi e qafoi kolegun e tij të ri duke i dhënë kurajë që të vazhdonte në mënyrën më atraktive si artist i kërkuar, si personalitet që i kishte të gjitha rrugët e suksesit.

- Unë dhe Faruku, që është subjekt i kësaj interviste, - e nis bisedën Bekim Fehmiu duke qëndruar përpara Farukut që rri me kokë të ulur, me një buzëqeshje të fshehur në fytyrë, - jemi takuar në filmin e përbashkët "Eskadrila partizane" të Hajrudin Kërvavcit. Me këtë rast të kësaj interviste, - vazhdon Bekimi, - kërkoj nga Faruku të na tregojë për filmin e xhiruar në Tashkent...

Faruku ka qëndrimin e njeriut të ndrojtur, të njeriut që ka konsideratë të madhe ndaj bashkëbiseduesit.

- Unë kam qenë i përgatitur të flas, - vazhdon Faruku, - por jam i emocionuar ... Të bëjë Bekimi intervistë me mua, është diçka e papritur...

Derisa Faruk Begolli duke bërë të kuptohet se fama e Bekimit ia kufizonte edhe mundësinë e shprehjes, Bekimi vazhonte të mbajë qëndrimin e reporterit, duke mbajtur mikrofonin para

Farukut i cili do të vazhdonte:

- Ishte ai film, në të vërtetë ishte rol që deri tash nuk e kam luajtur... - shpreh ai krenarinë që ishte zgjedhur për atë rol, duke ia mbështetur fatit për atë angazhim.

Lidhja me fatin ka të bëjë modestinë e tij, derisa për marrjen e rolit të filmit të realizuar në Tashkent, ndikim kishte talenti dhe rolet e shumta që i kishte luajtur në filma të tjerë dhe që ishin dëshmia më e mirë për të qenë i përshtatshëm për çdo regjisor.

Edhe kur nuk ishte i angazhuar në film, Faruku rrinte afër filmit; përcillte festivalet, duke qenë gjithherë në rrethin e elitës kinematografike, duke përcjellë rrjedhat e këtij arti dhe duke shfaqur edhe ndikimin e tij rreth përcaktimit të vlerave, si në rastin konkret, bie fjala, në Festivalin e Filmit Dokumentar që mbahej në Beograd, më 1973. Sipas sistemit të atëhershëm kur, në krye të komisioneve apo jurive, çdo njësi federative duhej ta kishte përfaqësuesin e tij dhe në këtë frymë edhe Kosova, si njësi konstituive e federatës, e kishte përfaqësuesin e vet (në rastin konkret përfaqësues jurie ishte autori këtyre rreshtave), Faruk Begolli ishte përcjellësi më besnik i festivalit, duke ushtruar ndikimin për vlerësim.

Më thotë se në zhanrin e filmave të animuar do të ishte mirë të vlerësohet me çmimin e parë një prodhim i Neoplanta filmit të Novi Sadit, filmi me titull "Flamujt", film nëntë minutash, realizim i Zoran Jovanoviqit. Ishte një film metaforik, që nxirrte flamurin si vlerë të posaçme, shpesh të anuluar dhe të manipuluar. Një temë- lojë e cila, në një mënyrë, sikur përkonte me manitë e ambientit tonë ku, flamuri (ynë) kishte pësuar kundërtënie nga më të ndryshmet. Më dukej interesant insistimi i Farukut për përkrahjen e atij filmi, prandaj e tha me këmbëngulësi: "Qëndro para këtij propozimi, ndoshta fiton edhe përkrahjen e të tjerëve në juri."

Procedura e mbajtjes të mbledhjes së jurisë mbështetej në një disiplinë dhe rregull: caktimi i çmimeve bëhej në natën e fundit të festivalit me kohëzgjatje derisa të shqyrtoheshin të gjitha filmat e shfaqur në ekranin e festivalit, kjo domethënë se u dashtë të qëndronim tërë natën në një zyre duke debatuar mbi filmat dhe duke marrë qëndrime të përbashkëta, siç thonë me koncensus.

Duke pasur parasysh vullnetin e Faruk Begollit që e kishte interesimin për filmin "Flamujt" e orientova propozimin drejt këtij filmi, ndërkaq propozimi i dytë (por që propozuesi i Kroacisë ishte prof. Mate Relja) ishte i një autori kroat. Çdo anëtar ishte i obliguar të thoshte mendimin për të arritur konsensusin për cilindo film. Shtyrja rreth filmit "Flamujt" dhe realizimit kroat kishte zgjatje, deri në orën tre të mëngjesit, derisa u vendos për kategoritë tjera të filmave. Pas orës tre sekretarja e jurisë për të katërtën herë pyeti çdo njërin veç e veç se për cilin film ndanin mendimin. Ia thashë shkurt: për filmin "Flamujt". Në atë moment anëtari i jurisë nga Kroacia, Mate Relja, protestoi duke u larguar nga puna e jurisë: "Prej këtij momenti, tha, nuk jam anëtar i jurisë!" Pas një pushimi, me ç'rast përfaqësuesi i Malit të Zi, shkrimtari Sreten Asanoviq më pëshpëriti te veshi: "Edhe unë mendoja si ti, por thjesht nga qyqarllëku nuk votova hapur!"

Filmi "Flamujt" fitoi vendin e parë, ndërkaq Faruk Begolli të nesërmen qerasi grupin prej afro dhjetë vetave që ishim në aulën e sallës (së Sindikatave) ku mbahej festivali.

As atëherë, por as më vonë, nuk e kam



pyetur kurrë se cili ishte motivi për insistim aq të madh ndaj atij filmi, ishte autori (të cilin mund ta njihje) apo përmbajtja që kishte diçka magjike në përputhshmëri me flamurin tonë, më saktë me fatin e flamurit tonë për të cilin njerëzit tanë (të Kosovës) i ngatërronin këmbët nëpër burgje... Sidoqoftë, në mënyrë indirekte, Faruku ishte shkaktari për vlerësimin e atij filmi me çmim të parë.

Ishte me të renë, gjithnjë me përpjekje të bënte jetë artisti përtej kornizave politike, duke mbajtur mllëfin e ditëve më të hershme të fëmijërisë kur qe bërë viktimë e politikës vetëm pse, tradicionalisht, familja e tij kishte qenë me oreolin e bejlerëve dhe pikërisht për këtë ajo familje kishte pësuar duke humbur kreun e familjes dhe gjithë pasurinë që u vodh nga komunistët.

Ndoshta i prirë nga kjo ndjenjë e pëlqente angazhimin e atyre që, në një mënyrë apo tjetër, bënin një hap përpara drejt avancimit të ideve, drejt largimit nga klishtët e surviuara nga dokumentet partiake, përmes së cilave, edhe pse jo në masën e dogmatizmit të tepruar, siç ndodhte tek fqinjët me përkrahjen dhe përfaqësimin e realizmit socialist, prapëseprapë duhej respektuar fryma partiake gjatë zërthimit të luftës, për shembull, apo edhe të përparimit të deklaruar për hir të propagandës, e tj. Lëvizjet që kishin të bënin jashtë këtyre dogmave, Faruku i çmonte, mbase edhe insistonte në vënien në binarë të ideve që merrnin formë filmi me një gjuhë artistike ndryshe dhe me koncept të avancuar.

I tillë ishte, për shembull, filmi i Dushan Makajevit "WR misteret e organizmit", një realizim që, në kohën kur u shfaq (viti 1971) ishte vlerë e një "revolucionit kulturor", jo sipas shembullit kinez, por sipas shembujve evropian dhe amerikan; një film që kapërcente të arriturat e deriatëhershme, prandaj edhe i vënë në shënjestër si krijim destruktiv. E përmenda këtë film, meqë Faruku ishte aty, domethënë në Festivalin

(tradicional) të Filmit Jugosllav që mbahej në Pullë, kur e përshëndeta Makavejevin, duke ia uruar filmin, por edhe duke kërkuar nga ai për një intervistë

për gazetën "Rilindja". Për këtë iniciativë ishte pajtuar edhe Faruku, mbase u tërhoq nga një piknik që e kishte të planifikuar me kolegë dhe kolege aktorësh, dhe u gjend në shoqëri edhe për shkak se Makavejevin e njihje mirë, por edhe dëshira e tij ishte që për "Rilindjen" të kishim prezantimin e një fryme të re në fushën e filmit.

I thashë: "Shoku Makavejev (duke e ditur se nuk i pëlqente termi - shok) desha të marrë një opinion nga ju lidhur me idenë e përfaqësuar në filmin më të ri "Misterjet...". Ç'ju shtyri të përfaqësoni ideologjinë e Wilhem Rajhut?"

Më shikoi bukur gjatë. E shikoi edhe Farukun i cili, sikur duke dashur t'ia bënte me dije se ishte me mua, buzëqeshi dhe ma hodhi dorën në qafë.

- Sipas pyetjes që e bëtë, po më obligoni të përgjigjem, por... më thoni e keni guxim të shkruani në atë gazetën e juaj krejt çka them unë?

- Po, - i thashë.

- Atëherë, para se t'ia fillojmë, shkruaj: jam mërzuar me produksionet e filmave tanë, me temat nga lufta ku,

partizanët tanë, vrasin aq shumë sa, ta merr mendja, krejt ushtria gjermane që ishte e shpërndarë në gjithë Evropën, ka mbetur e vrarë pikërisht në Jugosllavi. Unë kujtoj se për këtë mënyrë të tillë, ta quaj banale, të paraqitjes të luftës të ashtuquajtur nacionalçlirimtare, fajet i ka Velko Bullajiqi. Dhe ti, nëse ke guxim të shkruash atë që them unë, lirisht thuaj se Makavejev tha se Bullajiq është mut. Hë, a po e shkruan këtë përkufizim timin për personalitetin krijues të regjisorit Bullajiq i cili, për të fituar simpatinë e komunistëve, rrëfen në mënyrë sensacionale. Me këso rrenë ai arrin të përfitojë shumë. Kurrë nuk i mungojnë paratë për realizimin e filmave, kurse mua jo vetëm që nuk më ndihmojnë materialisht, por edhe më ndjekin, edhe nuk më lejojnë të shfaq filmin, edhe (për shkak timin) e shkarkojnë nga detyra e drejtorit të Neoplantës drejtorin Svetozar Udavački. A e ke të qartë? Pranbdaj thashë se Bullajiq, por edhe të tjerët si ai, janë plehra.

(Vijon në faqen 5)



Kohë më parë doli nga shtypi vëllimi i tretë i kolanës *Enciklopedia naimiane*, me studime për artin e Naim Frashërit. Pasi ka parë dritën vëllimi *Naim Frashëri në librin dhe në shtypin botëror e të huaj* (2021) dhe vëllimi me studime *Gjuha e Naimit* (2022), tash së fundi u kurorëzua vëllimi *Arti i Naimit* (2025).

Në këtë vëllim janë përfshirë rreth njëqind autorë me mbi njëqind e pesëdhjetë njësi studimore, të cilat në një mënyrë a një tjetër flasin për artin e veprës së Naim Frashërit, në të vërtetë, më shumë se kaq, për artin e gjuhës së tij, artin e komunikimit të tij me bashkëkohësit, për artin letrar dhe artin estetik, për artin e ligjërimit dhe stilin e të thënit të botëkuptimit të tij për jetën dhe të tjerët, për Shqipërinë, shqiptarët dhe universin. Për artin e tij në këtë vëllim kanë shkruar historianë të letërsisë, kritikë të letërsisë, biografë, historianë, gjuhëtarë, shkrimtarë, artistë të fjalës e të mendimit gjatë gjithë shekullit XX. Janë të paktë shkrimtarët në letërsinë shqipe për të cilët është shkruar pa pushim, pa ndërprerje, pa përjashtim dhe në mënyrë unike. Janë disa shkrimtarë, sikur është bie fjala Gjergj Fishta, për të cilët një periudhë është shkruar shumë e në ndonjë tjetër nuk është shkruar fare sepse ishin përjashtuar nga sistemi politik; janë disa shkrimtarë, si pjesa më e madhe e shkrimtarëve të realizmit socialist, për të cilët në një periudhë kohore është shkruar duke u vlerësuar lart kryesisht për temat, motivet dhe mesazhet politike, por në një periudhë tjetër nuk janë vlerësuar gjithanshëm, si dhe, më në fund ka shkrimtarë, si bie fjala Ismail Kadare, për të cilin njëkohësisht është shkruar me konsideratë dhe me sugjerime; por janë të paktë, shumë të paktë shkrimtarët, si Naim Frashëri për të cilin është shkruar gjithnjë dhe gjithkund me konsideratë të pafundme për jetën dhe për veprën e tij. Të këtillë janë edhe autorët e teksteve të përfshira në këtë vëllim dhe të këtilla janë vlerësimet për veprën letrare të Naim Frashërit në shkrimet e tyre.

Vepra hapet me një ese të shkrimtarit e studiuesit Moikom Zeqo, i cili trajton një përmasë tjetër universale të Naim Frashërit, si profet i kombit dhe i veprës së tij, i cili u flet të gjitha kohëve dhe të gjithë popujve. Intelektuali Zeqo portretin e Naim Frashërit dhe komunikimin e tij e ndërton mbi katër përbërës, të cilët ai i quan "katër elementët e kozmogonisë së filozofëve të lashtë": idenë e njeriut shqiptar (*homo albanicus*); idenë e gjuhës letrare; idenë e universit shqiptar dhe idenë e madhe të miqësisë së popujve. Në kronologjinë e studimit më shumë se 100-vjeçare të personalitetit dhe veprës së Naim Frashërit, këto katër dimensione kanë qenë objekt i vlerësimit të të gjitha kohëve: në kontekst të krijimit të identitetit kombëtar; në kontekst të rolit të gjuhës, përtej besimeve fetare dhe bindjeve politike për krijimin e identitetit të shqiptarëve; në kontekst të paraqitjes së universit mitik e historik, gjeografik e etnokulturor, gjuhësor e përmbajtësor; në kontekst të miqësisë me fqinjët në prag të pavarësisë së tyre nga Perandoria Osmane etj.

Studimet e vëllimit *Arti i Naimit* hapen me një fragment nga studimi i parë monografik i Mit'hat Frashërit për Naim Frashërin, pa të cilin vështirë është të shkruhet një studim serioz për veprën dhe sidomos për jetën e tij. Të kësaj natyre janë edhe teksteve të studiuesve, të cilët me artin e veprës letrare të Naim Frashërit merren duke shkruar në kontekstin enciklopedik, biografik a përgjithësues të veprës së tij. Fjala është për teksteve të Kostaq Cipo, Milo Duçit, Zoi Xoxës, Eqrem Çabejt, Faik Konicës, Namik Resulit, Nebil Çikës, Koçi Petritit etj., të cilat janë shkruar kryesisht gjatë gjysmës së parë të shekullit XX.

Gjysma e dytë e shekullit XX shënon një shkallë dhe një përmasë tjetër të botimit,

Arti i Naimit (Përgatiti: Mehmet Gëzhilli. Përkujdesja shkencore: Akad. Gjovalin Shkurtaç, Enciklopedia naimiane II, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2024, f. 906.

Kryetema e sintezave shkencore për veprën e Naim Frashërit

Nga Myrvete & Begzad Baliu

leximit e studimit të veprës së Naim Frashërit, prandaj thellësia e përmasa e trajtimit të veprës së tij sjell rezultate të tjera, sikur janë ato të studiuesve kulminantë të tij: Dhimitër S. Shuteriqi me monografinë për jetën dhe veprën e Naim Frashërit (1980), Rexhep Qosjes me monografinë për poetikën e veprës së Naim Frashërit (1985), Françesko Altimarit me botimin filologjik të *Bagëti e Bujqësisë* (1995), Jorgo Bulos me monografinë për tipologjinë e lirikës së Naim Frashërit (1999) etj. Fjala është për monografite e papërsëritshme deri më tash për Naim Frashërin, qoftë për tërësinë e njohjes së jetës dhe veprës së tij (Shuteriqi), qoftë për thellësinë shumëdimensionale të sintezës së poetikës së veprës së tij (Qosja), qoftë për metodën bashkëkohore të botimit të veprës së tij (Altimari), qoftë për tipologjinë shumëdimensionale të lirikës së tij (Jorgo Bulos) etj.

Karakteristikë e kërkimit të artit, në të vërtetë të poetikës në veprën e Naim Frashërit është se kërkime të këtilla kanë bërë edhe gazetarët e intelektualët si: Nebil Çika, Selahudin Toto; gjuhëtarët, që më parë se sa të merreshin me projektet e tyre në fushë të filologjisë, u morën me përmasën kombëtare, historike, filologjike e artistike të veprës së tij etj. Të tillë ishin sintaksologu

Kostaq Cipo, etimologu e historiani i gjuhës Eqrem Çabej, historiani i gjuhës Namik Resuli; biografi i parë i Asdrenit, Dhimitër Fullani, intelektuali, editori e kryepolemisti Faik Konica; satiristi e përkthyesi Nonda Bulka; dramaturgu Et'hem Haxhiademi, romancierët e realizmit socialist Sterio Spasse e Shefqet Musaraj; bardhi i bektashizmit dhe martiri i demokracisë Baba Ali Tomori; historiani i periudhës mesjetare Injac Zamputi; politikani e intelektuali Abaz Ermenji; kryestudiuesi i Ndre Mjedës Mark Gurakuqi; shkrimtarët e sipërm të gjysmës së dytë të shekullit XX, Ismail Kadare e Dritëro Agolli; studiuesi i folklorit e letërsisë bashkëkohore Anton Nikë Berisha; autori i parë i *Abetares* dhe teksteve shkollore elementare në Prishtinën e pasluftës së dytë botërore Tajar Hatipi; pedagogu e studiuesi themelart i jetës dhe veprës së Migjenit në Shkup, Petro Janura; profesorët e përkushtuar të eposit Demush Shala e Qemal Haxhihasani; historianët e letërsisë e kritikët: Agim Vinca, Razi Brahimi, Adriatik Kallulli, Ali Aliu, Floresha Dado, Sabri Hamiti, Ali Xhiku, Dalan Shaplo, publicistët e shkrimtarët Ramiz Kelmendi e Mehmet Kraja; dramaturgu Fadil Kraja e romancierët Murat Isaku e Zejnullah Rrahmani; studiuesi i letërsisë

së bejtexhinjve e ligjëruesi universitar Mahmud Hysa; studiuesit e letërsisë bashkëkohore Shaban Sinani e Sali Bashota; studiuesi i marrëdhënieve letrare e kulturore shqiptaro-rumune Luan Topçiu; profesorët universitarë të Vlorës Bardhosh Gaçe e Petrit Qejvani; përkthyesja dhe studiuesja e letërsisë së Rilindjes Kombëtare Klara Kodra e studiueset e një brezi më të ri: Mimoza Hysa, Rovena Vata Mikeli; akademikët Vasil S. Tole e Arian Leka; poetja Natasha Lako e studiuesi i editimit të veprës së Naim Frashërit në Lindjen e Largët Abdulla Rexhepi etj. Përgjithësisht, pjesa më e madhe e studiuesve përfaqësohen me nga një tekst, ndërsa një numër tjetër, si: Rexhep Qosja, Jorgo Bulos, Ali Aliu, Ali Xhiku, Mahmut Hysa, Sabri Hamiti, Klara Kodra etj., me më shumë se tri tekste.

Në studimet monografike, në esetë, në tekste me karakter enciklopedik, në trajtesat, në hulumtimet krahasuese etj., autorët e tyre e kanë parë artin e Naim Frashërit në raport me artin e krijuesve më të hershëm prej të cilëve është ndikuar, në raport me artin e shkrimtarëve bashkëkohës, në raport me temat e mëdha rajonale dhe universale, në raport me gjinitë dhe llojet e tjera letrare dhe në raport me gjuhët e tjera.

Le të theksojmë këtu shembujt krahasues, afrues, kundërshtues dhe kompletarë ndërmjet Konicës e Naimit, Prometheut e Homerit, vendit të tij në literaturën shqiptare, shenjtërinë e emrit të tij, përmasën mendonjëse (intelektuale) të tij, kultin e tij; natyrën shqiptare, dashurinë, perceptimin estetik, raportet me Lasgush Poradecin, Fishtën, Çajupin, folklorin, Rumiun, përkthimet e Vexhi Buharasë, raportet me poezinë persiane, vendin e tij në kritikën letrare, yllësinë poetike të tij, polemikat e tij në letrat shqipe, veçoritë romantike të poezisë së tij, përbërësit autentikë të shkollës së romantizmit shqiptar, kultin e flijimit në poezinë e tij, strukturën e vargut të tij, parimet kryesore të artit të tij, raportet tematike dhe strukturën ritmike ndërmjet poezisë së Naim Frashërit dhe Ndre Mjedës, intertekstualitetin e poezisë së tij, figurat mitike, historike, letrare e gjuhësore, reflektimin, kryqëzimet dhe ndërndikimet e tij ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit, atdhetarinë e tij, komplementaritetin e poezisë së tij me letërsinë popullore, praninë e elementeve kozmogonikë në krijimtarinë poetike dhe jopoetike të tij, afritë tematike e mitike me Uollt Uitman, afrinë me poezinë perse etj.

Duke shkruar për të gjitha temat, autorët e teksteve, me theks të veçantë studiuesit, kanë shkruar për artin e krijimtarisë letrare të tij, sikur e kanë theksuar autorët e periudhës së parë dhe poetikën e krijimtarisë, sikur e kanë konceptuar autorët e periudhës së dytë, kryesisht nga specialistët e teorisë së letërsisë dhe historianët e letërsisë së shkollës së strukturalizmit. Duke shkruar për krijimtarinë letrare të Naim Frashërit, studiuesit kanë theksuar përbërësin themelor të veprës së tij: "magjinë e artit naimian (Dalan Shaplo); të lartësuarit e artit të tij (Namik Resuli); "të çfaqurit ndjenjave me fjalë (...) si një pasqyrë e artit të tij në fushën e vjershërisë" (Baba Ali Tomori); për "krijimin e artit, si një punë të vështirë dhe madje si një nderë e artit" (Injac Zamputi); "pikëpamjen e artit" (Shefqet Musaraj); "rregulat e artit" (Nonda Bulka); për "konfliktin ndërmjet jetës dhe artit" (Petro Janura); për "efektin e artit të tij" (Dhimitër S. Shuteriqi); për "misionin e artit dhe të artistit" (Jorgo Bulos); për "majat, kulmet, fuqinë, gjuhën dhe ndikimin e artit" (Ali Aliu); për "mjeshtërinë e artit" (Shaban Sinani); për "famën tejkohore të artit, për atdhetarizmin e artit të tij" (Sali Bashota) etj.

Duke shkruar për dy nga poezitë antologjike të Naim Frashërit *Fyelli* dhe





Fjalët e qiririt, studiuasi i poezisë shqipe Profesor Agim Vinca, ka bërë njëkohësisht edhe një sintezë të pikëpamjeve të Naim Frashërit për *artin letrar*, përkatësisht konceptet e tij për *poetikën*, mbase jo si nocion po si përmbajtje dhe përbërës estetik e krijimtarisë letrare. “Derisa në të parën (*Fyelli*), në frymën e përgjithshme të romantizmit, për artin poetik flitet si për diçka me karakter hyjnor, në të dytën (*Fjalët e qiririt*), shfaqet ideja e misionit mesianist të poetit si prijës i popullit dhe si tribun. Dhe, derisa në të parën poeti identifikohet me fyellin, imanencë e të cilit është zëri, në të dytën njësohet plotësisht me qiririn, që ka si pandan dritën”, shkruan Profesor Agim Vinca.

Grupi i studiuesve të cilët shkruajnë për poetikën e veprës letrare të Naim Frashërit, është më i madh, ndërsa çështjet e krijimtarisë letrare me të cilat merren janë më të mëdha, qoftë brenda teksteve të tij letrare, estetike, etike, didaktike, publicistike, historike e gjuhësore me të cilat merret, qoftë në kontekst të krahasimit të tyre me autorë e vepra letrare të kohës së tij dhe ndikimit të tyre më tej.

Deri sa për artin e Naimit, përkatësisht poetikën e veprës letrare të tij, kanë shkruar shkrimtarë, publicistë, bashkëkohës, studiues, filozofë, artistë të të gjitha përvojave e drejtimeve shkollore e teorike dhe në artikujt, esetë, trajtesat e studimet e tyre kanë identifikuar disa përbërës të artit të tij, apo sintezën e disa prej tyre, studiuesi Dhimitër S. Shuteriqi në monografinë e tij, atë e ka trajtuar si sintezë qendrore të veprës letrare të tij, ndërsa studiuesi tjetër Jorgo Bulo, tipologjinë e artit, përkatësisht poetikës të tij e ka bërë gjerësisht e thellësisht në monografinë e tij për lirikën e Naim Frashërit.

Përtej të parëve dhe të dytëve, sintezën e madhe shkencore të artit letrar të Naim Frashërit, përkatësisht poetikës së veprës së tij e ka bërë Profesor Rexhep Qosja. Sinteza e tij është bërë mbështetur në shkollën e strukturalizmit, e kjo do të thotë në rrafshin diakronik e sinkronik të saj. Në këto studime dhe sidomos në sintezat e mëdha të saj, analiza e veprave të tij është parë në rrafshin e makrostrukturës dhe mikrostrukturës, të cilat bashkërisht përbëjnë sintezën e poetikës së tij. Disa nga studimet e tij të mëparshme, sinteza e madhe e “Historisë së letërsisë shqipe” (Romantizmi I, II, III), me theks të veçantë I dhe III, si dhe kryevepra “Porosia e madhe” (Poetika e veprës së Naim Frashërit), përfaqësojnë nivelin më të lartë të strukturës së poetikës së romantizmit në përgjithësi dhe poetikës së veprës së Jeronim De Radës e veprës së Naim Frashërit në veçanti.

Me nocionin e poetikës dhe të togfjalëshave të krijuar me të, në sintezat e Profesor Qosjes për poetikën e Naim Frashërit mbulohej jo vetëm përbërësit estetikë, përkatësisht disa prej tyre, sikur veprojnë pothuajse të gjithë paraardhësit e tij, po edhe poetika e gjuhës, e ligjërimit, e krahasimit, e temave, e formave poetike, e thënieve poetike, e habitës poetike, e

motiveve poetike, e veçantive poetike, e letrave poetike, e strukturës së mjetit poetik, e subjektit poetik, e procedimit poetik, e realizmit poetik, e prirjeve poetike, e prozave poetike, e poezisë poetike, e utopizmit poetik, e gjuhës poetike nocionore, e formave filozofiko-poetike, e parimeve të gjuhës poetike, e formave të lira të gjuhës poetike, e praktikave poetike, e teksteve poetike, e fjalës poetike dhe retorikës konkrete, e strukturës poetike, e mjeteve gjuhësore poetike, e poetikës universale, e reagimeve poetike, e unit poetik, e përfytyrimit poetik, e poetikës së figuracionit, e njësisë së poetikës romantike, e iluzionit poetik, e konfiguracionit poetik, e modelit poetik, e fjalorit poetik, e nëntekstit poetik etj. Si e tillë sinteza e artit poetik, përkatësisht poetikës së veprës letrare të Naim Frashërit, nuk e mbulon vetëm krijimtarinë letrare po edhe atë historike, didaktike, gjuhësore, historike dhe madje jetësore.

Autorët e tjerë ndërkaq merren me një apo më shumë veçori të tjera të poetikës së tij, por jo në korpusin thellësisht universal të veprës së Naimit. Në këtë rrjedhë do parë studimin për “shijet estetike të popullit dhe poetikën e tij” (Haxhihasani); diskutimin për “gjuhën popullore dhe poetikën e folklorit në veprën e Naim Frashërit” (Jorg Bulo); vlerësimet për “dallimet në poetikën e Naim Frashërit dhe të periudhave apo të brezave të kohës së tij” (Sabri Hamiti); pikëpamjet krahasuese për ndjenjat e ndërtuara në poetikën letrare të Naimit, të përbëra nga akti i frymëzimit, akti i krijimit, zgjedhja e motivit, liria e krijimit, gjuha e figurshme ose metaforike (Mahmut Hysa) etj. Koncepteve të Naim Frashërit për poetikën, të cilën më parë e kishte theksuar Profesor Vinca, i është kthyer edhe njëherë Profesor Luan Topçiu, kur vuri re se “Naim Frashëri është i pari poet shqiptar që ndjen nevojën e ndërtimeve epiko-lirike, të poemës me frymë epopeje që të figurizojë në mënyrë simbolike gjenezat e mëdha, dhe, në të njëjtën kohë, është ai që do të shtrojë për herë të parë parimet e pyetjet mbi poetikën.

Në këtë rrjedhë studiuasja Klara Kodra ka shkruar për tri kode në poezinë e Naim Frashërit, që në të vërtetë janë tre çelësa të zbërthimit dhe hyrjes në shpirtin e tij, në atë “vizion të jetës” që përcakton poetikën e tij (Kodra), ndërsa po kaq sinjifikative duket përcaktimi i poetikës së Naimit “si poetikë e reales” (Mimoza Hysa) dhe këta përbërës identifikohen edhe më përafërt dhe shfaqen si paradigmë e poetikës së tij, në pikëpamjet e Llanajt: “Bukuria, dashuria dhe perëndia përbëjnë në filozofinë dhe në poetikën naimiane një trinitet të pandarë. Ky konceptim e ka burimin tek mistika sufiste”. (Arjan Llanaj)

Parë në tërësinë e tij, ky vëllim përplotëson një dimension shumë të rëndësishëm, përkatësisht boshtin kryesor të kërkimeve në poetikën e veprës së Naim Frashërit, krahas atij për gjuhën dhe filozofinë e formimit kombëtar.

Prishtinë, janar 2026

(Vijon nga faqja 3)

- Mirë, unë i shënova këto fjalë, ndërkaq nuk u përgjigjët në pyetjen rreth Vilhem Rajhut.

- Shikoni, filmi është një produkt i revolucionit seksual në botë dhe për bazë ka ideologjinë që përfaqëson psikologu Vilhem Rajh. Ai, në një mënyrë sa origjinale, po aq edhe atraktive, e sheh shpëtimin e njerëzimit, apo të avancimit të tij përmes zbrazjes emotive, që domethënë përmes lirisë së plot shpirtërore të njeriut. Kjo teori nuk është e re, vjen në shprehje përmes psikoanalizave të dala edhe nga laboratorit i Frojdit, bie fjala, kurse unë jam përpjekur dhe (sipas vlerësimeve të jashtme) ia kam arritur t'i bëj shërbim të mirë kësaj ideologjie e cila, kuptohet, nuk iu pëlqen komunistëve. Filmi, nga ana tjetër, është edhe produkt i problemeve të viteve të fundit të gjashtëdhjetave, të lëvizjes së rinisë së atëhershme dhe ishte kthesë në fushën e kinematografisë.

- Prandaj filmi u ndalua?

- Sigurisht, por kopjet arritën në qendrat botërore dhe, nga atje, marr vlerësime të jashtëzakonshme. A je i kënaqur me përgjigje?

- Po.

- E, pra, uroj që të botohet në gazetën tënde, nëse ajo gazetë nuk ka embargo të mendimeve të reja.

- Edhe ne jemi në të njëjtin shtet, por jam i bindur se nuk do të kem problem botimin e këtyre mendimeve. Çfarë thua Faruk: - iu drejtova.

- Nuk jam aq optimist. Unë jetoj në ambient tjetër, por megjithëkëtë besoj se Prishtina po i jep krah frymës së re, sidomos pas 81- shes.

Makavejev qeshi, ndoshta për shkak të pasigurisë së Farukut, apo ndoshta për shkak të besimit të tij se ngjarjet e 68- ësh kishin ndikuar pozitivisht në pranimin e influencës nga meset e moderuara evropiane në fushën e zhvillimit të arteve.

Karakteristikat për një avancim më të plotë pozitiv në fushën e kinematografisë do të vijnë në shprehje gjatë viteve të shtatëdhjeta, kur e shohim Farukun në elementin e tij të sukseseve në shumë filma jo vetëm jashtë Kosovës ku kishte e kishte nisur dhe kishte arritur suksese të jashtëzakonshme, por edhe në ambientin e vendlindjes së tij, domethënë në filmat shqip, siç ishte “Si të vdiset”, “Era dhe lisi” në regji të Besim Sahatçiu, “Kur pranvera vonohet” në regji të Ekrem Kryeziut, “Proka” e t.j., por edhe në seria televiziv, siç ishte “Fidani” që ishte një shkak shtesë për kënaqësinë e autorit, për shkak se te “Fidani” që u realizua sipas romanit “Pas kthimit” në regjinë e Sadedin Prekazit, Farikun e kisha shumë afër. U bë pjesë e rrëfimit tim dhe e shihja me tipare të plota të personazhit të cilin e kisha formësuar shumë vjet më parë. Në rolin e prindit të Fidanit Farukun e shihja të fisnikëruar me ndjenja reale të prindit në situatën e humbjes së të birit. Po e shihja edhe në rolin e këshilltarit pranë regjisorit, kështu që ai sukses evident i serisë “Fidani” ishte në kompetencat e Farukut dhe që e arriti bindshëm. Siç arriti edhe sukseset në skenë teatri, në “Epoka para gjyqit” për shembull, në atë rrëfim dinjitoz mbi Lidhjen e Prizrenit, apo edhe te “Dervishi e vdekja” edhe në role të tjera skene, siç ishte edhe roli permanent i profesorit në Akademinë e Teatrit dhe Filmit në Prishtinë, ku u gjend në kohën më të përshtatshme, pasi qe kthyer nga Beogradi pas ngjarjeve të viteve të tetëdhjeta. Pra, që nga viti 1990, Farukun e shohim si banor të përhershëm të Prishtinës, si emblemë e teatrit “Dodona” dhe shoqërues konstant me studentët e tij tek te cilët ofronte përvojën e gjatë të aktrimit në filma dhe të mësimave në Akademinë e Beogradit.

Ai thoshte se në Beograd kishte filluar mësimet e aktrimit, duke u prezantua në skenë para profesorëve të tij, me pjesët e titulluara “Jam talent se jo mahi”. Me këtë përvojë nga ditët e studimeve Faruku le mbresa të jashtëzakonshme para studentëve të Prishtinës të cilëve u mbante ligjëratat. Me këtë seri aktrimesh treguan aftësitë e tyre interpretuese aq shumë student të e studente, që sot kanë pasuruar skenat e teatrove, por edhe rrëfimet filmike e televizive.

Në biografinë e tij shënohen aq shumë përmbajtje filmash, aq shumë aktrime në dërrasa teatri, shënohet edhe se ishte i martuar, por nuk pati trashëgimtarë andaj edhe qe ndarë, pas shtatëmbëdhjetë vjetësh martesë, nga bashkëshortja për të cilën gjithmonë fliste me adhurim, por shënohet edhe gjendja e tij apatike në Prishtinë gjatë bombardimeve. Ai nuk u largua nga Prishtina. Ndenji gjatë atyre muajve të ethshëm, vetëm të mos bëhej numër, siç thoshte.

Mandej, pas luftës, vazhdoi me të njëjtin ritëm; mbledhi studentët duke i konsideruar si fëmijët vet, për të nxjerrë kuadro aktrimi.

Mandeu, seria “Profesor, jam talent se jo mahi” arriti deri në numrin shtatë, që domethënë shtatë breza studentësh. Te numri shtatë ishte prova e fundit e Farukut:

Në sallën e Teatrit “Dodona” kishin ardhur shumë studentë të shiheshin me Farukun i cili, pas një mungese të gjatë për shkak të sëmundjes, erdhi zorshëm, por me përpjekje që të mos lente përshtypjen e njeriut të mundur nga sëmundja e pashërueshme. Zuri vend në karriget e para, mes studentëve në rolin e publikut dhe të tjerëve që defilonin në skenë. Faruku ishte i entuziasmusar, por jo si përpara. Përpiquej të tregohej i lumtur, dhe atë lumturi e kishte nga parakalimet e studentëve në skenë në kuadër të pjesës “Jam talent se jo mahi.”

Me atë rast shpjegoi përvojën që e kishte sjellë nga studimet në Beograd, pastaj me një qëndrim prej njeriut që nuk dorëzohej, tha:

“E kam një sëmundje...Jam kah luftoj ta mposht smundjen...Unë gjithmonë më së miri e ndjej veten me kolegë dhe publikun... Tërë jetën kam studiuar dhe luajtur... Për mua nuk ekzistojnë të hollat, partitë... Për mua ekzistojnë vetëm kolegët dhe publiku...”

Flet ai me shprehje të fjalëve dhe mendimeve, në sallë ku përcillet me vëmendje të të pranishmëve. Dhe thotë:

“... deri tash, siç e dini, e kemi arritur numrin shtatë të serisë “Jam talent se jo mahi. Po bëj përpjekje të shërohem dhe të vazhdoj edhe tetëshin...”

Me gjitha përpjekjet, Faruku vdiq (në moshën 63 vjeçare, në një nga ditët e nxehta të gushtit të vitit 2007, në atë të marte, në ora 03.00 të mëngjesit, ndërkaq të pasnesërmen e asaj dite, domethënë të enjten në ora 12.00 u përcoll në rrugën e fundit drejt varrezave të Prishtinës.

Arti nuk krijohet në izolim, as në kufizim. Arti krijohet në hapësirat që takohen dhe krijojnë. Ajo gjindet në universin e individit dhe kolektivit, midis përvojës personale dhe kujtesës shoqërore, midis atij vendi që i përkasim dhe atyre vendeve që i imagjinojmë. Kur flasim për praktikën artistike të femrave, ajo hapësirë takimi fiton një identitet më të përfilltë. Përmes veprave artistike të femrave, hapen dimensionet e kujtesës, identitetit dhe pranisë në strukturat shoqërore dhe kulturore që shpesh i marginalizojnë ato. Një liri dhe realitet që vetë krijohet dhe nga vetëvetja merr formë në botë. Aty gruaja dhe zëri i saj jehojnë në një gjuhë të veçantë, që jo gjithkush mund ta kuptojë, por nuk len askënd indiferent.

Një vepër artistike vetë për vehte vlen mjaftueshem, por një vepër artistike nga një femër vlen aq sa ka vlerën një zë që gjen guximin të dalë nga heshtja. Vlen sa një dritë e vogël që përçan errësirën e një heshtje kolektive dhe një mburrje mashkullore. Ajo është një rrëfim që flet më shumë se sa fjalët mund të thojnë. Ajo është një puls i brendshëm që rreh në formë, në ngjyrë, në vija, në materie...

Por çfarë jehone merr një zë femëror kur bashkohet me zëra të tjerë femërorë? Çfarë peshe ka një ekspozitë e përbashkët ku vetëm gratë dhe vajzat marrin pjesë? Ku lëviz ky rrefim dhe si shkëlqen ajo dritë?

Përgjigjen na dëshmon ekspozita "Përtej kufijve, brenda shpirtit", që u mbajt më datën 8 mars të këtij viti, në hapsirat ekspozituese në Imanje Knjaz në Podgoricë të Malit të Zi.

Në këtë ekspozitë figuronin veprat artistike me të cilat gratë dhe vajzat artiste shqiptare të trevave shqipfolëse të Ballkanit argumentonin dhe zërat e tyre nuk qëndruan të izoluar, por u ndërthuren në një kor të shumëzërshëm përvojash, ëndrrash, ndjenjash dhe kujtimesh. Secila vepër nga vetja mbart një histori personale, por së bashku ato krijuan një hapësirë ku rrëfimet individuale u shndërruan në një narrativë kolektive.

Kur përmendet hapësira kulturore shqiptare është e domosdoshme të dime se ajo u formua përtej teritorive të vetme politike e historike duke patur faktorë të ndryshëm që ndikonin në zhvillimin e saj.

Duke mbajtur në mend vetëm disa ngjarje të shekullit të kaluar siç ishin: Shpërndarja politike e teritorisë së Shqipërisë nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër në vitin 1913 (së shpejti pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë në vitin 1912), bashkëjetesa e shqipëtarëve brenda shtetit të EX-Jugosllavisë, konfliktet e shumta ndërshtetëror që rezultojnë në migrimin e shqipëtarëve në diasporë, por edhe hapja e institucioneve të arsimit dhe kulturore siç ishin: hapja e Galerisë Kombëtare e artëve

Përtej kufijve, brenda shpirtit: veprat e artisteve shqiptare nga Mali i Zi

Nga Gjovana Dediq

në Tiranë në vitin 1954, hapja e Universitetit të Prishtinës në vitin 1969 dhe hapja e Galerisë Kombëtare të Kosovës në vitin 1979... të gjithë këto ndikonin në zhvillimin e hapësirës shoqërore, kulturore dhe artistike për të gjithë shqipëtarët, e poseçarisht për artistët femërorë që në këtë frymë mundën të merrnin pjesë vetëm gradualisht sepse një proces i tillë ishte shpesh i vështirë.

Brenda këtij konteksti të fragmentuar gjeografikisht dhe kësaj prapashese historike u krijua një teren ku identiteti nuk paraqitet si kategori e fiksuar, por si një proces i vazhdueshëm interpretimi dhe rikonfigurimi.

Në këtë bazament, hapësira kulturore shqiptare në Mal të Zi e vendosur ndërmjet traditave lokale, realiteteve institucionale të shtetit, lidhjeve kulturore dhe me hapësirën më të gjerë shqiptare. Kjo sferë kulturore formon një fushë ku praktikën artistike marrin forma të ndryshme shprehjeje. Brenda këtij horizonti krijues veprojnë edhe artistet shqiptare nga qytetet e ndryshme të Malit të Zi.

Emra të njohur për artin bashkëkohor të siudhësës së Ballkanit (por edhe më gjërë) dhe emra të ri të artistëve. Nder to u gjenden Anamaria Gjonaj dhe Arlinda Dushaj nga Tuzi, Arijeta Lucević nga Rozhaja, Brigita Antoni, Emina Nimanbegu, Jetmira Hoxha, Lisa Nimanbegu, Mersiha Resulbegović Mavrić, Teodora Mirdita, Vahida Nimanbegu dhe Gjovana Dediq nga Ulqini, Ivanka Đonović nga Podgorica dhe Kaltrina Hoti nga Hoti i Plavës.

Veprat e tyre artistike përfshinin një

spektrum të gjërë teknikash krijimtarije që nga piktura, grafika e deri tek fotografija dhe teksti. Veprat e këtyre artisteve artikulojnë përvoja individuale, por njëkohësisht reflektojnë dimensione më të gjera të identitetit kulturor, kujtesës shoqërore dhe përkatësisë gjinore.

Anamaria Gjonaj dhe Arlinda Dushaj, dy artistet nga Tuzi, ekspozojnë dy koncepte të ndryshme. Në grafiken Flappers të realizuar në teknikën e shtypit, serigrafisë, Anamaria Gjonaj ndërton një hapësirë figurative ku dy figura femërore vendosen brenda një mjedisi dekorativ, ku vijat janë të theksuara, deformimi i figurave është ekspresiv dhe përdorimi i elementeve grafike krijojnë një estetikë që i afrohet ilustrimit dhe karikaturës bashkëkohore me një esencë avangarde.

Figura femërore të paraqitura në vepër koegzistojnë në mënyrë harmonike me mjedisin ku gjenden, por edhe njëkohësisht reflektojnë një pakënaqësi intime. Kjo figuron në qëndrimet trupore dhe me artikullimet e tyre të përditshme, gjë që sugjeron një reflektim mbi identitetin dhe rolin shoqëror të gruas në hapësirën urbane moderne.

Nga ana tjetër, në veprën Bashkim përmes vallëzimit, Arlinda Dushaj përdor një qasje ekspresive dhe abstrakte për të artikuluar idenë e lidhjes dhe komunikimit njerëzor. Në një sfond të hapur dhe të zbehtë, del në pah një prekje domethënëse.

Një bashkim, por jo i atij të llojit të një gruaje dhe mashkulli. Në fakt është një bashkim femëror. Një kontakt fizik që thotë

"jemi këtu për njëra tjetrën". Motivet e veshjeve tradicionale dhe fryma e traditës shqipëtare dëshmon në një lidhje të fortë historike me kohën e tashme dhe atë të së kaluarës. Përmes kësaj gjuhe ekspresive, vallëzimi paraqitet jo vetëm si një akt fizik, por edhe si metaforë e bashkimit dhe e komunikimit.

Artistja Arijeta Lucević nga Rozhaja me veprën e saj Beshkët e Nemuna paraqet një pejzazh malor të theksuar në reliev me një tonalitet dhe paletë ngjyrash të ngrohta që theksojnë madhështinë dhe dramatzimin e nyrës së Beshkëve të Nemuna. Vepra shëndrohet në një metaforë kulturore ngaqë ajo simbolizon qëndrueshmërinë, krenarinë dhe lidhshmërinë për atdheun dhe identitetin. Vargmali i Alpeve Dinarike më në theksim të Beshkëve të Nemuna që edhe pse ishin shumë të thepisura e të thella në reliev dhe të ashpërta në klimë, shërbyen si vend i strehimit nga konfliktet e shumta dhe mbrojtjes së kulturës e traditës të popullit shqiptar. Në këtë mënyrë Arijeta paraqet natyrën si një element i pandashëm i historisë dhe kulturës së komuniteteve që kanë jetuar në këto treva.

Nga qyteti më jugor i Malit të Zi marrin pjesë një grup artistesh që përmes praktikave të ndryshme vizuale artikulojnë përvoja estetike dhe kulturore të lidhura ngushtë me hapësirën bregdetare dhe me historinë shekullore dhe shumë-shtresore të këtij qyteti. Në veprat e tyre reflektohen njëkohësisht dimensione të ndryshme të kujtesës, identitetit dhe përditshmërisë, duke krijuar një dialog të ndjeshëm mes traditës dhe shprehjes bashkëkohore artistike.

Artistja Brigita Antoni, me rapitograf në fletë sjell veprën Pa titull. Kompozimi i saj ndërtohet mbi një ritëm të dendur linear ku format bimore ndërthuren në një strukturë organike të vazhdueshme. Simbolika e vitalitetit, ciklit jetësor dhe vetë kalimit të kohës karakterizohet nga elementet bimore me motive dhe lëvizje dekorative. Nga vijat e zeza që janë vendosur me siguri të dorës dhe qartësi të syrit krijohet një dialog mes disiplinës grafike dhe spontanitetit organik, duke e vendosur natyrën si një strukturë të gjallë dhe dinamike që vazhdimisht formësohet dhe transformohet.

Emina Nimanbegu, sjell pikturën Arcanum dhe krijon një hapësirë vizuale të mbushur me energji dhe tension kromatik, ku ngjyra bëhet elementi kryesor i komunikimit mes veprës, artistës dhe publikut. Kompozimi abstrakt organizohet rreth një qendre të ndritshme që tërheq vëmendjen e shikuesit. Qendra hapsinore simbolitikut vlen si një portë që të çon drejtë një dimension tjetër. Një dimension imagjinar, surreal dhe larg prekjes njerëzore. Në këtë mënyrë formohet një ndjenjë gravitacioni vizual. Një gravitacion

Anamaria Gjonaj



Emina Nimanbegu



Mersiha Resulbegović Mav



Teodora Mirdita



që falë ngjyrave të ndezura jep një ndjenjë ekuilibrimi mes kaosit dhe harmonisë. Në këtë vepër forma dhe ngjyra bashkëveprojnë dhe mbartin procesin e lindjes së emocionit dhe intelektit personal.

Në veprën *Seascaper*, Jetmira Hoxha ndërton një peizazh detar që tejkalon përshkrimin realist dhe lëviz drejt një interpretimi ekspresiv të hapësirës bregdetare.

Një motiv karakteristik dhe ngusht i lidhur me Ulqinin. Ritmi vertikal i fuqishëm brenda kompozimit të anijëve të grumbulluara ndertojnë një strukturë që duket sikur është në lëvizje të vazhdueshme. Deti nuk paraqitet si një element natyror, por si një personifikim i lëvizjes, ritmit dhe kujtesës. Kontrastet e theksuara mes toneve të ndritshme dhe të errëta që reflektohen në ujë dëshmojnë në rrjedhjen e jetës së njeriut. Artistja në këtë mënyrë lidh njeriun me detin me një pe të padukshëm. Njeriu personifikohet me anijët, kurse deti bëhet vetë jeta. Po përse gjinden më shumë se një anije? Sepse njeriu edhe pse është individ, ai nuk është kurrë vetëm.

Në serinë fotografike 85360, Lisa Nimanbegu i afrohet trashëgimisë kulturore përmes një perspektive intime dhe të përqendruar në detaj. Fotografia dokumenton momentet e punës së duarve që qëndisin dhe prekin stolitë tradicionale, duke e shndërruar këtë akt në një gjest simbolik të transmetimit të kujtesës kulturore. Objektet e arta dhe ornamentet tradicionale luajnë rolin e bartëseve të historisë, të identitetit dhe kulturës, e jo vetëm si paraqitje e thjeshtë të elementeve estetike. Titulli i vetë veprës në numra nuk është një praktikë e përditshme. Por çfarë janë këto numra? Numri 85360, si kod postal i thjeshtë që koordinon lokacionin e qytetit të Ulqinit në botë dhe shërben vetëm për orientimin gjeografik, në këtë vepër luan rolin e një dimensionit tjetër. Një dimension më të thellë konceptual që synon në lidhjen intime mes hapësirës, traditës, identitetit dhe përvojës personale. Në këtë mënyrë, fotografitë e Lisës, nuk dokumentojnë vetëm një traditë artizanale të Ulqinit, por edhe një proces të vazhdueshëm të ruajtjes dhe të reinterpretimit të identitetit kulturor.

Në diptihun *Vis Vitae*, Mersiha Resulbegović Mavrić ndërton një strukturë vizuale që lëviz mes abstraksionit dhe simbolikës figurative. Kompozimi vertikal dhe kontrastet e ngjyrave krijojnë një ndjenjë

tensionit dhe lëvizjeje. Forma qendrore, në anën tjetër, duket sikur shfaqet dhe zhduset brenda sipërfaqes së pikturës. Që nga titulli latin kemi të bëjmë me dy fjalë mjaft të mëdha dhe të gjëra në domethënije. "Vis" që do të thotë energji, forcë, pushtet, dhe "vitae" që do të thotë jetë. Vepra mbart një energji që pulson në mbrendshmërinë e saj. Ajo ka një frymëmarrje që lëviz nëpër shresat e saj të ngjyrave. Elementet e kuqe dhe të bardha krijojnë një berthamë energjike që sugjeron lëvizjen e vazhdueshme të jetës dhe transformimin e saj. Si diptih, vepra krijon një dialog mes dy pjesëve të kompozimit, duke sugjeruar idenë e dualitetit dhe të procesit të vazhdueshëm të ndryshimit të jetës së secilit prej nesh. Në këtë mënyrë, piktura shndërrohet në një reflektim mbi forcën e jetës. Ajo pezullon, ashtu sikur dhe individ, mes stabilitetit dhe transformimit. Pikërisht atë që karakterizon ekzistencën njerëzore.

Artistja e re e skenës artistike të Malit të Zi, Teodora Mirdita, sjell pikturën *Shoqe dhome*. Ajo nëpërmjet akrilikut në kanavac shëndron hapsirë intime të përditshme të dhomës, në një vend reflektimi mbi përvojën personale dhe mbi marrëdhëniet njerëzore. Ajo nxjerr intimitetin në publik, por jo vetëm atë të dhomës. Ambienti që rrethon figurat femërore krijon narrativën e jetës së zakonshme, ndërsa figura femërore janë ato që vëzhguesin e tërheqin në intimën e tyre. Në intimën e mendimeve, problemeve, ndjenjave dhe kompleksioneve rinore të tyre. Përmes paletës kromatike dhe formave të thjeshtuara, momenti i zakonshëm i përditshmërisë shndërrohet në një reflektim mbi hapësirën personale dhe mbi dimensionin emocional të jetës moderne.

Vahida Nimanbegu, me veprën *Kompozim*, eksploron gjuhën e abstraksionit përmes një strukture të ndërtaur mbi ritmin e formave dhe ndërveprimin e ngjyrave, duke e dëshmuar se arti nuk ka për detyrë të pasqyrojë realitetin, por të komunikojë ndjesi përmes elementeve të brendshme vizuale. Nuancat e ngjyrës së kaltërt, si ngjyrë dominante në këtë vepër, krijojnë një hapësirë reflektimi dhe meditimi. Në këtë mënyrë formohet një përvojë perceptivë që tejkalon kuptimin të fjalë për fjalë. Elementet e vogla të ngjyrave të tjera e gjallërojnë sipërfaqen piktorike ku format e tyre krijojnë një ndjenjë lëvizjeje të ekuilibruar të sponanitetit dhe të strukturës

Vahida Nimanbegu



të perfillur mirë në mendje. Ngjyrat nuk duhet të qendrojnë të izoluar, ashtu siç nuk duhet të qendrojnë as femra e izoluar. Ashtu si një ngjyrë e vetmuar humb fuqinë e saj perceptivë, ashtu edhe identiteti i femrës nuk duhet të paraqitet i burgosur, sepse ajo është si një dritë që merr kuptim vetëm kur reflektohet në hije dhe nuanca të tjera. Përmes kësaj qasjeje, piktura nuk përpqet të përfaqësojë një realitet të caktuar, por të krijojë një hapësirë përjetimi ku ngjyra dhe forma bëhen elemente të një gjuhe vizuale që komunikojnë përmes ritmit dhe ndjesisë.

Brenda kontekstit lokal të Ulqinit paraqitet edhe vepra e Gjovana Dediq, e cila përmes mediumit të tekstit e zgjeron fushën e praktikës artistike drejt reflektimit teorik dhe diskursit kritik mbi identitetin, kujtesën dhe përvojën kolektive shoqërore të femrës.

Nga kryeqyteti i Malit të Zi, nga Podgorica, artistja Ivanka Đonović ekspozon veprën e saj Pa titull. Vepra përfshin një kompozim të pasur me elemente floreale dhe forma organike që ndërthuren në mënyrë ritmike brenda një hapësire të qetë piktorike. Ngjyrat e një palette harmonike dhe motivet bimorë krijojnë një atmosferë poetike ku natyra shfaqet si një element qendror i përjetimit estetik. Artistja flet me një gjuhë lirike dhe organike ku nuancat e ngjyrës të gjelbërt mbizotërojnë në kompozim. Natyra gjindet në qendër të mendjes. Kjo zhvendosje e fokusit nga individ në natyrë, në fakt, luan një rol të dyanshëm. Si balans dhe disbalans, si një thikë me dy tehe. Në këtë mënyrë, krijimtaria e saj ndërton një dialog drejt një reflektimi më të gjerë mbi ritmin dhe ekuilibrin e jetës.

Në veprën *Së bashku*, por jo të njëjtë, artistja Kaltrina Hoti nga fshati Hot i Plavës ndërton një kompozim figurative ku marrin formë disa trupa njerëzorë të vendosur pranë njëri tjetrit si figurim i heshtsisë që bërtet në një melodi harmonike. Këto trupa e ndajnë një horizont por e mbartin njëkohësisht edhe individualitetin të personës së tyre. Përmes përdorimit të teknikës së përzier në kanavac dhe trajtimit të lirë të formës, krijohet një ritëm i qetë i kompozimit që synon në bashkëjetesën e dallimeve nderkulturore. Këto silueta të heshtura që ndajnë të njëjtën hapësirë mbartin frymen e tensionit midis afërsisë dhe dallimit. Një afërsi fizike por edhe dallim individual. Kjo vepër artikulon një reflektim të thellë mbi bashkëjetesën dhe temën e përkatësisë.

Përkatësisë gjinore, intelektuale dhe thjeshtë asaj njerëzore. Lindin pytet; "A përkas unë këtu?", "A është e mundur të jemi së bashku pa u bërë të njëjtë?" dhe "A mund të ndërtohet një komunitet ku individët ruajnë dallimet e tyre pa u ndjerë të përjashtuar nga tjetri?"

Pikërisht këtyre pyetjeve vepra e Kaltrina Hotit u përgjigjet përmes një gjuhe dinamike dhe domethënëse vizuale. Kaltrina në mënyrën e saj artistike shëndron figurat e thjeshta piktorike në një metaforë të fuqishme për solidaritetin, për respektin ndaj njëritjetrit dhe për mundësinë e një ekzistence të përbashkët që nuk kërkon njëtrajtshmëri, por mirëkuptim. Nga këto vepra artistike mund të përmbyllim se veprat artistike të artisteve femrorë nuk janë thjesht objekte vizuale në një hapësirë ekspozuese, por ura që lidhin. Ato janë në mundësi të lidhin kohën dhe hapësirën, të lidhin të kaluarën me të tashmen, si dhe individualen me shoqërinë e komunitetit.

Kjo ekspozitë na vërteton se distanca gjeografike nuk luan rol në identitetin e tyre kolektiv, sepse veprat artistike nuk njohin kohë as kufi, edhe pse atë e dëshmojnë. Si lumenj që rrjedhin nëpër male të ndryshme, veprat e grave dhe vajzave shqiptare kalojnë kufijtë fizikë dhe perceptivë, duke krijuar një rrjedhë të pandalshme të reflektimit, vetëdijes dhe afirmimit. Zëri i femrës, në gjithë shumëllojshmërinë e saj, nuk kërkon të dominojë. Ai kërkon të dëgjohet, të reflektohet dhe të bashkohet me të tjerët. Ai kërkon të ketë të njëjtën peshë sa e ka dhe zëri i mashkullit. Ajo kërkon barazi. Hiç më shumë, hiç më pak. Këtë barazi dhe e meriton. E meriton, si një gjë më të paktë që mund dhe duhet t'i ofrohet. Sepse ajo luajti shumë role gjatë jetës së saj. Rolin e bijës, rolin e gruas, rolin e nënës, rolin e intelektit në shoqëri, rolin dëshmuës... në një scenari shumë të gjatë e të tepruar. Ku mbeti roli i saj me të vërtetë real? Roli i vetvetës dhe i identitetit të personës së saj? Kur një zëri i bashkohet edhe zëra të tjerë, gruaja qëndron si shkëmb që nuk lëkundet nga stuhitë e jetës.

Veprimtaria dhe ekspozimi kolektiv të veprave artistike dëshmojnë në këtë shkëmbeje femërore. Në këtë moment arti nuk flet më vetëm në emër të një gruaje apo vajze. Ajo merr frymë si një organizëm i gjallë, ku zërat e tyre, dikur të shpërndarë dhe të heshtur, bashkohen në një hapësirë të përbashkët.

Studimi i gazetarit Rafael Floqi "Noli dhe Konica nën dritën e 'Diellit'" është një vepër e arrirë historiko-publicistike, e cila nxjerr në dritë, përmes shqyrtimeve dokumentare dhe bibliografike, dy nga figurat më të shquara, dominante dhe protagonistët absolutë të mërgatës shqiptare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës: Fan Noli dhe Faik Konica.

Ky studim mbart vlera historike, komunitare, mediatike, atdhetare dhe shoqërore, pasi përfshin një punë shumëvjeçare pasioni, përkushtimi dhe dedikimi ndaj këtyre kolosëve të kombit shqiptar. Në këtë studim serioz trajtohen në mënyrë të detajuar jo vetëm marrëdhëniet e ndërlikuara mes Nolit dhe Konicës, por edhe raportet e mërgatës shqiptare të Amerikës me atdheun.

Me një literaturë të pasur, gjuhë dhe stil të shkëlqyer, citime të bazuara në dokumente në disa gjuhë dhe dëshmi, informacion të imtësishëm dhe analizë të thelluar publicistiko-shkencore, si dhe me referenca nga burime amerikane dhe monitorim të kujdesshëm të artikujve të gazetës "Dielli", autori dëshmon një punë hulumtuuese disa-vjeçare, ndër më dinjtozet e botuara në dekadën e fundit mbi marrëdhënien e veçantë të miqve- "armi" Fan Noli dhe Faik Konica, të parë në një prizëm paralel sa psikologjik aq dhe njerëzor dhe artistik.

Marrëdhënia ndërmjet Faik Konicës dhe Fan S. Nolit përbën në vetvete një nga raportet më të veçanta dhe më polemike të shekullit të kaluar dhe këndvështrimi i ri psikoanalitik është një zbulim dhe arritje në studimet historiko letrare dhe i veçantë në letërsinë dhe historinë shqipe dhe botërore, duke u nisur nga fakti tek përgjithësimi.

Rivalitet dhe afrim, ndarje dhe bashkime, aleanca dhe përçarje, polemika dhe akuza, ironi dhe sarkazëm, idealizëm dhe pragmatizëm, si dhe ambicie politike – të gjitha këto elemente ndërthuren në këtë libër. "Noli dhe Konica nën dritën e 'Diellit'" ofron një analizë të shumfasetë: historike, psikologjike, kulturore, letrare dhe mediatike.

Gazeta "Dielli" jo vetëm që pasqyron me detaje veprimtarinë e Nolit dhe Konicës në një prizëm krahasues, por mbi të gjitha dokumenton idetë, ndarjet dhe bashkimet, polemikat e zjarra dhe konceptet mbi zhvillimin e Shqipërisë, si dhe rolin e Vatrës dhe të vetë "Diellit".

Libri trajton në mënyrë të veçantë marrëdhënien dhe përplasjen e këtyre dy figurave kombëtare me Mbretin Zog, vizionet politike të Nolit dhe Konicës, konceptet e shtetndërtimit dhe shtetformimit, politikës, filozofisë, moralit, ndërgjegjes dhe zgjimit kombëtar. Noli dhe Konica, si dy figura të fuqishme të mendimit, frymëzimit dhe veprimit kombëtar, edhe pse larg Shqipërisë, themeluan një shkollë të kulturës, politikës, letërsisë, moralit publik dhe ndërgjegjes patriotike shqiptare.

Libri "Noli dhe Konica nën dritën e 'Diellit'" na fton në thell në një reflektim mbi amanetin moral, shpirtëror dhe kulturor të Nolit dhe Konicës, mbi rëndësinë e trashëgimisë dhe themeleve të "Diellit", të Vatrës, të shtetit dhe të kombit shqiptar.

Duke përshkruar konfliktin krijues dhe kundërshtues të këtyre kolosëve, vepra paraqet rolin e jashtëzakonshëm të Fan Nolit dhe Faik Konicës si dy pika referimi për historinë kombëtare, identitetin dhe kulturën shqiptare, ndërgjegjen atdhetare dhe veçanërisht trashëgiminë shqiptare në mërgatën e Amerikës.

Noli dhe Konica trajtohen imtësisht si subjekte superaktive mediatike, atdhetare, politike dhe kulturore, me ndikim të fuqishëm në shekullin e kaluar dhe, pa dyshim, edhe në shekullin që vjen. Konica si intelektual kritik dhe Noli si fenomen

Rafael Floqi "Noli dhe Konica nën dritën e 'Diellit'"

Një kontribut i vyer historik por për mbarë mërgatën shqiptare në SHBA

Nga Sokol Paja
Editor i gazetës "Dielli"



kulturor e politik patën një marrëdhënie që prodhoi përplasje, admirim, vlerësim, konkurrencë, bashkëpunim dhe kundërshti, të cilat përbëjnë boshtin themelor të këtij libri, të parë në prizmin psikologjik dhe historik e letrar.

Një meritë e veçantë e librit qëndron në faktin se dy figurat madhore të kulturës dhe identitetit kombëtar shqiptar, Noli dhe Konica, trajtohen edhe në dimensionin e tyre njerëzor, karakterial dhe shpirtëror.

Siç shprehet edhe vetë autori Rafael Floqi, Noli dhe Konica nuk ishin vetëm shkrimtarë apo politikanë; ata ishin arkitektë të një kombi që po dilte nga errësira osmane drejt dritës evropiane. Secilit i takoi një rol thelbësor: Nolit ndërtimi i frymës së kombit, Konicës ndërtimi i formës së tij.

Temat themelore të librit, ngjarjet në Vatrë me Nolin dhe Konicën si protagonistë, polemikat përmes "Diellit", marrëdhëniet e tyre me Mbretin Zog, zhvillimet politike në Shqipëri në viteve '20-'30, çështje të historisë, letërsisë, gjuhësisë dhe identitetit kombëtar, prirjet politike dhe mjeshtëritë individuale, periudha e regjimit diktatorial, si dhe veprimtaria dhe ndikimi i tyre

kulturor e kombëtar, janë trajtuar nga gazetari Floqi me delikatesë, ndershmëri dhe elegancë, pa ngarkesë emocionale dhe me një distancë profesionale nga zjarri i përplasjeve të përgjithshme.

Fan Noli dhe Faik Konica përbëjnë dy referenca të jashtëzakonshme të kulturës shqiptare dhe të identitetit modern kombëtar.

Studimi i gazetarit Rafael Floqi "Noli dhe Konica nën dritën e 'Diellit'" është një kontribut i vyer historik jo vetëm për Federatën Vatra dhe gazetën Dielli, por për mbarë mërgatën shqiptare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

New York, 10 janar 2026



Noli dhe Konica, në dritën e "Diellit"

Si dy miq u bënë armiq,
dhe miq përsëri

Onufri

NË HIJET E DY KOLOSËVE: PSE KY LIBËR ËSHTË I DOMOSDOSHËM

Historia shqiptare ka dy figura që nuk ecin brenda saj si personazhe, por si drita dhe hija: Fan S. Noli dhe Faik Konica. Ata nuk janë vetëm dy emra të mëdhenj të kulturës sonë; janë dy mënyra të menduarit, dy botëkuptime, dy mjete me të cilat Shqipëria e fillimit të shekullit XX kërkoi të gjejë fytirën e vet. Në çdo epokë historike, ka njerëz që krijojnë vepra; në epokat e rralla, ka njerëz që krijojnë kombe. Noli dhe Konica i përkasin këtij lloji të dytë.

Ky libër nuk është thjesht një përmbledhje studimore, as një kronologji faktesh jetësore. Ai është një udhëtim i gjatë në shpirtin dhe mendjen e dy njerëzve që, me të gjitha dallimet, kundërshtitë, rezistencat dhe admirimet e tyre, ndërtuan themelet e identitetit modern shqiptar.

Noli u bë profeti i ndërgjegjes, moralisti i zjarrtë, zëri që kërkonte drejtësi përtej politikës. Konica u bë aristokrati i kritikës, mjeshtri i ironisë, diplomati i kulturës, njeriu që kërkonte të shëronte popullin e vet përmes mendimit të pastër dhe fjalës elegante.

Njeri u përpoq të shpëtonte shpirtin e kombit, tjetri mendjen e tij.

Ky libër i sjell bashkë jo për t'i pajtuar, as për t'i vënë në peshore, por për t'i treguar ashtu siç ishin: dy forca të epokës, dy shtylla që mbështetën të njëjtën urë, dy zëra që krijuan të njëjtën simfonie, edhe kur luanin nota të ndryshme. Marrëdhënia e tyre nuk është e thjeshtë, nuk mund të përkufizohet me fjalë të zakonshme si "miqësi" apo "armiçësi". Ajo është një lidhje e pazakontë, një tension i bukur, një duel estetik dhe moral që prodhoi dritë.

Në faqet që vijojnë, lexuesi nuk do të gjejë vetëm histori. Do të gjejë njeriun pas historisë: ambicien, dhimbjen, tejkalmimet, dyshimet, krenarinë, refuzimet, heshtjet dhe shpërthimet e dy mendjeve të mëdha.


Ky libër është një përpjekje për të kuptuar jo vetëm çfarë bënë ata, por edhe pse e bënë. Jo vetëm çfarë shkruan, por edhe çfarë heshtën. Jo vetëm çfarë lanë pas, por edhe çfarë ëndërruan e nuk arritën dot ta shohin.

Është një libër për dy njerëz, por në të vërtetë është një libër për Shqipërinë. Sepse historia e tyre është historia e dilemave të saj, e betejave të saj të brendshme, e përplasjes midis moralit dhe racionalitetit, idealizmit dhe skepticizmit, revokimit dhe ndërtimit. Noli dhe Konica nuk janë vetëm dy biografi; janë dy harta të shpirtit shqiptar.

Prandaj ky libër nuk është thjesht studim: është rikthim në një nyje të kulturës sonë, në një moment kur dy rreze drite u ndeshën për të krijuar një horizont të ri.

Dhe këto dy drita ende na ndriçojnë.

Nga Rafael Floqi



Bota do të ketë fatin e Amerikës. Është një bndjesi që nuk lidhet me ndonjë njohje apo shqyrtim të thellë të historisë, por me faktin kryesor të kohës ku jetojmë, se rendi ynë është rendi i ideuar, themeluar dhe organizuar mbi parime të gjithëpranuara, por nën aureolën e fuqisë amerikane. Dhe të modelit amerikan.

Ai rend sot po shpërbëhet, shembet, minohet dhe çmontohet nga vetë autorët e tij – Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Nga filozofia trampiste që ka bërë zëvendësimin paradigmatic të kredos amerikane: nga ajo e “qytetit mbi kodër” tek “Amerika e para”. Një kredo nacionalizmi që vepron në ndërgjegjen amerikane “të veçanësisë”, të kombit të domosdoshëm (të paktën deri dje), apo të një force të së mirës në botë.

Si erdhëm deri këtu? Cilat forca, cila psikologji, cilat shkaqe, emotive dhe objektive, sollën kompromentimin e “ëndrës amerikane”, e zgjuan botën dhe SHBA në truallin e njohur të realizmit dhe gjeopolitikës, të konflikteve periodike dhe tensioneve permanente? Është një pyetje që do të dojë kohën e vet për t’iu përgjigjur, në mos nuk do të marrë përgjigje kurrë, sikurse nuk ka një përgjigje as fundi i Romës. Por një hap i domosdoshëm është njohja e Amerikës, e indit të saj historik, e debateve të brendshme, krizave dhe rikthimeve.

Libri i ri i dr. Ernest Nastos ofron një mundësi të rrallë për lexuesin shqiptar që të rrokë më me lehtësi origjinalitetin amerikan, pikënisjet ideore, ideologjitet, ndasitë, e më në fund edhe aktualitetin që po dikton ndryshime radikale në mbarë botën.

Dr. Nasto paraqitet me këtë libër pas botimit të punimit të tij shumë të veçantë e me rëndësi “Një komb nën Zotin: besimi fetar dhe politika në Shtetet e Bashkuara”, një lloj historie fetare e superfuqisë botërore, që mbetet deri më sot i vetmi në këtë fushë në gjuhën shqipe.

Në dallim nga libri i parë, ky i tanishmi është një përmbledhje artikujsh dhe intervistash që nisin si kohë para mandatit të parë të Donald Trump e deri më sot, që mund të cilësohen si një lloj ditari politik i autorit. Të rimarra në një renditje tematike që përkon me debatin e sotshëm, ato ofrojnë një panoramë të qartë dhe mundësi depërtimi në arsyet e trazimit të SHBA.

Një libër mund të lexohet dhe përjetohet në mënyra të ndryshme, shënimet e një autori mund të befasonjë apo ndikojnë lexues të ndryshëm për arsye apo aspekte të larmishme. Por ajo që është e jashtëzakonshme në këtë përmbledhje është se historia amerikane përshfaqet në galerinë e popujve dhe shteteve si aspiratë e një kombi të themeluar mbi gërshetimin e disa ideve për botën dhe jetën, me një ndërgjegje fetare të implantuar në një tokë të re. Besimi fetar kristian dhe një vështrim manikeist i botës, krahas projektit kushtetues të etërve deistë të Shteteve të Bashkuara, përurojnë një traditë që dallon thellë nga çdo entitet tjetër të prezantuar në historinë e popujve.

Nuk ishte ekonomia, as siguria në vetvete që përcaktoi atë që Dr. Nasto e quan një ndër eksperimentet më të mëdha të njerëzimit, por edhe një meditim i thellë mbi natyrën e njeriut, mbi pushtetin, kontrollin e tij, përherë në funksion të lirisë dhe lumturisë.

Janë në libër një tërësi temash: dallimi mes revolucionit amerikan dhe atij francez, diskutimet për Kushtetutën me një parashtrim shumë interesant të imponimit të Kartës së të Drejtave nga anti-federalistët, mandej shqyrtimi mbi vetëperceptimin e

Dr. Ernest Nasto, NGA “QYTETI MBI KODËR” TEK “AMERICA FIRST”, Onufri 2026

KUJTIME DHE JETË NË NJË NARRACION TË MIRËFILLTË LETRAR

Nga Skerdilajd Zaimi

amerikanëve; besimi kristian, dy lëvizjet e mëdha gjallëruese të rolit fetar, ideja e fatit të qartë që ushqeu ekspansionizmin dhe gjeti vend në polemikën për mëkatën dhe providencën, këmbëngulja e aktivistëve të shumtë (si William Tyndale) të besëlidhja e Zotit me hebrejtë si analogji dhe shpjegim për fatin historik të amerikanëve, mandej “ungjilli i pasurisë” me befasishtë e mëdha të miliarderëve filantropë, apo progresizmi tradicional si lëvizje shumëgjyreshe që shndërroi peizazhin politik, të gjitha këto në suazën e një ëndrre dhe aspirate shumë të veçantë që nuk u vu në diskutim as nga një veprimtar i njohur i vonët, Martin Luther King.

Libri i z. Nasto nuk është megjithatë një histori e Shteteve të Bashkuara, që merret me të dhëna (edhe pse ato nuk mungojnë kur është e nevojshme të ilustrohen argumente të caktuar) apo analiza shkaqesh: ai nuk kërkon një dialektikë klasike të ngritjes, shkëlqimit dhe rënies. Kjo është një çështje

ekspertësh, progresistësh, nëse do të marrim ndikimin e tyre historik sipas librit që kemi në dorë. Amerika e temave të librit e ushtron gravitetin e vet ende si fuqi e së mirës, para së gjithash, si komb i diskutimit dhe mobilizimit të madh kulturor.

Dhe është ky tipar që shpjegon më saktë hyrjen në Luftën e Dytë Botërore, lëvizjet për të drejtat e njeriut, apo edhe kristalizimin si moment reagimi, të së Djathtës Fetare Amerikane, antimoderniste, antikomuniste e në fund edhe pretenduese e një “shumice morale”. Një term ky që mund të duket i panatyrshëm në pamje të parë për një vend kampion të kapitalizmit e të pushtetit të parasë.

Përmbledhja nuk është as thjesht një gjenealogji, pasi autori jep mendimet dhe komentet e veta, ai bën analizë e sugjeron edhe rrugëdalje, gjithnjë me besimin e thellë se Amerika është e pazëvendësueshme, si dikur stereja e kolonëve shpresëmirë të kësaj bote. Dhe e bën këtë me një koherencë

dhe intuitë për t’u vlerësuar, sidomos për trampizmin dhe arsyet e fitores së tij.

Sa për një shembull, artikulli “Miliarderi – shpëtimtar i masave punonjëse” komenton librin e JD Vance, “Elegji për katundarinë”, duke kapur debatin delikat rreth “gjendjes së punëtorit të bardhë” e duke parandjerë atë që u konsumua mandej në vitin 2025, kur Vance u bë numri dy i Shtëpisë së Bardhë.

Në fund, meriton vëmendje edhe fakti se libri vjen në shqip si shqyrtim i hollë dhe i vëmendshëm i SHBA, si një analizë që nuk tradhëtohet nga nevoja për të krahasuar zhvillimet e atjeshme me Shqipërinë, apo me përvojën e autorit në Shqipëri. Edhe pse ngjashmëritë nuk mungojnë.

Siç e thamë në nisje, askush nuk e di se ku po shkon Amerika. E rrjedhimisht askush nuk e di as se ku do të shkojë bota. Por për ata që si z. Nasto e duan dhe çmojnë Amerikën për gjithçka ajo solli në botë, duhet shpresuar se sikurse revolucioni amerikan u dallua për gradualitetin e vet dhe jo hysterinë e sivëllaut i tij francez, edhe ky eksperiment i jashtëzakonshëm i nisur gati 3 shekuj më parë, do të ketë hapësirë për të akomoduar me mençuri edhe trampizmin e sotshëm, që ka edhe ai arsye objektive se përse u shfaq.

“Pakicat me ngjyrë kanë bërë hapa të jashtëzakonshëm jo duke i përmbysur idetë themeluese të 1776-s, por duke iu drejtuar parimeve më të larta të tyre.”

Te ky pasazh, i sjellë nga libri, ndodhet, me gjasë, edhe çelësi i daljes nga një krizë që sot na duket të gjithëve shumë konvulsive.



Ëndërr e falur titullohet përmbledhja e me poezitë që ka zgjedhur vetë autori Resul Shabani për të na dhënë një antologji të jetës së tij dhe si poet. Po ç'është ajo? Ëndërra është një dhuratë që na vjen nga lart, si nga qiejt, kështu besohet, del nga fati, e fshehur nga vetë nënvetëdija. Të të falet një ëndërr, është një mënyrë për të thënë: "Të është dhënë një mundësi për të parë përtej reales." Dhe sa bukur kur kjo dhuratë është poezi! Ëndërra e falur është edhe një lloj frymëmarrjeje shpirtërore, do të thosha, por po aq edhe akt i mëshirës kozmike. Ëndërra bëhet edhe një falënderim i heshtur ndaj ekzistencës: "Faleminderit që më është falur të ëndërroj." Dhe ëndërra të bën edhe poet. Dhe e fal ëndërrën si poezinë, pra, e dorëzon – me kuptimin "që e lëmë pas" si diçka që jo se s'do ta kemi më, por e dhamë për të tjerë. Ëndërra është edhe dashuri, shpresë, vetë idealja, të shtrenjtat që mund të kemi dhe falja e saj është edhe akt lirie, i natyrshëm si ajo.

Poeti ishte krejt si bari, lexojmë në këtë antologji. Poeti Resul Shabani përcakton ëndërrën e tij, rolin krijues të saj, kredon. Ëndërra si besim ka edhe një kuptim më mistik, thirrjen për adhurim të vetë ëndërrës që na ngre mbi realitetin, të besojmë në atë bukuri "që do ta shpëtojë botën", sipas Dostojevskit, në fuqinë krijuese për të ndriçuar errësirën me dritë të brendshme. Dhe kjo s'është vetëm ëndërr. T'i lëmë mënjatë ëndërrat mashtruese, ankthin dhe tmerrin le t'ia lëmë urryetjes, por të dimë të duam. Këtë porosi na ka lënë edhe Shenjtja jonë Nënë Tereza, e cila lindi në Shkup, atje ku jeton dhe shkruan edhe poeti Resul Shabani.

Në thelb, *Ëndërr e falur* është një oksimoron poetik, sepse falja nënkupton edhe dorëzimin, ndërsa ëndërra nënkupton edhe dëshirën. Këto dy përvoja të larta të njerëzores bashkohen si në një pikë drite të poezia *Shfletim si në ëndërr*.

Në brigjet prej ëndërrë të liqenit të Ohrit, aty ku uji i derdhet zallit si kujtesë dhe lumi Drin merr jetë dhe bëhen këngë, poeti deshi ta dëgjojë botën me veshët e shpirtit. Zëri i Resul Shabanit vjen nga ato anë ku janë vendosur kufij që ndajnë edhe tokë edhe ujë, por jo frymë të ëndërrën. Quhet Maqedoni e Veriut – e Jugut për ne, shqiptarët, do të thosha – dhe aty ushtojnë ëmbël edhe meloditë e qëndresës dhe të identitetit. Në poezinë e Resul Shabanit vendlindja, atdheu, Ballkani, bashkohen dhe dhembin si një plagë, ndërsa Mesdheu frymon si horizont i hapur për bashkëjetesë dhe me poezi.

Poezia e tij është meditative dhe gjakon të përkorën, atë lloj heshtjeje që flet me agullimën e atyre vendeve, duke e bërë fjalën një akt sublim. *Shumëzohej nga të prekurit me sqep/ të zogut grabitqar, shumëzohej me fjalët e veta, dënes si grua/ pa turp*. Është poezia kështu dhe poeti bashkë. Zembrën "e vë në një pjatë me ujë të valë". Përfytyrimi i flijimit artistik, njeriu naimjan që digjet për të ndriçuar të tjerët. Kur thotë: *Çudi ishte poeti, krejt si ti, ai i kthen lexuesit pasqyrën* – për ta bërë pjesë të së njëjtës ndjesi e ndërgegjesim. Në poezinë *Drini i Zi* është lumi që bart mallin dhe historinë, por edhe poezinë: *Zbriti me ujë e me valë rrëmeti/ si zembrën pikëllimi e brehu tokën*. Këtu rrjedh jo vetëm uji, por edhe gjaku i jetës që kërkon lirinë e jetës. Drini bëhet metaforë e unitetit të copëtuar, mund të ndahen brigje, por jo ardhmëria. Ai mbledh vëllazërisht të gjitha dhembjet e Ballkanit dhe i shndërron në këngë. Në ujërat e tij sheh veten çdo vetvete, që rrjedh, por nuk shuhet. *Shën Naumi përfshin shpirt të vendlindjes, që magjeps me trupin që ka, zemër mbi zemra*. Hyjnia dhe njeriu, bukuria që ndriçon, por edhe djeg. *Nuk e di sa e bukur je, sirenë e Mesdheut, me alga detit mbuluar, me koralin e verdhë*. Kjo shtrirja largësive nga Ohri në Mesdhe, në këtë udhëtim, Ballkani i tij është dhe qendër e një universi që përzien besimin, artin dhe

Parathënia e vëllimit poetik "Ëndërr e falur" të Resul Shabanit

Kush mund të falë një ëndërr? Nga Visar Zhiti

dashurinë. Në poezinë *Zhulieta* edhe vdekja përmendet me një butësi tronditëse: *Si mund të jetë kaq e freskët vdekja/ në buzët e mia trëndafila?! Zhuljetë është vetë poezia*. Dashuria dhe vdekja nuk janë ndarje, por takim, ku çasti arrin përjetësinë. Ja, edhe *Hamleti me plis të zi dhe ...mos më thoni / se heshtja ime s'është urtësi*. Hamleti shqiptar mban kafkën e historisë së tij ndër duar, pa klithmë e përsiatje të thella, nën pelerinën e qetësisë. Plisi i zi bëhet kurorë, simbol i krenarisë që nuk kërkon sundim.

Ëndërr e falur shënon kulmin e një udhëtimi shpirtëror. Kur fjala bëhet lutje, çdo poezi është një rit i brendshëm katarsis. Në ciklin *Artefakte dafine* kujtesa shfaqet si peizazh mitik, ku *Dru e gur, zhur e valë/ vetëm ngjyrë dhe vetëm pikturë*. Realiteti si pikturë në lëvizje, ngjyra uji kullojnë si vegimet. Në ciklin *Erosi mbi mjegull* dashuria është dritë e butë pa vetmi. Në *Tri balada*, liqeni, nata dhe agimi flasin për qerthullin e pambarimtë të ndjenjës, ndërsa *Trishtim i vakët* sjell një melankoli të qetë që shndërrohet në kujtim e përshtirje. Që rrjedhin si ujë i thellë dhe nuk kërkojnë të befasojnë, por të zgjojnë. Nëpër vargje ndihet ritmi i brendshëm i gjuhës, fryma e malit dhe shushurima e liqenit, një melos



që pikon nga shpirti i fjalës amë. Në fund ai pohon me një besim të qetë: *Këmbët vetë përpara më shpien./ Do të arrij sidoqoftë...* Dhe kjo vetë është arritje. Resul Shabani është poet i gjuhës së tij dhe i heshtjeve që flasin, poet i urave të padukshme ballkanike, ku bie hija e legjendave. Poezia që na vjen prej andej, nuk është vetëm lexim, por dhe përvojë, mënyra më e bukur për të (mbi) jetuar.

Visar Zhiti
Tiranë, tetor 2025

RESUL SHABANI

Ëndërr e falur



Me parathënie nga
Visar Zhiti

OnufriPoezi

Shoqja ime e fëmijërisë së hershme dhe më pas shoqja e fakultetit të Filologjisë, Luljeta Gjini, Gërmenji vjen para lexuesit me librin e saj të dytë, një vëllim me skica e tregime, titulluar "Monologu i fustanit".

Nëpërmjet këtyre skicave e tregimeve lexuesi jeton një copë nga Gjirokastra e dikurshme, si vend dhe si komunitet personazhesh realë. Po ashtu edhe një pjesë të ishullit të Sazanit dhe të jetës së ushtarakëve dhe familjeve të tyre atje; natyrisht edhe pjesë nga Tirana, me jetën e saj studentore dhe artistike të kohës, me sallat e koncerteve të festivaleve, apo me vendin emblematik "Te Reklammat". Po edhe më gjerë, me zona të tjera të Shqipërisë si: Dukagjini, Lumi i Shalës, Bregu e vende ku rinia zhvillonte dikur aksionet e ndërtimit të hekurudhave.

Vëllimi karakterizohet nga natyrshmëria, vërtetësia, sinqeriteti i rrëfimit dhe frymëzimi. Vetkuptohet që tregimi rrjedh pa bariera, i kapur në një moment fatlum kujtimi, meditimi dhe frymëzimi njëkohësisht. Personazhet, më së shumti, janë realë.

Luljeta ka pasur fatin të jetojë në një mjedis letraro-artistik, duke pasur pranë vëllain e saj, kompozitorin e talentuar Kastriot Gjini dhe të fejuarin (bashkëshortin e saj) poetin e talentuar Fluturak Gërmenji, që shpesh poezitë e tij muzikoheshin nga K. Gjini duke krijuar një vatër artistike familjare që rriste mundësinë e përjetimeve letraro-artistike në shkallë më të gjerë.

Jo më kot vëllimi hapet me një skicë titulluar "Inicialet" e cila përbleh në vetvete, jo vetëm një titull kënge me kompozim të K. Gjinit, një tekst kënge me poezi të F. Gërmenjit, po edhe një emër ure, në këmbët e betonta të së cilës janë gdhendur inicialet e emrit të autores dhe të fejuarit të saj në kohën kur kanë qenë aksionistë. Pra, kemi një ndërkallje të jetës reale në botën letrare për të sjellë pranë lexuesit në mënyrë të rrjedhshme dhe elegante kujtime reale të njerëzve realë në mjedise letrare.

Gjirokastra vjen aq natyrshëm në faqet e këtij libri, sa faqet të duken të pakta dhe, për ne që kemi qenë në Gjirokastër në ato vite, sikur kërkojmë më shumë kohë e më shumë personazhe. Ja shtëpia e vjetër gjirokastrite ku familja e Shaqo Gjinit jetonte dikur, salloni me kolltuqe ku mjekët bënin konsultat për të përcaktuar kurën e Kastriotit, emrat e mjekëve si Vasil Laboviti, Zhusti, Pandovski, etj dhe infermieret si Rramania, Melpoja, Meri duke përshkruar seriozitetin, përkushtimin dhe kontributin e tyre për mjekësinë në atë qytet. Por këtë ajo e lidh edhe me historinë e një dashurie të thellë po të parelizuar për hir të paragjyqimeve mes doktor Pirros dhe infermieres Meri, e cila është një ngjarje reale dhe e njohur nga qyteti i atëhershëm, por që autorja e ngre në nivelin letrar të përshkrimit, duke e sjellë si një tregim të mirëfilltë.

Po le të kalojmë në një tjetër mjedis, po aq në mos edhe më interesant, sepse ka pasur veçorinë e të qenit territor ushtarak i izoluar dhe më pak i njohur nga të tjerët. E tillë është jeta e familjeve të ushtarakëve në ishullin e Sazanit. Përshkrimi i një prej udhëtimeve të saj të para nga porti i Vlorës për në Sazan, në një det shumëballësh, me një mot të trazuar në furtunë janë nga faqet më të bukura të librit me një prozë të arrirë e tërheqëse që mbajnë në tone të larta përshkrimin dhe tensionin e ngjarjes. Tregimi i përshtypjeve personale të jetës në ishull, të vështirësive që kalonin gratë e ushtarakëve atje, largësia nga pjesa tjetër e atdheut, po edhe bukuritë e pamata të natyrës në ishull, të mirat e klimës dhe sidomos dashamirësia, miqësia dhe solidariteti mes banorëve janë aureola që veshin me nostalgji dhe romantizëm jetën e kaluar atje. "Nuk besoj të shkoj më aty, thotë autorja në f.143 të librit, sepse më mungon ai për të cilin shkova dhe jetova në atë copë tokë në mes të detit, duke i bërë ballë një jetese sa të vështirë, aq edhe të bukur"

Libri është shkruar me dashuri dhe ka shumë dashuri brenda faqeve të tij:

Shënime për librin “Monologu i fustanit” të Luljeta Gërmenjit

KUJTIME DHE JETË NË NJË NARRACION TË MIRËFILLTË LETRAR

Nga Katjusha Pogaçi

Dashurinë e saj me bashkëshortin, poetin Fluturak Gërmenj, dashurinë e prindërve të saj, Shaqo e Krisanthi Gjini, dashurinë e vëllait të saj, kompozitorit Kastriot Gjini me A..., por edhe më gjerë. Dashuria për prindërit, për fëmijët, për një shoqe, për njerëzit e thjeshtë, për atdheun, për vendet e ndryshme ku ka shkuar, vende si Dukagjini, udhëtimet e rrezikshme me korrierat e dikurshme, por edhe përgjegjësinë e lartë dhe profesionalizmin e atyre shoferëve heronj që ua dilnin rrugëve thikë mbi humnera, etj., etj. Libri është një apoeteozë për ndjenjën e mirë, për njeriun, për rininë shqiptare.


Syza “Luledelet” i kushtohet të vëllait, Kastriot Gjini, jetës, pasionit të tij për muzikën, kompozimeve të tij, dashurisë për jetën, për prindërit dhe vajzën e tij të dashur dhe ikjen e parakohshme. Kompozitori i talentuar i këngëve të rinisë, këngë të cilat edhe sot këndohen e dëgohen me ëndje, janë në fondin e krijimtarisë më të mirë të atyre viteve. Portreti i prindërve është gjithashtu një tjetër stacion i dashur i Luljetës. Ajo i përshkruan ata dhe dashurinë e tyre me ngjyrat më të ndezura të kujtimeve dhe penës së saj.

Nga ana tjetër ajo është e shqetësuar edhe për gra që në marrëdhëniet në familje përjetojnë dhunën bashkëshortore dhe ka gjetur mënyrën si ta sjellë nëpërmjet penës së saj këtë shqetësim, ashtu siç sjell në një tregim të mirëfilltë dhe interesant, siç është “Monologu i Fustanit”, tregim mjaft i arrirë, i ngritur mbi bazën figurative të një fustani të animuar që bëhet dëshmi e tradhëtisë bashkëshortore, gjë që shpreh shqetësimin qytetar të autores për emancipimin dhe mbrojtjen e të drejtave të gra.

Proza e Gërmenjit ka disa veçori të dallueshme, si: të qenit një prozë e rrjedhshme, që shfrytëzon detajet jetësore në dobi të pasqyrimin artistik, që sjell informacion përshtatur në kohën të cilën e merr në shqyrtim për vende, njerëz e ngjarje që rrëfen. Ka gjuhë të rrjedhshme, figuracion të pasur, është shkruar me shpirt, mall e dashuri.

Është fakt që Luljeta ka jetuar mes dy artistëve, që krahas arsimimit përkatës për gjuhë-letërsi, i ka dhënë asaj vetëdijen të ushtrorë me sukses prozën e shkurtër duke sjellë krijime të freskëta që lexohen me ëndje dhe me një frymë.

Tiranë, më 26 mars 2026



Zija Çela nderohet me Çmimin Mbarëkombëtar Letrar “At Zef Pllumi” për veprën “Koka mbi katror”

Zija Çela nderohet me Çmimin Mbarëkombëtar Letrar “At Zef Pllumi” më 7 prill, për veprën “Koka mbi katror”, me motivacionin: “Për ndjeshmërinë e spikatur ndaj krijimtarisë artistike të bashkëkohësve të tij, për leximin e thellë dhe të gjithanshëm të një epoke të tërë përtej kufizimeve formale, si dhe për ruajtjen e freskisë së gjykimeve estetike. Në këtë vepër ndërthuret në mënyrë harmonike këndvështrimi i krijuesit me kërkimin e vëmendshëm të lexuesit, duke ofruar një qasje pozitive që nxjerr në pah vlerat e mirëfillta letrare dhe rolin e tyre të rëndësishëm në formësimin e ndërgjegjes njerëzore.”

Dëgjoj dhe lexoj shpesh të ceket termi Originalitet; dhe kjo thuhet e shkruhet me një lehtësi që të habit. Por ndërsa merr në dorë pastaj aksh libër, prozë e poezi, konstaton se fjala, termi, nuk janë kund... Doemos, është një qëllim i lartë dhe një arritje e madhe të ketë origjinalitet në krijimtari. Originaliteti ka të bëjë me vetë qenien e krijuesit, nga vjen, çfarë ka përjetuar, ç'kulturë e vizione ka për botën; mandej shfaqet në tematikën e parapëlqyer, imponohet me teknikat që aplikon, lartohet me gjuhën që përdor, shkon deri te kujdesi për detajet. E megjithatë, përtej këtyre nënvizimeve, origjinaliteti vjen me shfaqjen e autorit, buron më së pari nga talenti i lindur, a thua janë të njëkohshëm; përndryshe, krijimtaria nuk do të ishte me interes për publikun.

"Dy udhë u ndanë në pyll/ dhe unë mora atë që s'ishte rrahur shumë. Dhe ajo solli gjithë ndryshimin." Janë vargje të njohura të poetit amerikan Robert Frost. Më parë, ishte Esenini që shkruante: "Këndo vetë, qoftë edhe si bretkosë." Kurse Dostojevski thoshte: "Ndjej frikë, frikë nga të ngjasuarit me të tjerët." Originaliteti rëndom ndan klasin e krijuesve. Mund të ketë shumë arsye apo shpjegime përse një krijimtari mund të jetë apo mund të quhet e cilësuar dhe përse një tjetër mbetet thjesht në kufijtë e tentativës. Shpjegimet mund të fillojnë me shkallën e talentit dhe të përfundojnë me fatin vetjak të krijuesit. Gjithsesi, një prej argumenteve më të rëndësishme në këtë temë, është pikërisht veçanësia, origjinaliteti, pangjashmëria me të tjerët, shkurtazi dukuria e patjetërsueshme e krijimit të profilit artistik.

Më duhet ta them me droje - ndoshta do të doja të mos e thosha - por sot, një mungesë e frikshme origjinaliteti e gjetjesh, ka ngritur një perde mosbesimi midis krijuesve dhe lexuesit; në të gjitha zhanret, sidomos në poezi. Në një vështrim sa më realist dhe të patrazuar nga teoritë e pafund, krijimi artistik që lë gjurmë dhe mbetet, është një punë e pavarur, me tipare të dallueshme, fryt i kërkimit të formave dhe shprehive origjinale, pa imituar (pa le më kopjuar) ndokënd. Gjetja artistike dhe kombinimi i ideve, prurja e një gjëje të pashkruar a shfaqur më parë, guximi për te e çuditshmja, përkryerja në çdo hap të krijimit, këto dhe të tjera qasje janë shanset që një vepër të mund të jetë interesante, tërheqëse, por edhe jetëgjatë.

Originaliteti në të shkruar i jep autorit dhe veprës së tij një zë e tingëllim të veçantë, asish që të mos jetë asnjëherë monotone, por veç intriguese, ndërkohë që, me raste, nxit fantazinë e lexuesit a shikuesit, krijon fushë për debat, e grish atë në meditim, ndoshta e bën edhe të ndjehet pak bashkautor. Një nga të fshehtat më të mëdha pse na pëlqejnë disa krijime, pse ato jetojnë shumë dhe bëhen pjesë e përjetimeve njerëzore edhe pasi e kanë konsumuar gjatë lavdinë e tyre, është pikërisht origjinaliteti, gjëja e veçantë dhe interesante që, në një kuptim, identifikohet me vetë autorin. E vështirë për çdo shkrimtar e artist të lërë gjurmë, nëse ai nuk ka mundur të krijojë dot profilin e vet artistik. E di që ky pohim shpërndan pak trishtim, por s'ka Zot që ta kthejë mbrapsht.

Në botën e madhe të artit dhe në historinë e ndritur të tij, janë shquar gjithnjë, në kohën e tyre apo më pas, shkrimtarët dhe artistët që bashkë me veprën kanë "firmosur" edhe veçanësinë e tyre. Don Kishoti i Servantesit, të paktën prej pesë shekujsh, na mahnit me bukurinë e vet; tashmë romani është cilësuar si një nga librat më të lexuar ndonjëherë në kohëra, është ekranizuar pafundësisht, është dramaturgizuar, është bërë balet. Performimi i tij në kaq shumë arte, flet vetiu për një gjetje të jashtëzakonshme, por që është përcjellë nga një mjeshtëri e madh, i cili tregon aq bukur dhe në mënyrë krejt të veçantë. Peneli magjik dhe ngjyrat dehëse të Van Gogut mund të qëmtohen nga kushdo, edhe në mos pastë ndonjë kulturë të madhe. Po ashtu, besoj, muzikën e Bethovenit, shumëkush e dallon lehtësisht nga krijimtaria e të tjerëve.

Po të përpqesha të shkoja më tej në këtë galeri autorësh e veprash, në thellësi të kohërave apo edhe në dekadat e cilësuar moderne, nga Homeri te Shekspiri, nga Tolstoi e Çehovi te Tueni, nga Heminguej e Xhojsi te Kafka e Markezi, do të humbisja fillin... Rëndesa që bie vlerësimin, s'është e thënë të jetë e shënuar diku, e deklaruar - krijuesi nuk thotë ja ku i

Fjalë për origjinalitetin

Nga Vangjush Saro



kam dukuritë në fjalë - sepse ato shkrihen në vepër në atë mënyrë që lexuesi, spektatori, ta ngjërojë e ta ndjejë të bukurën pa qenë nevoja për shpjegime apo qasje të sforcuara. Veçanësia mund të lexohet pikësepari në tematikën që autori sjell dhe në gjinitë e zhanrin që preferon; si të thuash, një shkrimtar i mirë dhe i veçantë ndjen, kërkon dhe gjen "territorin" e tij... Stili i të shkruarit, mënyra se si tregon, skemat që përdor, gjuha, figuracioni, shpërfillja e normave të ngurta, etj. e bëjnë atë tërheqës dhe ndonjëherë shënojnë edhe shkollë letrare.

Disa nga emrat më të spikatur të Letërsisë Shqipe mund të dallohen menjëherë për nga stili, tematika dhe qasja në realitet: Çajupi, Migjeni, Paradedi, Kadareja. Kushdo që mund të vinte në dyshim këtë konstatim, sado kokëfortë po të ish, do të mund të dallonte menjëherë autorët e mesipërm: Për nga tematika ku fokusohen, për nga zhanri që kanë përzgjedhur, për nga teknikat letrare që përdorin, për nga gjuha dhe stili krejt i veçantë. Në vështrimin e autorit të këtyre radhëve, këto veçori, "sekrete" në mund t'i quajmë këtë konstatim, gjenden të shkruara në vepër, njëfarësoj janë vetë krijimtaria.

Lektisjet e Lasgushit donin një varg të shtruar, të qetë, me shumë përkujdesje e përkëdhelje, për nga rima dhe gjuha. Zhgënjimet dhe fryma protestuese e Migjenit kërkonin tjetër grintë, natyrisht edhe tjetër gjuhë e stil. Dhe ai bashkoi në një mbresat e errëta nga një realitet i vështirë, leximet, ëndrrat, mendimin për të ardhmen... Është gjithnjë më bindëse dhe, sigurisht, jeton më gjatë një krijimtari që menjëherë njëmendësohet me emrin e autorit. "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", "Kronikë në gur", "Dimri i madh", "E penguar", "Darka e gabuar" etj., e bëjnë lexuesin të kuptojë menjëherë kush është autori.

Kam rastin të përsëris çfarë kam shkruar edhe më herët për Ismailin tonë, mungesën fizike të të cilit e ndjejmë aq shumë. Ai erdhi në letërsi me një frymë krejt tjetër, në tematikë, në terma, në konceptimin e jetës, në guxim... Po. Ishte një autor që guxoi, në përmbajtje dhe në formë. Koha që shkon, e vërteton edhe më shumë veçanësinë e tij, sa edhe guximin për të thyer monotoninë dhe frikërat e drojen e kohës. E di që disa (për fat të keq, ndonjëherë edhe asish që quhen krijues) nuk arrijnë t'i dallojnë e vlerësojnë këto dhe kërkojnë nga ai "t'i binte murit me kokë". Ndonjëherë, më vjen t'i pyes: Ku ishin këta (trima pas lufte) kur një personazh i tij i thotë një komunisteje të vjetër: "Na merrzitët me këtë Stafetën e Revolucionit! Mbajeni se nuk e duam." (Dimri i madh) Ku ishin ata kur ai shkruante: "Iknin e vinin ushtritë nën indiferencën e plotë të qytetit." (Kronikë në gur) Ku ishin ata kur ai vinte në gojë e një bejlereshe fjalinë: "Kur ata t'i marrë malli për ne, atëherë do të ketë ardhur fundi i tyre." (Nëntori i një kryeqyteti) Ku ishin ata kur ai nxirrte nga shpirti baladën "Mësueset e fshatit"? Ku ishin ata kur në Pallatin e Madh të Kulturës, në një plenum famëkeq të LSHA (fillimi i viteve '80) e

kryqëzuan për romanin "Nëpunësi i pallatit të ëndrrave"? Etj. Pa debat, se nuk ka vend për një gjë të tillë kur ke të bësh me një gjeni; thjesht u them merreni më shtruar, më butë, më qetë...

Petro Marko, ishte një tjetër mjeshtëri i prozës së gjatë, me një profil të spikatur, një këngëtar i lirisë, i dashurisë dhe i natyrës komplekse njerëzore, një shkrimtar që shpalo shumë përvojë, duke përfshirë ndërkaq në prozën e tij elemente moderniste dhe duke iu përgjigjur me stil dhe profesionalizëm kërkesave aluçinante të kohës e të shkollës së Realizmit Socialist. Ashtu siç thotë me të drejtë studjuesi Behar Gjoka, "në narrativen e prozës romanore të Petro Markos, rrëfimi fiton njëfarë distance nga ngjarjet". ("Hasta la vista", "Qyteti i fundit") Po ashtu, Jakov Xoxa, nga krijimtaria e të cilit dallon romani "Lumi i vdekur", vjen me një prozë bindëse, të shtruar, realiste dhe plot ndjeshmëri artistike, solide në të gjitha komponentet e gjinisë; një autor shumë origjinal. Duke folur për episodet e dashurisë në këtë vepër, studjuesja Klara Kodra vë në dukje se si "dashuria erotike përkruhet me guxim, madje edhe me një lloj sensualizmi, po ky i fundit mbetet i shëndetshëm si në folklor". E gjithë krijimtaria e Xoxës, në tematikë, në mënyrën se si shtjellon episodet, në peizazhet e vizatuara me aq kujdes, në përpjekjen maksimale për të vizatuar karakteret, e bën atë një nga autorët më të veçantë të Letërsisë Shqiptare.

Gjithë në këtë vijë të bisedës, krejt ndryshe nga shumë e shumë prozatorë të kohës, erdhi Qamil Buxheli, një satirist i lindur; humori dhe ironia ishin (nëse mund ta themi kështu) të përfjalshme në krijimtarinë e tij. (Kujtojmë që një pjesë e mirë e krijimtarisë së tij u ndalua, duke filluar nga drama "Dueli" dhe më pas romani "Kur qesh tërë qyteti".) Tregimi i tij "Stenograma e një fjalimi", që më vonë u inskenua nën titullin "A doni më për Belulin?", pothuaj një mono-komedi, mbetet një model ekselent i të shkruarit, i të bërit humor në mënyrën më të kulturuar dhe për çfarë e vlen, i qasjes në tema të rëndësishme dhe i vizatimit në perfeksion të karaktereve njerëzore. Trendi qesëndisës në film "Historiani dhe kameleonët" (realizuar sipas romanit "Karriera e z. Maksut") vjen në kohë: tenderat, shatërvani, burgu, gostitë, dhuratat, rendja marrëzish për të hyrë në histori, etj. Janë të gjitha në rendin e ditës...

Në fund të viteve '70, u shfaq në Letërsinë Shqipe një tjetër prozator i veçantë, Nasi Lera. Ndalea në tema të mprehta, ku mund të veçohej përpjekja për të hyrë në jetën intime të njeriut, droja për tjetërsimin e tij, lufta (e kufizuar) për më shumë dinjitet, etj. ishin disa nga rreket e veçanta. Në tregimet e tij ka shumë jetë, ka vërtetësi, dialogë të bukur e në një intensitet të vazhdueshëm. Në prozën e Lerës shoh një qetësi prej njeriu të mençur e një qëndrim aq qytetar. Ishte edhe për këtë që ai tërhoqi vëmendjen e kineastëve. (Kujtoj filmat "Duaje emrin tënd" dhe "Telefoni i një mëngjesi" të regjisorëve

Kristaq Mitro e Ibrahim Muçaj, "Të shoh në sy" të regjisorit Mevlan Shanaj, etj.)

Një nga autorët që në fillim të viteve '90 zgjoi interesin e publikut të gjerë, kinemasë, por edhe botuesve të huaj, është Fatos Kongoli. Ka disa tipare ku mund të ndaleshim, por po veçoj njërin, atë të ndjesisë njerëzore në formën e kujtesës, përqeshjes dhe faljes; veças në temën e së shkuarës. Kjo ishte ndryshe nga shumë autorë të tjerë që, të fiksuar tek anë e errëta të së shkuarës, e rëndojnë dhe e skajojnë atë dhe episodet e saj. Këta autorë nuk përpqen asfare të qëndrojnë në prapaskenë e të lënë personazhet të veprojnë, të flasin, të ndjejnë; ata lëshohen kokë e këmbë në subjekte të stërshkruara pa u fshehur aspak dhe pa e kamufluuar fare urrejtjen e cinizmin. Ndryshe nga ata, te Kongoli e vërteta e kohës rrëfhet ftohtë, hidhur, zbulohet me një ndjesi të rezervuar, sikur autori të ishte vetë në ato që tregon dhe në të njëjtën kohë jo, nuk është, po tregon për një botë shumë të largët dhe që vërtet nuk duhet të rishfaqet më në jetët tona, në përvojat e mëtejme.

Duke hedhur një vështrim kërkues e dashamirës edhe tek arte të tjera, në dekada, mund të thuhet me bindje se gjithnjë janë përcjellë në publik vepra që kanë manifestuar veçanësi, duke mbijetuar në rrethana delikate. Dalloheshin menjëherë punët e Vangjush Mios, sikundër më pas ato të piktorit Sali Shijaku, etj. Me një vështrim të parë, sot mund të shquash stilin e veçantë të piktorit Artur Muharemi; sikundër ndjehet veçanësia e Vlash Drobonikut. Disa nga kineastët tanë gjithashtu kanë lënë gjurmë më së pari për shkak të stilit dhe faktorit vetjak. Viktor Gjika pëlqente temat e "mëdha", tablotë epike ("Nëntori i dytë", "Përballimi"); Dhimitër Anagnosti e qëndiste filmin gjer në sekucenën e fundit dhe në lojën e aktorëve kishte kërkesa maksimale ("Në shtëpinë tonë", "Përrallë nga e kaluara", "Gjoleka, djali i Abazit"); Piro Milkani kujdesej që në filmat e tij të kishte gjithnjë humor dhe optimizëm; ("Çifti i lumtur", "Zonja nga qyteti", "Trishtimi i zonjës Shnajder"). Kristaq Mitro e Ibrahim Muçaj u dalluan për frymën lirike në filmat e tyre; ("Apsionata", "Duaje emrin tënd", etj.) Esat Musliu u qas në drama të forta dhe me një sfond klasor; ("Hije që mbeten pas", "Nata"). Albert Xholi mund të veçohet për trajtimin e temave sociale dhe të jetës reale, sjellë në ekran me aq thjeshtësi; ("Familja ime", "Shkëlqim i përkohshëm", "Jeta në duart e tjetrit", etj.) Në kinemanë e sotme, pikati menjëherë kinoregjisorit Gjergj Xhuvani; dramës i dha ngjyra groteske dhe lojës së aktorëve një përsosmëri që kishte munguar më parë ("Parrullat", "I dashur armik", etj.)

Një vepër origjinale krijon edhe hapësira për të zgjeruar interesin social e kulturor rreth saj; ajo i ka të gjitha mundësitë të qëndrojnë bindshëm në treg dhe në mendjen e njerëzve, të rivijë herë pas here; ajo zgjon interesin e kineastëve dhe të botuesve të huaj. mund të duket sikur tretet për një kohë, por është gjithnjë atje, vlen e kujtohet... Të qenit i veçantë, me fjalë të tjera krijimi i një profili artistik, mbetet gjëja më e rëndësishme për çdo krijues, shkrimtar apo artist; është ajo çka e dallon nga të tjerët dhe e bën jetëgjatë krijimtarinë e tij.

Në këto radhë, u përpoqa të jap ndonjë opinion, të shfaq disa mendime, pa marrë përsipër të vë kufij apo të skicoj ose të çoj më tej ndonjë teori; është thjesht një vështrim mbi terma që e vlej në vëmendjen. Shënimet tona janë ndihmesa përmes të cilave besojmë se zgjerohet edhe më tej pamja e Letrave Shqip, e krijimtarisë artistike dhe e autorëve të veçantë, në dekada të ndryshme. Dhe vetëm kaq. Sigurisht, jeta letrare dhe ajo artistike, veprat dhe autorët, janë më shumë se kaq; dinamikën që karakterizon zhvillimet e sotme (dua të them të disa dekadave) nuk mund ta shterojmë në pak radhë, çka nënkupton se mund t'i kthehem kësaj teme sërish, me emra të tjerë, por pa harruar kurrsesi që përshtypjet gjithnjë janë vetjake. ("Një libër apo një histori mund të shihet në aq shumë versione, sa ka lexues... Kushdo merr atë çka do prej saj dhe për rrjedhojë, ndryshon matja e saj." Xh. Stejnbeq)

*Emrat e autorëve të huaj janë shkruar sipas parimit të shqiptimit. Faleminderit për mirëkuptimin.

Harold Jamieson-i, dikur kryeinxhinier në Drejtorinë e pastrimit të qytetit të Nju Jorkut, e shijonte jetën si pensionist. Nga rrethi i tij i vogël i miqve kishte mësuar se jo të gjithë e bënin këtë, ndaj e konsideronte veten me fat. Ai kishte një parcelë prej rreth një akri në Manhattanin e Veriut, të cilën e ndante me disa entuziastë të tjerë të kopshtarisë; kishte zbuluar Netflix-in dhe kishte lexuar tashmë shumë nga librat që gjithmonë kishte dashur të lexonte. Ende i mungonte gruaja e tij, e cila pesë vjet më parë kishte vdekur nga kanceri i gjirit, por, përveç kësaj dhimbjeje të vazhdueshme, ai bënte një jetë të kënaqshme. Çdo mëngjes, para se të çohet nga shtrati, i kujtonte vetes se duhej ta shijonte ditën.

Në moshën gjashtëdhjetë e tetë vjeçare donte të besonte se kishte një rrugë të gjatë përpara, por e kishte të pamundur të mohonte se ajo rrugë kishte filluar të ngushtohet. Pjesa më e mirë e ditëve të tij - për sa kohë që nuk binte shi, borë apo nuk bënte tepër ftohtë - ishte shëtitja prej nëntë blloqesh deri në Central Park pasi hante mëngjes. Edhe pse kishte telefon celular dhe përdorte një pajisje portative (nga e cila, në fakt, ishte bërë i varur), ai ende preferonte ta lexonte *Times*-in në letër. Në park ulej rehat në stolin e tij të preferuar dhe i kushtonte një orë gazetës, duke i lexuar të gjitha rubrikat nga fillimi në fund dhe duke thënë me vete se po kalonte nga sublimja te absurdja.

Një mëngjes në mes të majit, kur moti ishte paksa i freskët, por gjithsesi mjaftueshëm i ngrohtë për t'u ulur në stol dhe për të lexuar gazetën, ai ngriti sytë nga gazeta dhe pa me bezdi një mesoburrë që u ul në skajin tjetër të stolit të tij, megjithëse përreth kishte plot stola krejtësisht bosh. Burri që pushtoi hapësirën e mëngjesit të Jamieson-it dukej të ishte mes dyzet e pesë dhe pesëdhjetë vjeç, as i pashëm e as i shëmtuar, në fakt, krejtësisht i zakonshëm. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për veshjen e tij: një palë atlete shëtitjeje nga New Balance, xhinse, një kapele me logon e Yankees dhe një bluzë me kapuç, po ashtu me Yankees, me kapuçin e ulur.

Jamieson-i e shikoi me padurim dhe u përgatit të zhvendosej në një stol tjetër.

"Mos ikni, tha burri. "Ju lutem. U ula këtu sepse duhet t'ju kërkoj një nder. Nuk është ndonjë gjë e madhe, por ju paguaj për këtë." Ai futi dorën në xhepin e madh të përparmë të bluzës dhe nxori një kartëmonedhë prej njëzet dollarësh.

"Nuk u bëj nder të panjohurve, tha Jamieson-i dhe u ngrit në këmbë.

"Por pikërisht kjo është ideja - që ne të dy jemi të panjohur. Ju lutem, më dëgjoni çfarë kam për të thënë. Nëse thoni jo, do ta pranoj. Por ju lutem, më dëgjoni njëherë. Ju mund të... " Ai u kollit dhe Jamieson-i e kuptoi se burri ishte i shqetësuar. Ndoshta më shumë se kaq - i frikësuar. "Ju mund të më shpëtoni jetën."

Jamieson-i u mendua paksa dhe u ul sërish. Por sa më larg burrit tjetër që mundej, pothuajse në cep të stolit.

"Do t'ju jap pak kohë, por nëse ajo që thoni tingëllon marrëzi, do të iki. Dhe futni paratë në xhep. Nuk më duhen dhe nuk i dua." Burri e shikoi kartëmonedhën sikur të ishte i habitur që po e mbante në dorë, pastaj e futi sërish në xhepin e bluzës. Vendosi duart mbi kofshë dhe vështrimin e mbante aty, në vend që të shikonte Jamieson-in.

"Jam alkoolist. Esëll prej katër muajsh. Katër muaj dhe dymbëdhjetë ditë, për të qenë më i saktë."

"Urime, tha Jamieson-i duke lënë përshtypjen se e tha me gjithë mend, por në fakt nuk ishte ndier kurrë më i gatshëm të çohet. Madje edhe të largohej nga parku, po të ishte e nevojshme.

Burri dukej normal, por Jamieson-i ishte tashmë në një moshë që e dinte se marrëzitet nuk shfaqeshin gjithmonë menjëherë.

"Jam përpjekur tri herë të tjera, dhe një herë ia dola ta lë pothuajse një vit të tërë. Kam një ndjenjë se ky mund të jetë shansi im i fundit. Jam në AA. Kjo do të thotë..."

"E di çfarë është. Si quheni, zotëri "Esëll-prej- katër muajsh"?"



STEPHEN KING

Hapi i pestë

Përktheu: Qerim Raqi

"Më quani Jack. Mjafton. Në AA nuk përdorim mbiemra." Këtë e dinte edhe Jamieson-i. Një mori personazhesh në serialet e Netflix-it kishin probleme me alkoolin.

"Dhe çfarë doni të më kërkon, Jack?"

"Tri herët e para që u përpoqa, nuk kisha sponsor në AA - dikë që të më dëgjoj kur kam nevojë të flasë, që u përgjigjet pyetjeve, ndonjëherë të më thotë çfarë duhet të bësh. Këtë herë e kisha një të tillë. E takova në takimim e mbrëmjes në Bowery dhe më pëlqeu shumë ajo që tha. Dhe mënyra si sillje ai, nëse e kuptoni çfarë dua të them. Esëll prej dymbëdhjetë vitësh, i qëndrueshëm, punonte shitës, ashtu si unë.

Ai ishte kthyer nga Jamieson-i, por tani sërish uli sytë poshtë.

"Isha një drejtues i mirë. Për pesë vjet isha shef i departamentit të shitjeve në... mirë, s'ka rëndësi, ishte një punë fantastike, ju me siguri e njihni firmën. Ishte në San Diego. Tani shes kartolina dhe pije energjike për dyqanet e lagjes këtu në qytet. Shkalla më e ulët, pra."

"Bjeri shkurt, tha Jamieson-i, jo pa dashamirësi; ishte bërë paksa kureshtar pa vullnetin e tij. Rrallë mund të ndodhte që ndonjë i huaj të të ulej në stol dhe të fillonte të fliste kështu. Aq më pak në Nju Jork.

"Doja të shihja si po ia dalin ata në Mets. E kanë nisur mirë sezonin, - tha Jacku dhe fërkoj gojën me pëllëmbë. "Më pëlqeu ai tipi që takova në takimim e mbrëmjes, ndaj mora guximim dhe, pas një mbledhjeje, i kërkova të bëhej sponsori im. Kjo ishte në mars. Ai më shikoi me kujdes dhe tha se do ta bënte këtë, por vetëm me dy kushte. Që të bëja gjithçka që më thoshte dhe që ta telefonoja nëse më vinte dëshira për të pirë. Atëherë do t'ju telefonoj çdo mbrëmje të mallkuar, i thashë. Ai tha: më telefono çdo mbrëmje të mallkuar atëherë, dhe nëse nuk përgjigjem, lëre mesathin në sekretari. Pastaj më pyeti nëse kisha filluar me dymbëdhjetë hapat. A i njihni këta hapa? "Përafërsisht". I thashë që nuk i kisha filluar. Ai tha se, nëse doja ta kisha si sponsor, duhej të filloja me ata hapa. Tha se tre të parët ishin njëkohësisht më të vështirët dhe më të lehtë. Në thelb më thonë vetëm se nuk mund ta ndaloj pirjen e alkoolit me forcat e mia, por me ndihmën e Zotit, ndaj duhet ta lejoj të më ndihmojë."

Jamieson-i gërthiti lehtë.

"I thashë se nuk besoja në Zot. Ky tipi - quhet Randy - tha se nuk i bëhej vonë nëse besoja apo jo. Tha se gjithçka që duhej të bëja ishte të ulesha në gjunjë çdo mëngjes dhe t'i lutesha këtij Zoti, të cilin nuk i besoja, që të më ndihmonte të qëndroja esëll edhe

një ditë. Dhe nëse nuk pija, tha, duhej të ulesha sërish në gjunjë para se të filja dhe ta falënderoja Zotin për një ditë pa alkool. Randy më pyeti nëse isha i gatshëm ta bëja këtë, dhe unë thashë po. Sepse ndryshe do ta humbisja. Më kuptoni?"

"Sigurisht. Ishe i dëshpëruar."

"Pikërisht! Dhurata e dëshpërimit, kështu e quan AA-ja. Randy tha se, nëse nuk i thosha ato lutje por vetëm shtiresha sikur i thoja, ai do ta dinte këtë. Sepse vetë kishte kaluar tridhjetë vjet duke gënjyer për gjithçka.

"Pra u lute? Edhe pse nuk besoja në Zot?"

"Po. Dhe funksionoi. Sa i përket mosbesimit tim në Zot... sa më gjatë që qëndroja esëll, aq më pak i sigurt jam për këtë."

"Nëse do të më kërkon të lutem bashkë me ju, harrojeni, tha Jamieson-i.

Jack-u buzëqeshi dhe shikoi poshtë kah duart e tij.

"Jo, jo. Ende ndihem në siklet me atë punën e gjunjëzimit, madje edhe kur jam vetëm. Muajin e kaluar - në prill - Randy më tha të merresha me hapin e katërt. Aty bën një investigim moral të vetes. Ideja është, natyrisht, që njeriu të jetë i thellë dhe plotësisht i ndershëm."

"Dhe e ke bërë?"

"Po. Randy tha që duhej të shkruaja të gjitha gjërat e këqija dhe pastaj ta ktheja letrën në anën tjetër dhe të shkruaja të gjitha të mirat tek vetja ime. Të këqijat i mbarova për dhjetë minuta. Por të mirat më morën mbi një orë. Në fillim nuk më vinte ndër mend asgjë e mirë, por në fund shkrova: të paktën kam sens humorit. Sepse e kam këtë. Kur e kuptova këtë, arrita të gjeja edhe disa gjëra të tjera. Kur i thashë Randyt se e kisha të vështirë të gjeja anë të mira te vetja, ai tha se kjo ishte normale. Ke pirë për gati tridhjetë vjet, tha. Kjo lë shumë gjurmë dhe njolla në vetëvlerësimin e individit. Por nëse qëndron esëll, plagët do të shërohen. Pastaj më tha t'i digjia listat. Tha se kjo do të më bënte të ndihesh më mirë."

"E bërë?"

"Po. Çuditërisht, po. Gjithsesi, kemi arritur te ajo që Randy do që ta unë ta bëj këtë muaj."

"Më tepër e kërkon, do të thosha, - tha Jamieson-i me një buzëqeshje të lehtë."

Ai e palosi gazetën dhe e la mënjanë. Jacku buzëqeshi gjithashtu.

"Tingëllon sikur keni filluar ta kuptoni këtë marrëdhënien mes sponsorit dhe të sponsorizuarit. Randy më tha se kishte ardhur koha të bëja hapin e pestë."

"Që konsiston në çfarë?"

"Të rrefehem para Zotit, para vetes dhe para një njeriu tjetër saktësisht për të gjitha

të këqijat që kam bërë, - tha Jacku dhe bëri shenjën e thonjëzave me gishtat. I thashë: në rregull, do të bëja një listë rreth këtyre dhe do t'ia lexoja atij. Zoti mund të dëgjonte fshehurazi njëkohësisht. Dy zogj me një gur, si të thuash."

"Dyshoj se nuk të tha jo."

"Ai tha jo. Tha se duhej të shkoja te një person krejt i panjohur. Propozimi i tij i parë ishte të flisja me një prift, por unë nuk kam shkelur në kishë që kur isha dymbëdhjetë vjeç dhe tani nuk kam asnjë dëshirë ta bëj këtë. Çfarëdo që të përfundoj duke besuar - dhe ende nuk kam asnjë ide se çfarë do të jetë - nuk do të jetë diçka që kërkon të ulesh në bankat e kishës.

Jamieson-i nuk ishte as vetë njeri kishë. Ai pohoi me kokë.

"Randy më tha: "Thjesht afroju dikujt në Grant Park ose Washington Square ose Central Park dhe kërkoji të të dëgjojë ndërsa rendit të këqijat që ke bërë. Afroju disa dollarë për mundimin nëse është e nevojshme. Dhe vazhdo t'i pyesësh derisa dikush të pranojë. Tha se pjesa më e vështirë do të ishte të pyesje njerëzit - dhe kishte të drejtë."

"A jam unë... " Jamieson-i u ndal. Shprehja "viktima e parë" i erdhi ndër mend, por iu duk e padrejtë. "A jam unë i pari që ke pyetur?"

"I dyti. Dje provova me një shofer taksie që nuk ishte në punë dhe ai më tha të zhdukesh."

Kjo i kujtoi Jamieson-it një shaka të vjetër njujorkase: Një turist i afrohet një burri në Lexington Avenue dhe e pyet: «A mund të më tregoni si shkohet te bashkia, apo duhet të shkoj drejt e në ferr?» Vendosi të mos i thoshte burrit me rrobat e Yankees-it të shkonte në ferr. Do ta dëgjonte, dhe herën tjetër që do të hante drekë me mikun e tij Aleksin (edhe ai pensionist), do të kishte diçka interesante për të treguar.

"Mirë. Filloni, - tha ai.

Jacku futi dorën në xhepin e bluzës me kapuç, nxori një copë letre dhe e hapi. "Kur isha në klasën e katërt..."

"Nëse do të më tregoni gjithë historinë e jetës suaj, ndoshta duhet të më jepni ato njëzet dollarë gjithsesi."

Jacku futi dorën në xhep, por Jamieson-i bëri një gjest ndalues.

"Po bëja shaka."

"Vërtetë?"

"Po. Por të mos e zgjasim shumë. Kam një takim në orën tetë e gjysmë."

Kjo nuk ishte e vërtetë, dhe Jamieson-i mendoi se ishte me fat që nuk kishte probleme me alkoolin, sepse nga ato pak mbledhje AA që kishte parë në televizor, singeriteti dukej thelbësor.

"Mirë, e kuptoj. Do të jem sa më i shpejtë. Në klasën e katërt u përfshiva në një zënkë me një djalë tjetër. Ia çava buzën dhe i shkaktova gjakderdhje nga hunda. Kur na thirrën te drejtori, thashë se ai kishte thënë diçka të turpshme për nënën time. Ai, sigurisht, e mohoi këtë, por nga drejtoria na dhanë nga një letër për t'ua treguar prindërve. Në rastin tim vetëm nënës, sepse babai ishte larguar kur isha dy vjeç."

"Dhe çfarë ishte ajo që të tha për nënën?"

"Kjo ishte një gënjeshërë. Atë ditë ndihesh keq dhe mendova se do të ndihesh më mirë po të rrihesha me atë djalë, të cilin nuk e pëlqeja. Pse nuk e pëlqeja nuk e di, ndonëse duhet të kisha pasur ndonjë arsye. Por nuk e mbaj mend. Ajo ngjarje bëri që të filloja të gënjeja. Kur hyra në adoleshencë, fillova të pija. Nëna mbante një shishe vodka në frigorifer. Unë i vidhja pak vodkë dhe i mbushja shishen me ujë. Në fund ajo e kuptoi dhe vodkën e hoqi nga frigoriferi. E dija ku e mbante - në një raft lart mbi sobë - por nuk mora më prej asaj shishe. Tani shishja ishte pothuajse vetëm ujë. Në vend të kësaj, kurseja paratë e xhepit dhe ato që fitoja duke ndihmuar në shtëpi dhe paguaja një alkoolist të vjetër që të më blinte shishe të vogla. Ai blinte katër sosh dhe mbante njërin për vete. Kështu ia mundësoja të pinte. Të paktën kështu do ta thoshte sponsori im." Jacku

(Vijon në faqen 15)

**Prag i martur pranvere,
1 Mars 2005**

Sot u bënë dhjetë vjet qysh kur jam slarguar nga Shqipëria pa u kthyer njëherë të vetme aty. Jam një njeri që nuk shoh ëndrra. Nuk e di shkakun përse? Në dhjetë vitet e fundit ku, jam endur nga njëri vend në tjetrin, kam njohur njerëz, gjuhë, dashuri, urrejtje, që as më shumë e as më pak, e kanë shuar kureshtjen time ëndërrimtare duke më bërë të ndihem si një Grifon i damarëve të galerive ku dergjet shpirti i mërgimtarit

Jam në kërkim të ditë tuneleve të reja jetësore. Të cilat ndjekin njëra-tjetrën si vajzat e qytetit tim ndërsa shkonim për në shkollë dikur. Ishte pjesa më e bukur e atyre ditëve. Kjo orë që gërmon kujtesën përgjatë netëve që përngjajnë me një rrobë të magjishme, vello e zezë e tejdukshme që mbështjell trupin e universit, njësoj si trupin ku dallohen qartë nishanet mu si galaktika yjesh në të pafundmin shtegtim. Do të isha i lumtur sikur gjithmonë të ishte kështu. Por fatkeqësisht realiteti i ditëve të mia ka tjetër fytyrë.

Alarmi i zgjimit të mëngjesit është një nga shpikjet që e urrej me shpirt. Pastaj, fytyra ime në pasqyrë. Oh, fytyra ime në pasqyrë?! E urrej praninë e fytyrës time në pasqyrën e përditshmërisë. Por nuk kam shumë kohë të merrem me të. Më duhet të rend. E me makinën time si turinjtë e një kobre, të zvarritem në vendin ku fitoj refrenin e këngës që përditë këndo: "Bukën tonë të përditshme falna Zot!"

Për dymbëdhjetë orë jam këngëtar i kësaj kënge që zgjat gjashtë ditë në javë. Të gjashta ditët përbëjnë rreth treqind e katëmbëdhjetë pasqyra mëngjesore në vit. Dhe për dhjetë vjet formojnë mozaikun e tridhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë fytyrave të pasqyruara në një fytyrë të vetme. Netët kanë tjetër formë. Ose nuk kanë formë. Netët nuk kanë fytyrë. Më tepër se tokësore ato janë hyjnore. Në to ashtu si në muzikë koha rrjedh, shtrihet në një hapësirë të pakufizuar me kufijtë e një jete të vetme.

**Nata mërkuriane e të mërkurës,
2 Mars 2005**

Mbi kodrën ku prehen varret e të vdekurve të qytetit të Pogradecit, mund të shohësh liqenin. Një pikëz loti midis shpirtave ngashërues të maleve që mbështjellin pamjen. Qyteti ku vijon një jetë e vdekur e banorëve të tij të gjallë. Një gjysmë qiell i gërvishur në shikim nga degë gështenjash që popullojnë varrezat. Pllaka mermeri. Pllaka varresh ku koha shtrihet njëtrajtësisht. Ku koha nuk ekziston. Ku ekzistenca është e ngurtësuar në mermer.

Nuk i di rrethanat si dhe përse u gjenda aty prej kaq mijëra kilometrash larg? Përballë meje u shfaq i ndjeri im gjysh. I mbështetur në trungun pranë gështenjës ku prehet. Qëndronte i qetë me atë buzëqeshjen njerëzore e cila e tregonte më të ri nga ç' ishte në të vërtetë, sipas llogarive të mia matematikore. Ndryshe nga ç'më kujtohet kur ishte i gjallë, ajo që më bëri përshtypje së pari ishin rrobat e tij. Në krejt shkallaren që shërbente si zbritje-ngritje të kujtimeve të mia, më kujtohet se i ndjeri në më të shumtën e kohës së jetës që kishte jetuar ishte i veshur si dhëndër me kostum dhe kravatë. Kështu e mbajnë mend edhe qytetarët e Pogradecit "profesorin". Kishte kaluar një rini "endur ditën dhe ç' thurur natën" përmes Selanikut, Bukureshtit, Romës, Gjenezës dhe Lionit. Ndërsa, tashmë ishte i veshur me një palë tuta sportive kineze të viteve shtatëdhjetë. Tuta ngjyrë blu të zënë. Një palë atlete me shollë kauçuku ngjyrë gri. Në imazh të ëndrrës sime ishte



FLURANS ILIA

Rekuiem

Tregim

buza e tij. E ngjyrosur në anën e poshtme të njëjtën ngjyrë blu e errët si kostumi i tij sportiv. Dridhej dhe kishte ftohtë. Bashkë me të edhe unë, dridhesha dhe kisha ftohtë. Ftohtësia vinte prej mjegullnajës nga një tjetër kohë kur isha fëmijë. Kur i sapodalë nga uji i ftohtë i liqenit të Ohrit, me buzën e nxirë nën qortimin e fjalëve të tij, mundohesha të fshija trupin tim vocërrak brenda krahëve të gjyshit tim si një nosit në vjeshtë kur natyra fillon të hedhë mbi vete petkun e përgjumjes dimërore. Nuk e di përse sot, është im gjysh që më shfaqet në ëndrrën time të parë mbas dhjetë vjetësh qyshkur nuk shoh më ëndrra.

"Më fal që nuk kam mundur të shoh një të vetme herë në ëndërr!" i thashë.

Ndihesha fajtor pa faj kundrejt këtij fakti që më bënte të afrohesha më tepër drejt tij.

"Dua të më kuptosh. Nuk e kam pasur të lehtë përgjatë këtyre ditëve endacake!" shfaqësoshesha.

Ai vazhdonte të kishte në buzën blu po atë buzëqeshje që e tregonte më të ri nga ç' ishte në të vërtetë. Një lloj ngjyrimi e cili bëhej edhe më i afërt me hapat e mi drejt tij.

"Dua të më kuptosh se nuk kam pasur kohë për ëndrra!" thashë, tashmë një hap larg tij.

Ai vazhdimisht miratonte me kokë pa folur duke më dhënë të kuptoja se: "Nuk është ndonjë gjë e jashtëzakonshme, biri im. Gjëra ndodhin në jetë. Të kuptoj. Kohët kanë ndryshuar. Nuk është ndonjë gjë e madhe. Të kam falur."

I hapi krahët dhe të dy u gjendëm në atë përqafim magjik i cili më kishte munguar tmerrësisht për të gjitha këto vite. Ndieja mall. Ndieja një shtrëngim që e kisha humbur ndër vite dhe po e gjeja rishtazi. Një përqafim në të cilin doja të isha i lidhur përgjithnjë. Por nuk mundesha. Nuk mundesha sepse sytë e tij më thoshin se "kohët kishin ndryshuar". Instinkti i rrugës që po përshkoj nga ëndrra drejt zgjimit më udhëhiqte drejt shtigjesh logjike ku lehtas kuptohej se shpirti i të ndjerit vinte në krahët e mi prej një tjetër bote. Në logjikën time sy zgjuar i binte që të isha përqafuar për të parën herë në jetë me një të vdekur atë natë.

- Pra, pothuajse, një vit pas largimit tim? I thashë vetes.

**Pritja e të premtës,
4 Mars 2005**

Unisa për në punë. Nuk e di se si i kam përtypur ato dymbëdhjetë orë ditë. Në mbrëmjen e datës katër mars përgjatë gjithë natës kisha një dëshirë të papërmbajtur për të pirë të gjithë detin e pijeve që kisha në shtëpi. Kisha dëshirë të digjia gjithçka këtë natë. Por siç thoshte zëri i Bob Dylan, burgosur në shiritin e magnetofonit: "Asgjë s'kishte mbetur për të djegur". Vërtetë asgjë. Kisha nevojë të flisja me shokë, të afërm, miq. Por të gjithë ishin larg. Flinin këtë orë në gjumin e halleve të botës.

U lëshova i dërrmuar nga alkooli mbi shtrat në pritjen e radhës që ndillte ankth me ndjesinë e një nate më parë mbledhur lëmsh mbi gjoks. Isha i gatshëm t'i jepja një copë mish nga trupi im bishës të së vërtetës. Por më kotë. Asgjë nuk erdhi. Asgjë nuk ndodhi. Përsëritja e të njëjtave rituale disa orë më vonë në mëngjes. Alarmi i zgjimit. Pasqyra. Fytyra. Kafja. Ndihesha i këputur si të kisha kapërcyer Saharanë në një natë të vetme. Më tej, makina ime me fytyrë kobre tek gjarpëronte rrugëve të qytetit. Puna. Orët. Refreni. Gjithçka e ndalur një moment përball kolegut tim gjashtëdhjetë e pesë vjeçar Mike Valas ndërsa i rrefëja ëndrrën.

- Përse unë? - e pyeta, - Prej kaq mijëra kilometrash larg të udhëtoj drejt atij vendi? Përse unë prej kaq kohësh i ikur duhet t'i bëja vizitë një të vdekuri?

- Nuk je ti, por shpirti i tij që ka ardhur e të ka gjetur këtu. - tha ai.

U shtanga. Tingëllon paradoksale. Kisha besuar se isha unë ai që kishte depërtuar atje në kodrën e gështenjave. Ku edhe kisha gjetur trupin e tij? Jo. Duhet thënë shpirtin e tij. Jo, jo! Nuk ishim në Pogradec por në ëndrrën time këtu në Cape Cod. Nuk besoj se isha unë, apo shpirti im, që kishte kapërcyer oqeanin atë natë. Por ai, shpirti i tij, që kishte zbritur prej kodrës së gështenjave drejt e në realitetin tim amerikan.

- Mos u bëj merak. - më shkundi Mike - Të shtunën do të vete në kishë dhe do të ndez një qiri në emër të tij.

- Të faleminderit! - thash më i qetë shpirtërisht, nuk e di përse në tre gjuhë të ndryshme me idenë idiote se nuk po më kuptonte.

Në mbrëmje mora një mesazh nga kushëriri im që jeton po ashtu në mërgim. Më tronditi kjo frazë e tij: "Nuk di kur ke genë për herë të fundit në Pogradec. Dua të ta them gjendjen me një paradoks që tingëllon pashmangshëm tepër poetik: Pogradeci jashtë kishte ndryshuar aq egër, dhe Pogradeci im që ruajtur brenda meje aq mirë, saqë askush nuk kish vdekur gjatë mungesës sime, e askush s'do të vdiste pas ikjes sime."

**Perëndim i vagëlluar
mbi liqerin pa kufij,
4 Mars 2005**

Liqeri i pulitur, mavijuar e venitur, lillamburitës svagullon. Sipër-e-më-sipër, tinës zog ardhushi, mjerush parëverak, posi frymë dehur, vetëtitës çiqëron zembëresë të këngëve. Këndimi yt nër ne pat rarë dit'e nat'. O fatlum i paçmuarshmë fjalëtor. Vgjer-i shentë. Vraparak. Posi zëth, qipallë, stolismë, çfrerim. Këng' e lasht' e vjershërisë, folja jonë pleqërishte, që veson farmaqet, rrëxosur farmason. Përtërit pashteruar, paqetuar, qielluar, shenjteruar, dëshëruar, shushulluar, mjergulluar, shkundërmuar, shaqiluar, pipëlim në kraharuar,

**E enjte e ënjtur,
3 Mars 2005**

Zgjimi ka zbritur Cape Cod, Massachusetts. U zgjova duke ndier të ftohtë. U mbështolla me batanije. Të parat rreze Marsit kishin mbërritur në pezul të dritares sime. Ora shënon dy orë më parë se rënia e alarmit të zgjimit tim të përditshëm. U ngrita nga shtrati dhe ndeza një qiri. Ishte diçka jo e zakonshme për ditët e mia sepse jam një njeri që nuk shoh ëndrra. Ky kthim i papritur drejt asgjësë. Këtë e ndieja te gishtat ndërsa u vura në përgatitje të një kafeje. Dy glënjkat e para më dhanë kurajë drejt marrjes së receptorit të telefonit. Po formoja numrin e nënës e cila jeton në Tiranë. Ajo pritje më vuri papritur përballë një reflektimi: Të gjitha lutjet e mia ja kisha thënë në anglisht të ndjerit. E vetmja gjuhë e huaj të cilën nuk e njihte përmes morisë së disa gjuhëve që zotëronte.

"Zot na ruaj! Prandaj edhe tundte kokën në shenjë miratimi pa folur."

Një mur na ndante në atë takim. Gjuha. Gjuha jonë e përbashkët të cilën ai e kishte humbur nga vdekja. Shqipe që unë po e humbisja nga jeta në morinë e viteve të mia të ikura në mërgim.

Një sinjal i zgjatur më torturonte në pritje të përgjigjes së nënës. Nuk po kuptoja përse po telefonoja atë të parën? Për të ndarë së bashku ëndrrën e sapo parë? Ndoshta. Pritja e atyre sekondave njëtrajtësohej me kohëzgjatjen e të gjitha këtyre viteve jetuar në tokë të huaj.

- Alo? - u dëgjua përtej oqeanit zëri i saj.

- Alo? Jam unë mama. Si je?

- Biri nënës si je?

- Mirë. Jam në merak. Kam parë një ëndërr të çuditshme sot.

- Ke parë ëndërr?

- Po. Kam parë gjyshin në ëndërr.

Një tjetër e vërtetë më shkundi ndër kohë. Nuk dua ta fsheh. Nuk më kujtohej viti i saktë i vdekjes së tij. Prej aty po kuptoja pse po i telefonoja mamasë. Për të marrë vesh se kur im gjysh kishte ndërruar jetë.

- Në vitin 1996! - foli ajo qortueshëm.

perëndimi më të vagëlluar sillet qark gjerorisht. Shtërg'i fundit prej zemërate. Bard i fundit i pulitur, dërdëllit. Ç'të zotërovi ç'çërrima sylynjarë e ç'çërrit q'i thurri lavdërim. Ç'quhen krillat mbudhë mbollisura, mijëza, mijëza, shejza t'shejta të mitura. Shkëndijime. Ç'm'u verbojnë-o syt'e mia, ndej në gji një këngë gjaku shtërgjysherishte. Ças. Një grime parpalitet pik'e ngritë. Ronitet. Dh' aher'... Lëngon levezhga palëpirë dhe palcorja me përgjërata pikon e merr kullimin, fund skëterre, kulm zeniti, nën etere, gjuh'e vdarë dyke vuar; Çkëlqen. Fërfëllon. Vaj' e një çasi-e këngës s'ate harmonishmë... Harmoni divine e tepërlumtur, fshehtësira, me kullim si fleta fundet në fund gremine, fund'. Skëterrur. Rrasë. Mort. Urgjin'e zisë. Urgji e ngratë mbi varrishta. Papo ula kryet mun ne zambaku, mbi shkorreta. Mun ne tumb'e përmivarshme, ku vërzave thëthinjë aromë borsilog. Kim' a-ni zilinë armiçërishtë, me pedantizm barbar, o maskaradë, renegacion! Ryn hunapi dal-nga-dal për së nalti nër fellësira. Fryn një erë-e ëngjërvë. Jet'e dherit, syr' i lodhur, kandilerit, marth, mpijet, mvarret, dhëmkoset dhe me hov të letë valon. Venë-e-vinë. Vate. Vanë sërë-sërë, sy-vramuseve, ç'm'j-u ka hije paanësira, lartësira, ndryshmësira. Afërò-m' u, shih-më shimëzë, për-mat' anë, shimëzë!

Ag mbi Atlantik, 5 Mars 2005

Dobare e gjumit si një sprijë zalli bariste nga shtrati i ngrohtë drejt dritares ku prej së largu shndriste bregu i të ndritshmit blu. Mëngjesi i datës pesë mars, e gjeti grykën time të njomësuar me ajrin e oqeanit. Një shije kripe në kishite mbetur në gurmaz nga nata e mëparshme. Nuk e di përse? Nuk e di nga vija e ku shkoja? Por më duhej të çaja thellë. Përtej asaj që pretendojmë se e njohim. Fytyrën e së cilës nuk e kemi parë kurrë. Ose gjithmonë e kemi me vete. Pa e kuptuar. Më dukej sikur kësaj here kisha kapërcyer i vetëm Atlantikun. I kisha shpëtuar mirazhit vertikalisht vdekjeprurës të Saharasë dhe lundroja i shtrirë mbi një copë shtrat druri, horizontalisht mbi oqean. Ndieja se toka lëvizte rrëshqitshëm nën shtratin e Atlantikut. Lëvizte përditshmëria. Veprimi mori formën dhe ritmin e valëve. Dhe valët morën kuptimin e ditës. Kuptimin e syrit të zgjuar në atë çast të pazakontë kur gjithçka për mua nuk do të ishte më asnjëherë si më parë.

Mike Valas sipas premtimit, në kishën ortodokse të Shën Gjergjit - 1130 Falmouth Road, Rte. 28, Centerville - e kishte ndezur një qiri në emër të gjyshit tim këtë ditë përballë shenjtorëve. Në të njëjtën kohë kur atje në Pogradecin e largët, NË REALITET, stuhia e shirave i detyroi të vdekurit të dalin nga varret.

E shtuna e pulave, 5 Mars 2005

Në kalendarin ortodoks e shtuna e pesë marsit, njihet si «dita e të vdekurve». Ndryshe thërritet nga pleqtë si «e shtuna e pulave». Thuhet se pikërisht shpirtrat e të vdekurve dalin mbi sipërfaqe të tokës gjatë gjithë kësaj dite. Pak para të shtunës së pesë marsit kanë lëvizur varret e Pogradecit. Ishte marrëzi të besojë përkimin e ngjarjes me ditën e të vdekurve. Por ashtu kishte ngjarë. E gjithë sipërfaqja e tokës (parcela e varrezave) pranë Përroit të Çaprazit, kishte shkarë nga shirat dhe dëbora e atyre ditëve. Kisha dëgjuar për një problem të tillë diku aty nga vitet '90. U tha atëherë se varrezat që po arrinin majën e kodrës një ditë do të rrëshqisnin. Ky do të ishte Apokalips i shpejtë, sepse vetë njerëzit nën një

fajësi kolektive të çmendur kishin prerë gështenjat e mbi kodrës, kishin bërë vend e pa vend shtëpi banimi (që edhe ato një ditë do të rrezikonin jetët e tyre) e çnuk kishin bërë. Shumë ujë rrodhi që atëherë e deri më sot, për të na mbetur në derë ky shqetësim që këtë mars u bë lajm ndërkombehtar.

Nga shtypi i kohës : *"Qytetari P. Dh. na tregoi se ai së bashku me të afërmit e tij, kishin zhvarrosur me dhimbje eshtrat e motrës Tefta dhe burrit të saj, vdekur vite më parë e për t'i varrosur përsëri në një varr të përbashkët me prindërit e burrit. Ndërsa P. H. na tregoi për tmerrin e bashkimit të eshtrave të vëllait të tij me ato të të vdekurve të tjerë."*

"Njerëz që gjenin të afërmit e praretur nga koha, të tjerë që seleksiononin kockat e tyre dhe ndokush që kërkonte personin e vdekur që për momentin s'ndodhej në varrin e tij! Mbi të gjitha, gjendjen e jashtëzakonshme e bënte më të vështirë terreni i përbaltur, shiu dhe bora. Ushtarë, mjete transporti, arkivole, maska, doreza, njerëz të dëshpëruar, punonjësit e Bashkisë, gjithandej, ...asnjëherë s'e kishim parë drejtpërdrejt një skenë masive zhvarrimi."

Presidenti i Republikës i telefonon krye bashkiakut : *"Më lejoni të shpreh keqardhjen time për pasojat e kësaj fatkeqësie natyrore që lëndoi ndjenjat e qytetarëve pogradecarë."* - 6 Mars 2005

- Paskë qenë i çuditshëm mor' bir! Me të gjitha këto që ndodhën kënde, dhe ëndrrën që më rrëfeve katër ditë më parë; Zot na ruaj! Paskë qenë i çuditshëm! Duhet të vizitohesh te ndonjë doktor, apo të shohësh ndonjë prift.

- Çfarë ka ndodhur? - 7 Mars 2005

- Eshtrat e gjyshit nuk kanë lëvizur se i kanë mbajtur rrënjët e gështenjës sipër varrit të tij. *Të kujtohet gështenja?* - 8 Mars 2005

Krye bashkiaku prononcohet në shtyp :

"Deri më sot, 9 Mars, Bashkia ka dhënë 270 autorizime për zhvendosje varresh në fshatin Guras. Një pjesë njerëzish i kanë çuar të afërmit e tyre për t'i rivarrosur në Korçë, Tiranë apo në komunat nga kanë ardhur. Aktualisht ende punojnë 160 ushtarë, 100 forca të ndërmarrjeve publike të bashkisë si dhe punëtorë të biznesit vendas. Në normalizimin e saj ndihmuan Bashkia e Tiranës. Prefektura e Bashkisë së Korçës dhe Prefektura e Elbasanit. Policia e Pogradecit në këtë situatë po punon pa u ndalur. Kanë mbërritur në Pogradec, një grup inxhinierësh gjeologë nga Tirana. Të gjithë i falënderoj." - 9 Mars 2005

"Sot është mbledhja e Qeverisë, e cila do të akordojë 27 milion lekë të reja për ndalimin e rrëshqitjes së mëtejshme të dheut. Nga këto, 15 milion lekë të reja për sistemimin e varrezave të reja në fshatin Guras dhe 12 milion lekë të reja për përbalimin e kostos varrim - zhvarrim. Gjithashtu vetë Bashkia Pogradec do të përdorë 12 deri 15 milion lekë të reja për të përbaluar këtë situatë. Do të ketë një autobus (linjë e vazhdueshme) çdo ditë për të çuar njerëzit në varrezat e reja të Gurasit. Përveç familjarëve që kanë vendin e tyre në varrezat e vjetra, të gjitha funeralet e tjera do të bëhen në varrezat e Gurasit. Ndërkohë, pas një Kalvarit të gjatë 9 marsi i dhuroi Pogradecit mot me diell dhe një normalitet në sistemimin e varrezave të vjetra." - 10 Mars 2005

Sikur të ishin dhjetë ditë dhjetë net dhjetë orë dhjetë minuta dhjetë sekonda dhjetë shekuj - janë bërë dhjetë vjet që kur jam larguar nga Shqipëria pa u kthyer një herë të vetme aty. Ngjan kjo kohë me një rekuem që sjell shpesh në mendje fëmijërinë e degëve të një gështenje.

Cape Cod, Mars 2005

tundi kokën. "Nuk e di çfarë ndodhi me të. Quhej Ralf, por unë gjithmonë e quaja në mendje Ralf Pijaneci. Fëmijët mund të jenë mizorë. Tani, me shumë gjasë, ai ka vdekur, dhe nëse është kështu, unë e ndihmosa të vriste veten."

"Mos e çoni aq larg, tha Jamieson-i. "Me siguri keni mjaft gjëra për t' u penduar pa shpikur të tjera."

Jacku ngriti sytë dhe buzëqeshi vesh më vesh. Jamieson-i vuri re se sytë i kishte të përlotur - nuk i rridhnin, por ishin gati.

"Tani po flisni tamam si Randy."

"Është gjë e mirë?"

"Mendoj se po. Dyshoj se kam pasur fat që ju gjeta."

Jamieson-i kuptoi se, çuditërisht, ishte i kënaqur që ishte "i gjeturi".

"Çfarë tjetër ke në listën tuaj? Koha po kalon."

"Më vonë studiova në Brown dhe u diplomova me nota të shkëlqyera, por me gënjeshtër dhe mashtrime. Në këtë isha i zoti. Dhe - kjo ishte më e keqja - mentori im kishte vartësi nga kokaina. Nuk do të flas se si e mora vesh këtë, sepse koha po kalon, siç thatë edhe ju, por e mora vesh dhe pastaj i sigurova një kilogram kokainë në këmbim të notave të mira. Dhe, sigurisht, ai më pagoi për drogën. Nuk po merresha me bamirësi."

"Një kilogram? " pyeti Jamieson-i. Vetullat i ishin ngritur pothuajse deri te vija e flokëve.

"Po. E futa nga Kanadaja, e fsheha në rrotën rezervë të Ford-it tim të vjetër. U përpoqa të dukesh si një nga studentët që kalojnë pushimet duke bredhur dhe duke flirtuar në Toronto, por zemra më rrihte si çekan dhe tensioni duhet të më ketë shkuar në qiell. Makinën para meje e kontrolluan në kufi, por mua më lanë të kaloj pasi u tregova patentën. Ndonëse në atë kohë nuk ishin aspak aq dyshues sa tani. "Ai heshti për një çast dhe pastaj shtoi: "Për më tepër, i mora shumë para për drogën. Mbajtja diferencën për vete."

"Por nuk bërdore vetë kokainë? " - pyeti Jamieson-i.

"Jo. Droga kurrë nuk ka qenë pija ime. Kam pirë ndonjëherë në ndonjë bar, por ajo që më pëlqente vërtet ishte uiski. Dhe ende e pëlqej. Gënjeva shefat e mi, por në fund më zbuluan. Nuk ishte si në universitet, dhe nuk kisha askënd për të kontrabanduar drogë. Të paktën nuk gjeta askënd."

"Si i gënjeje?"

"Falsifikojta raportet e punës. Sajoja takime shitjeje që nuk i kisha pasur kurrë, për të shpjeguar ditët kur isha shumë i dehur për t'u paraqitur në punë. Mashtroja me shpenzimet. Ajo puna e parë ishte puna e ëndrrave të mia. Mund të kisha shkuar shumë larg. Por e prisha. Kur më pushuan nga puna, mendova se ajo që më duhej ishte një ndryshim ambienti. Në AA e quajnë këtë "kërkimi i shërimit në gjeografi". Nuk funksionon kurrë, por unë nuk e dija. Tani duket e qartë: nëse hipën një budalla në avion në Boston, është po ai budalla që zbret në Los Anxhelos. Ose në Denver. Ose në Des Moines. E humba edhe punën e dytë. Nuk ishte aq e mirë sa e para, por ishte shumë e mirë. Ishte në San Diego. Atëherë mendova se ajo që më duhej ishte të martohesha dhe të qetësohesha. Kështu u martova me një vajzë të mirë, që meritonte dikë më të mirë se unë. Zgjati dy vjet dhe gjatë gjithë asaj kohe e gënjeva për varësinë time nga alkooli. Sajoja udhëtime pune për të shpjeguar pse kthehesha vonë në shtëpi, sajoja simptoma gripi për të shpjeguar pse shkoja me vonesë në punë ose nuk shkoja fare. Dhe përtypja pafund tableta menteje, por mendoni se e mashtrova?"

"Jo, nuk besoj, tha Jamieson-i. "Sa të ka mbetur ende për të treguar?"

(Vijon nga faqja 13)

"Vetëm edhe pesë minuta. Të jap fjalën."

"Në rregull."

"Grindeshim dhe grindjet bëheshin gjithnjë e më të këqija. Herë pas here njëri nga ne hidhte gjëra përreth dhe nuk ishte vetëm ajo. Pastaj erdhi mbrëmja kur u ktheva në shtëpi rreth mesnate, krejtësisht i dehur, dhe ajo shpërtheu. Tha të gjitha ato fjalët e zakonshme, e di, dhe të gjitha ishin të vërteta. Ndiheha sikur po më hidhte shigjeta helmi dhe secila fjalë po godiste në shenjë."

Tani Jacku po shikonte sërish duart e tij. Goja i dukej aq e dëshpëruar saqë për një çast Jamieson-it iu duk si Emmett Kelly, klouni i trishtuar.

"E dini çfarë më shkrepri në mendje ndërsa ajo më bërtiste? Mendova për Glenn Ferguson-in, djalin që e rraha kur isha në klasën e katërt. Mendova sa mirë isha ndërë atëherë, si kur shtrydh qelbin nga një puçërr. Dhe mendova se do të ndihesha po aq mirë po ta rrihja edhe atë. Dhe këtë herë, të paktën, askush nuk do t'i dërgonte letër mamasë në shtëpi për të më qortuar, sepse mamaja më vdiq vitin kur diplomova në Brown.

"Zot i madh", - tha Jamieson-i. Tani nuk po ndihej mirë teksa po dëgjonte këtë rrëfim të padëshiruar. Përkundrazi, po ndihej keq. Nuk ishte aspak i sigurt se donte të dëgjonte çfarë do të vinte më pas.

"U largova, - tha Jacku. "Por u frikësova mjaftueshëm për të kuptuar se duhej të bëja diçka për të ndalur pirjen e alkoolit. Ishte hera e parë që provoja AA -në, atje në San Diego. Kur u ktheva në Nju Jork isha esëll, por kjo nuk zgjati shumë. Pastaj provova sërish, dhe as kjo nuk zgjati. As herën e tretë nuk pata sukses. Por tani kam Randy-n, dhe këtë herë ndoshta do t'ia dal. Pjesërisht falë jush."

Ai zgjati dorën.

"Atëherë, ju lutem, - tha Jamieson-i dhe ia shtrëngoi dorën.

"Edhe një gjë duhet ta them, - tha Jacku.

Shtrëngimi i tij i dorës ishte shumë i fortë. Ai e pa Jamieson-in drejt në sy dhe buzëqeshi. "U largova nga shtëpia, siç thashë, por para se të ikja, ia preva fytin asaj kurvës së mallkuar. Nuk ndalova së piri, por kjo më bëri të ndihesha shumë më mirë. Ashtu siç isha ndonjëherë mirë kur rraha Glenn Ferguson-in. Edhe ai pijaneci për të cilin ju tregova - kur e rrihja edhe atë më bënte të ndihesha më mirë. Nuk e di nëse e mbyta, por gjithsesi ai mori atë që meritonte."

Jamieson-i u përpoq të tërhiqte dorën, por shtrëngimi i Jack-ut ishte tepër i fortë. Tani ai kishte futur dorën tjetër në xhepin e bluzës me kapuç me shenjën e Yankees. "Unë dua vërtet të ndaloj së piri, dhe nuk do të mund ta bëja hapin e pestë pa pranuar se duket se jam shumë i dhënë pas..."

Diçka që i ngjante një vije drite të bardhë, përvëluese, e çau Jamieson-in mes brinjëve, dhe kur Jacku nxori gozhdën e akulltë që pikonte dhe e futi sërish në xhepin e bluzës, Jamieson-i e kuptoi se nuk mund të merrte frymë.

"... pas vrasjes së njerëzve. Është një defekt karakteri, e di këtë, dhe ndoshta më e keqja nga të gjitha të këqijat që kam bërë."

Jacku u ngrit në këmbë.

"Pra, ju falënderoj shumë. Nuk e di si quheni, por keni qenë vërtet një ndihmë e jashtëzakonshme për mua."

Ai filloi të ecte drejt anës perëndimore të Central Park-ut, por më pas u kthye dhe pa Jamieson-in, i cili po kërkonte verbërisht gazetën e tij të mëngjesit... sikur një vështrim i shpejtë te faqja e argëtimit mbase mund ta bënte gjithçka sërish mirë.

"Sonte do të lutem për ju," - tha Jacku.

“Është liria që na bën të pakuptueshëm: secili kupton vetëm të vetën, ndërsa ajo e tjetrit i duket një formë marrëzie.”

Viola Ardone nuk është e panjohur për lexuesin shqiptar. Një vit më parë, ajo ishte në Tiranë, për një vizitë të shkurtër, me rastin e prezantimit për lexuesin shqiptar të romanit “Treni i fëmijëve”, botuar nga Dituria, libër që shërbeu edhe si skenar për një film shumë të suksesshëm, të shfaqur kohët e fundit.

Kësaj radhe vjen me romanin “Mrekullia e madhe”, i përkthyer sërish nga Agim Doksani, një libër që rrëfen për një revolucion kulturor dhe mundësinë për të ndryshuar botën, duke nisur nga personat më të brishtë.

Ngjarjet zhvillohen menjëherë pas miratimit të ligjit Basaglia të vitit 1978, që shënon një kthesë vendimtare në historinë e psikiatrisë italiane. Protagoniste është Elba, një grua e re e rritur brenda një spitali për të sëmurët mendorë (Fashone i Napolit), një hapësirë pezull që ajo vetë e quan “gjysmëbotë”.

Elba është mbyllur aty, që pa lindur ende, në bark të nënës. Pas zhdukjes së saj, Elba fillon të mbajë një ditar, ku mbledh historitë dhe çuditë e njerëzve që banojnë në atë univers të mbyllur. Ardhja e psikiatrit të ri Fausto Meravilja sjell një dritë në atë zymti: projekti i tij është të hapë portat e spitaleve të tilla, ta shoqërojë Elbën jashtë dhe t'i rikthejë kujdesit një dimension më njerëzor.

Rrëfimi ka një këndvështrim të dyfishtë: njëri është shikimi dhe mendimet e Elbës, ndërsa me tjetrin ndjekim rrugëtimin

Botim i ri nga Dituria. Përkthet: Agim Doksani

Vjen në shqip romani MREKULLIA E MADHE, shkruar nga Viola Ardone Nga Ana Sheldia

njerëzor të doktor Meraviljas, përballë kundërthënive të një shoqërie që po ripërcakton vetë kuptimin e çmendurisë.

“Është liria që na bën të pakuptueshëm: secili kupton vetëm të vetën, ndërsa ajo e tjetrit i duket një formë marrëzie.”

Falë këtij dizimi të shikimit, autorja arrin të shkojë përtej rrëfimit të një fati të vetëm, duke dhënë tablonë e një transformimi më të gjerë kulturor dhe institucional, atë që shoqëron fundin e spitaleve të tilla. Ajo arrin kështu t'i japë zë njerëzores së çdo pacienti, ekzistenca unike, shpesh të mbushura me ironi, vuajtje, shpresë dhe brishtësi.

Autorja na tregon se “sëmundja mendore” shpesh ishte një etiketë e imponuar ndaj më të dobëtëve, ndaj atyre që devijonin nga rregullat ose cenonin

ekuilibrin shoqëror. Protagonistja, Elba, nuk është e sëmurë: ajo thjesht ka lindur në vendin e gabuar, vajza e një gruaje të përjashtuar nga normat e kohës.

Çmimin më të lartë e paguanin sidomos gratë (siç rrëfen edhe Alda Merini në “L'altra verità. Diario di una diversa”), «të gjykuara si të gabuara, të papërsosura, ekscentrike, të paqëndrueshme, sepse nuk kishin qëndruar në anën e botës ku ishin vendosur. Të shpallura të çmendura nga babai, vëllai apo burri, për t'u çliruar nga një grua që nuk e donin më».

Viola Ardone është e aftë ta trajtojë këtë problem me forcë, intensitet, emocion, por edhe me lehtësi. Zëri i Elbës është i pastër, ironik, herë-herë poetik. Vështrimi i saj fëmijëror nuk e banalizon dhunën e spitalit, përkundrazi, e bën

edhe më therëse. Shkrimi është thelbësor dhe i matur, me një ritëm që alternon momente butësie me skena me emocione të forta. Një gjuhë e thjeshtë dhe një stil rrjedhës rrëfejnë një histori që të hyn në zemër dhe të zgjon shumë ndjenja, si trishtimi, zemërimi, indinjata, butësia dhe melankolia. Larg çdo vetëkënaqësie, autorja shmang sentimentalizmin dhe i rikthen kompleksitetin historisë pa rënë në sensacione.

“Mrekullia e madhe” na fton të rishqyrtojmë kufijtë mes shëndetit dhe çmendurisë, duke sugjeruar se mrekullia e vërtetë qëndron në një vështrim që di të shkojë përtej përkufizimeve dhe të njohë te tjetri një person, përpara se të jetë një diagnozë, bartës i një historie unike.

Dy fjalë për autorin

Viola Ardone (Napoli, 1974) jep latinisht dhe italisht në shkollë të mesme. Është autore e disa romaneve, ndër të cilat përmendim: “Receta e zembrës në trazira” (2012), “Një revolucion sentimental” (2016), “Treni i fëmijëve” (2019), Oliva Denaro (2021), që janë konsideruar ndër veprat më të suksesshme të letërsisë italiane të viteve të fundit.

“Mrekullia e madhe” është romani i dytë i Viola Ardone, që botohet nga DITURIA, pas Treni i fëmijëve (2023), që sapo u botua në Itali u bë ngjarja letrare e vitit dhe u përkthye në tridhjetë e gjashtë gjuhë. Me skenarin e këtij libri është realizuar së fundi një film.



Simbole të kohës dhe kujtimit: frika për trashëgiminë

Tash me të ishin dy vetë: ora dhe skeleti.¹

Me këtë fjali nis tregimi “Ora” i Anton Pashkut, i përfshirë në vëllimin me tregime të zgjedhura “Kjasina”. Në këtë tregim ora e dorës dhe skeleti që sheh i kujtojnë birit të paemër² babanë dhe orën e tij të çmuar që e kishte kujtim nga gjyshi. Ora shihet gjithnjë e lidhur me të atin, të cilin *posë tiktakut të orës së moçme, me gjasa, asgjë tjetër nuk e interesonte aq shumë³*. Ai dhe ora përbëjnë një çift të pandashëm në kujtimin e rrëfimitarit:

I pëlqente heshtja dhe në heshtje, nganjëherë, i kthente vrik sytë kah ora e vjetër e murit, të cilën e shikonte bukur gjatë e me vëmendje [...]⁴

Në tregim ngjan që padashje biri has me cep të krahut orën duke u rrëzuar bashkë me të në dysheme, duke rezultuar në dëmtimin e orës, e cila edhe pasi u riparua nga orëndreqësi nuk punoi dot më si më parë.

Ora dhe skeleti rishfaqen më pas në ëndrrën e birit, ku babai ndodhet në baltë me orën që nuk punon dhe shkel nëpër skelete e kafka, ku njëri nga skeletet mbante një orë që s’punonte.

Djelmoshat buzë kënetës, djelmoshat me nga një orë të madhe në dorë. Orët cingëronin. Edhe babai mbante një orë. Ora e tij nuk cingëronte. Ajo ishte rrum gjashtë orë prapa të tjerave. Qeshja e djelmoshave, fytyra e mrroltë e djalit të tij. Edhe fjalët e tij: “Baba, eja!” ku? Ishte në midis të kënetës. Të nisej kah djali, kah djelmoshat që qeshnin me orën e tij që kishte mbetur prapa gjashtë orë? [...] Kishte futur dorën nën ujë dhe prej atje kishte nxjerrë një skelet. Edhe në atë skelet kishte parë një orë të ndryshkur. Ajo, kuptohet, s’punonte, sepse sigurisht ishte plot ujë e lloshiti të asaj kënete.⁵

Kështu, ora dhe skeleti kthehen në simbole të kohës së shkuar dhe të kujtimit. Babai kaq i lidhur me orën e vjetër që nuk punon më përfaqëson pikërisht prirjet anakronike dhe frikën e ndryshimit, tjetërsimit, dhe të humbjes së identitetit apo trashëgimisë, ndaj edhe në mes të kënetës, simbol tamam për anakronizmin dhe prapambetjen, refuzon apo heziton të dalë e të shkojë drejt të birit dhe djelmoshave si përfaqësues të sinkronizmit dhe prokronizmit njëkohësisht.

Përsëri fjalët e djalit: “Baba, eja, dil jashtë, dil!” Si? Të shkojë pas tij, pas tyre? “Baba, hudhe orën, ajo nuk vlen gjë!” Njemend? Ç’të bëj? Ishte në kënetë. Orën e vet e mbante në dorë dhe nuk i thoshte mendja për ta fërfëlluar.⁶

Disforia⁷ e babait me ndryshimin dhe lënie pas të kohës së vjetër lidhet me frikën e humbjes së kujtimit prej tij. Të mos harrojmë që këtë orë e kishte kujtim nga gjyshi, ndaj ajo mund të ishte kujtimi i tij i vetëm apo i fundit nga gjyshi i vet, ashtu si dhe kujtimi i një të ashtuquajturë “e kaluar e lavdishme”. Jo më kot Bashkim Kuçuku, duke marrë shkas nga tregimi tjetër i Pashkut “Kulla”, sjell emërtimin *simbolikë e mbijetesës nëpërmjet traditës⁸* për tematikën mbizotëruese dhe motivin e vazhdueshëm në tregimtarinë e Pashkut.

Kurse orët cingëronin. Ato tregonin kohën e saktë. Djelmoshat qeshnin me orën e tij, që kishte mbetur prapa rrum gjashtë

¹ Pashku, Anton. *Kjasina* (Tregime të zgjedhura), Rilindja, Prishtinë, 1973, f. 65.

² *Kjo botë tregimtare është e banuar me preokupimin e shkrimtarit mbi fatin tragjik të njeriut në përgjithsi. Andaj, personazhet e këtyre tregimeve nuk kanë emra. [Raifi, Mensur. “Parathënje”. Pashku, Anton. *Kjasina* (Tregime të zgjedhura), Rilindja, Prishtinë, 1973, f. 11.]*

³ Pashku, Anton. *Kjasina* (Tregime të zgjedhura), Rilindja, Prishtinë, 1973, f. 67.

⁴ Po aty, f. 66.

⁵ Po aty, f. 70.

⁶ Po aty.

⁷ Refuzim, lëvizje larguese [Shih: Pozzato, Maria Pia. Semiotika e tekstit: Metoda, autorë, shembuj (përkth. Dhurata Shehri), Albas, Tiranë, 2017, f. 39].

⁸ Shih: Kuçuku, Bashkim. *Pas eklipsit letrar: Letërsi shqipe bashkëkohore I* (Studime, artikuj, ese), Toena, Tiranë, 2014, f. 275.

Raporti i njeriut me kohën dhe kujtimin në tregimin e Pashkut dhe krahasimi me Migjenin

Nga Noel Boci

orë. “Baba, hudhe orën!” Iu dhemb. Si ta fërfëllojë orën? Ah, ora. Gjyshi. Pallatet rriten, lartësohen gjithnjë e më shumë kah qielli. Edhe djelmoshat rriteshin, lëshonin shtat. Orët e tyre nuk ishin prapa asnjë minutë. Zhurma e maqinave. Balta deri në fyt. Orën e vet e mbante në njëorë dorë, të cilën e kishte çuar përmbi krye. Era e rëndë. Qeshja e djelmoshave. Zëri i djalit që e thërriste. Cingërima e orëve. Balta. I zihej fryma. Ora. Djelmoshat. Orët. Djali. Sharronte. Një dorë përmbi kënetë. Ora rrëzohet. Një dorë zhytet. Një dorë fundoset. Sharron.⁹

Në të kundërt, biri jepet në marrëdhënie disforike me këtë orë të vjetër të babait të tij. Në tekst kjo na shënohet me faktin se ora, duke mos punuar, i shkaktonte atij vonesa:

Shumë rrallë ecën me kohë. Kjo gjë nuk i pëlqente këtij, sepse, për shkak të saj, merrte vonesa të paarësyeshme në shkollë. Ah, ajo për këtë ishte bërë një orë e mallëkuar, e cila, edhe pse e ngrehshin rregullisht për çdo mbrëmje, prapë mbetej prapa për kushedi sa minuta [...] shumë herë kishte thënë që të blenin më një orë të re, një orë të mirë, që nuk të mashtron dhe që njeriu të ketë besim në të. Por, babai as që donte të dëgjojë.¹⁰

Disforia e djalit shkon më tej se kaq. Urrejta e tij ndaj orës për shkak të vonesave që i shkakton për në shkollë simbolizon urrejtjen apo pakënaqësinë ndaj anakronikes, ndaj asaj që mbetet në të shkuarën dhe që nuk pranon të ecë përpara me bashkëkohësinë. Përkundrazi, duket se ky anakronizëm kthehet gati në një padron distopik që nuk e lejon individin, dhe metonimikisht shoqërinë, të ecë përpara drejt së ardhmes, por e lë atë skllave të verbër e të heshtur të së shkuarës. Megjithatë, pesha e kohës dhe e kujtimit mbetet e rëndë, dhe për individin bëhet e vështirë t’i largohet së shkuarës që e ka formësuar atë. Kjo duket sikur përfaqësohet edhe nga struktura rrëfimore si një rikujtim i birit për të atin duke u nisur nga objektet simbolike të lartpërmendura.

Një disfori e tillë jepet edhe te romani i Pashkut, “Oh”:

Kurrë nuk më ka pëlqye ajo erë, ajo duhmë e dheut të malit, e dheut të arave të babës sim... As ai, as baba... As ai... Ai e donte tanë atë dhë të vet... Hëm, atë, atë

⁹ Pashku, Anton. *Kjasina* (Tregime të zgjedhura), Rilindja, Prishtinë, 1973, f. 71.

¹⁰ Po aty, ff. 67-68.

dhë të vet!... Dhe ishte shumë e vështirë të bisedosh për gjana të tjera, pos për atë dhë... Hëm, për atë dhë... Dhe ai ishte i gatshëm të bahej dhë, dhë për atë dhë... Dhe bahej...¹¹

Anakronizmi vs. Sin/Prokronizmi: përplasja mes brezave

Marrëdhënia që krijohet babai dhe biri me kohën kthehet në faktor ndikues në marrëdhënien midis tyre:

Njemend, kjo ishte gjë e vogël, ndofta pakëz qesharake, por rreth saj vazhdimisht zijej me fjalë me babanë, që ishte njaft i rreptë, madje edhe i gatshëm të çojë dorë kundër djalit, kur ia merrte mendja se vetëm ai kishte të drejtë. Në këso rastesh, kurrsesi nuk mund ta kuptonte. Por, as ai nuk mund ta kuptonte hallin e këtij. Që të dy kënaqeshin kur e mundnin njëri tjetrin me fjalë. Mirëpo, ky kurrë nuk ka qenë i bindur se ishte mundur prej tij. E as babai, me gjasë, kurrë s’kishte qenë i bindur se e kishte mundur ndonjëherë i biri.¹²

Përplasja mes babait dhe birit mbi prirjet e tyre në raport me kohën (anakronizmi i babait dhe sin/prokronizmi i birit) nuk jepen vetëm përmes orës dhe skeletit, por edhe përmes situatash të tjera të përditshme.

Ziheshin në gojë edhe një mijë punë të tjera: haheshin rreth modeleve të reja të petkave që nuk kënaqnin aspak shijen e babait, rreth këngëve të reja, ritmeve të reja, po, sidomos rreth këngëve moderne, të cilat i pëlqenin aq shumë, kurse babait i shponin veshin e mësuar me do këngë të tjera, që tash këndoheshin, më shumë ndër ndeja nëpër odat e fshatrave. Babai mrrolej edhe atëherë kur ky fillonte të fliste edhe për aso gjërash, që ishin të tmerrshme për të, po për të cilat djalit i flisnin çdo ditë profesorët e historisë, gjeografisë, biologjisë... Dhe, kur donte ta ngacmojë edhe një çik më shumë, i thoshte me ironi: “Baba, a di të më tregosh gjë për barkën e Nojit?... A thua, po kusha paskan qenë Adami dhe Eva?... Ah, zoti na ruajte, po çfarë krijese është ai farë Luciferi që digjet e piqet në flakë të ferrit... Kushedi

¹¹ Pashku, Anton. *Oh*, Camaj-Pipa, Shkodër, 2002, ff. 98-99.

¹² Pashku, Anton. *Kjasina* (Tregime të zgjedhura), Rilindja, Prishtinë, 1973, f. 68.

çfarë lëkure ka ai që kurrë s’digjet e s’piqet!” Babai, posa e dëgjonte, hidhërohej dhe çirrej, i thoshte të thyente qafën jashtë shtëpisë së tij, por ky rrinte i qetë dhe, vetëm atëherë kur ai çohej, çohej edhe ky dhe ikën prej tij, duke vrapuar rreth e rrotull tavolinës. E kur babai i afrohej për ta zënë, shkonte e strukej afër nënës, e cila thoshte: “Shenjtë qoftë ndërmjet jush... Njeri!... Bir!... O Zot!”¹³

Këto përplasje në shkallë të parë, paraqesin një tablo të mirëfilltë të përplasjes mes brezave, brezit të ri që do të largohet nga e shkuara dhe nga varësia e të fitojë lirinë e të qenit vetvetja dhe të të formësuarit të identitetit vetjak, dhe brezit të vjetër që më tepër se për pushtet apo ndikim mbi brezin e ri, gjakon për moshumbje të identitetit dhe për mosharrim, për moskalim në margjinë si diçka e pavlerë e që s’ka ekzistuar. Kështu, kalojmë në një shkallë të dytë: përplasjen e kahjeve brenda vetë qenies njerëzore, dëshirën për të ecur përpara duke u çliruar dhe pa u ndikuar nga e shkuara, dhe pamundësinë për të mohuar dhe për t’i shpëtuar të kaluarës që mbetet përherë si kujtim dhe si zanafillë e qenies.

Kjo duket se shpjegon edhe ndjenjën e dhembshurisë së birit për të atin:

Në atë heshtje babai i dukej shumë tragjik, i dhembsej dhe vendoste të mos e trazojë më atë njeri që aq shumë i kundërshtonte gati të gjitha mendimet e tij.¹⁴

Në personazhin e birit jepet empatia për të atin që ndryshe nga ai e ka të vështirë t’i largohet kujtimeve dhe herë-herë edhe vargonjve të së shkuarës, e cila ka një vlerë dhe domethënie specifike për të. Për më tepër, nuk mund ta harrojmë përpjekjen e vazhdueshme të birit për ta bindur të atin të dalë nga kënetë e të shpëtojë, siç diskutuam më lart, dhe vështirësinë e atit për t’u larguar kaq lehtë nga e shkuara. Kjo ndjesi dhe qasje deri diku euforike¹⁵ e birit ndaj të atit dhe dhembshuria për vështirësinë në të cilën ndodhet ai, ruhet gjër në fund të tregimit:

Por nëna kishte shfaqur dëshirën që ora e moçme e murit të mbetej edhe më tutje aty. I kishte thënë se prej vdekjes së babait ora ishte vetëm e saj. Ky e kishte kuptuar. Mandej ajo i kishte dhënë të holla që të blente një orë të re, orë dore, të cilën ky tash po e çonte te orëndreqësi për t’ia vënë rrypin dhe për ta ngrehur për së pari. Ecën duke fërkuar orën e re në xhep dhe, njëheri, duke menduar për orën e moçme të murit dhe skeletin në gjysmëterrin e muzeumit.¹⁶

I gjendur bashkë me të emën përballë vdekjes së babait dhe duke kuptuar lidhjen e nënës me orën e vjetër si kujtim prej të shoqit, biri tashmë kupton edhe lidhjen që kishte i ati me këtë orë si bartëse e kujtimit të gjyshit të tij. Me blerjen e orës së re duket se biri “i jep fund” rrethit vicioz të përplasjes mes brezave duke i dhënë më në fund vlerën e merituar si të shkuarës ashtu edhe të tashmes dhe të ardhmes, e përforcuar kjo nga fakti që ai vijon të mendojë për orën e vjetër të babait teksa fërkon orën e tij të re, duke shpëtuar lidhjen e shkëputur baba-bir dhe duke bërë paqe me kohën.

Në fjalimin e tij të mbajtur me rastin e dorëzimit të Çmimit Nobel në Letërsi, shkrimtari turk Orhan Pamuk do të shprehej: *ajo çka letërsia duhet të tregojë dhe të hulumtojë sot, është problemi kryesor i njerëzimit, frika e përjashtimit dhe e të ndjerit i parëndësishëm, ndjenja e të mosqenit i dobishëm, cenimet e sedrës të provuara nga shoqëritë, brishtësitë, frika e poshtërimit, zemërimet e çdo lloji, ndjeshmëritë dhe mburrjet kombëtare...¹⁷* Mbese është kjo frikë që kishte babai e për të cilën u vetëdijesua biri, e mbese këtë “detyrë” të letërsisë po ushtron vetë Pashku.

(Vijon në faqen 19)


¹³ Po aty, ff. 68-69.

¹⁴ Po aty, f. 69.

¹⁵ Tërheqje, lëvizje drejt [Shih: Pozzato, Maria Pia. Semiotika e tekstit: Metoda, autorë, shembuj (përkth. Dhurata Shehri), Albas, Tiranë, 2017, f. 39].

¹⁶ Pashku, Anton. *Kjasina* (Tregime të zgjedhura), Rilindja, Prishtinë, 1973, ff. 71-72.

¹⁷ Pamuk, Orhan. “Baulja e babait” (Fjalimi i mbajtur me rastin e dorëzimit të Çmimit Nobel në Letërsi, përkthyer nga Urim Nerguti). *Baulja e babait*, Skanderbeg Books, Tiranë, 2014, f. 25.



Do të ketë tapet të kuq, tapet të kuq, e dini ? Po; të shtruar madje, që te sheshi përpara Pallatit, ku ndalin Mercedes – Benz – at e zinj protokollarë, prej të cilëve zbresin ceremonialisht, pasi ua hapin derën, personalitetet e politikës shqiptare dhe botërore, që e kanë mësuar se, duhet të shtangen një moment në qëndrim gatitu për shkrepjen e atyre fotove historike, teksa anëve valviten flamuj gjithfarësh dhe, banda frymore ekzekuton hymnin e radhës...

E pra, që nga sheshi do të shtillet tapeti i kuq, pastaj do të ngjitet valë – valë te shkallët e mermerta, për t'u fashitur më në fund mospërmasë sallës kryesore me dyer të larta dhe tavan të harkuar si kube, në sallën e pasuruar artistikisht me piktura fiorentine, që i mbuluan cep më cep me tabakë kartoni në vitet e komunizmit ateist dhe, i zbuluan ngathtësisht pas Nëntëdhjetës...

Do të ketë tapet te kuq...

Moderatori Benjamin Ferri, njëherësh edhe gazetar, biznesmen, historian, shkrimtar, udhëtar, pronar i madh, e gjithë ç'është, do të promovojë pikërisht te ky Pallat, me hije klasike, librin e tij të ri, me titull Diktatorët e Paqes!

Hezitan në fillim administratorët e Pallatit, kur u njoftuan për këtë aktivitet skandaloz; ç'punë kemi ne me prezantimet e llojlloj librave, pyetën veten të hutuar, e më pas u përgjigjën zyrtarisht:

Nuk ju miratohet kërkesa për atë eventin që kërkoni ta zhvilloni në Pallatin Presidential, që ju, për çudi, ndonëse të medias, e quani edhe sot e kësaj dite Pallati i Brigadave. Sidoqoftë, e kush nuk e di se ne, i përkasim vetëm e vetëm protokollit shtetëror...

Por, hehe, mbërriti si përgjithmonë nga Lart, urdhri suprem i pakundërshtueshëm, për ta lejuar autorin e talentuar ta zhvillonte promovimin e librit të tij, që ngërthente vlera të veçanta artistike dhe historike; e ç'është tjetër do t'i përshtatej këtij libri më logjikshëm se salla hijerëndë e këtij Pallati, të ngritur për të qenë rezidenca e një mbreti...?

Do të ketë tapet të kuq.

Aloo!

O, Grida e dashur, të njoha menjëherë.

Ç'kemi, a ju mbërriti ftesa luksoze për atë promovimin e librit të Ferrit ?

Sigurisht që po. Gjashtëdhjetë minutat e para t'eventit do të transmetohen drejtpërdrejt, e lexove nënë të ftesës ?

Poo; do të jenë të gjithë, Adel, siç më rrëfyon: presidenti, kryeministri, ca deputetë majtas e djathtas, ministra...

Shkrimtarë, gazetarë, aktorë posepo, Demi, kryetari i bashkisë...

Ç'është veshim, thuaj ?

Dëgjo Grida : unë, këtë herë që u ktheva nga Milanoja, solla me vete dy valixhe plot me rroba; s'lashë gjë pa blerë, dëgjon? Nëse do t'iu hedhësh një sy...

O, rrofsh ; kam blerë edhe unë çudira pa mbarim, por mirë e the: hajt të zgjedhësh e të vendosësh !

Ne do të vimë me makinën e re; sapo kemi marrë një X6, një BMW që të le pa mend si me pamjen e jashtme, ashtu edhe me atë të brendshme. Sa mirë që ai Ferri na fton çdo herë çift. Riku, im shoq (o Zot, sa i çuditshëm është!) pati merak të më kujtoj të ndërroj modelin e flokëve ! E kujt, hahaha...

Tapet i kuq.

Prozhektorët jashtë , aty te të dyja anët e derës së hapur tej e tej, u ndezën me të rënë muzgu dhe llamburitën sheshin, teksa spikerja e lajmeve e Luna TV, Soni K. zuri vend ndanë hyrjes, nga ku e kontrollonte pasqyrë gjithë hapësirën e sheshit. Mbi tryezë kishte dy ekrane përballë, njeri i kompjuterit, prej të cilit do të nxirrte të dhënat që do t'i nevojiteshin në çast dhe, tjetri një televizor, ku do të ndiqte figurën finale gjatë transmetimit të drejtpërdrejtë, për të qenë kësajsoj sa më e sinkronizuar në komentet e saj për të ftuarit që pritej t'ia behnin...

Ah ah...

Ashtu siç e meritonte edhe rangi i lartë i eventit, Soni K, ndryshe nga çdo mbrëmje në studion e lajmeve, kishte veshur një fund përplot pala që i valëzonin tek ecte dhe, një këmishë, patjetër me dekolte të shpërthyer edhe vertikalisht. Dhe, i qe nënshtruar një grimi eksentrik, i cili e kishte tjetërsuar gjer dhe në identitet. Por, sa me entuziazëm e kishte prituar ajo këtë impenjim , i cili, ndonëse do të zgjaste veçse ca orë, do t'i jepte mundësinë të provonte një përvojë të re !

Kështu, i gjithë ekipi i televizionit u vu në gatishmëri për të filluar transmetimin dhe, vetë Beniamini, i futur në një kostum të kaltër dhe, me faqe të kuqëruara, të saporrojtura, doli te



KONSTANDIN DHAMO

Drejtpërdrejt nga pallati presidencial

Tregim

shkallët të priste të ftuarit vip, burrat e shtetit, ambasadorët, miqtë, kolegët, disa prej të cilëve, ia donte puna t'i shoqëronte deri te tryeza e rezervuar posaçërisht.

Dhe Soni K:

Siç e shihni edhe ju, telespektatorë, tani mbi tapetin e kuq po ecën analisti i njohur Altin Gora! Ndonëse i veshur veçse me një T- shirt të hollë, ka lidhur rreth qafës një shall të madh. Takohet me Ferrin dhe, kushedi përse po e tund kryet mohueshëm ; epo dihet, Altini çdo herë intrigon...!

Oho; ja edhe balerinat e Star Gala – së, tek zbresin nga një limuzinë çmendurish e gjatë me tre akse, që vezullon prej ngjyrës së bardhë dhe kromaturës te skema dhe parakolpot ! Po çne balerinat këtu ? Oho; me në krye baletmaestrin Niko, të pandarshmin prej tyre, mikun e ngushtë të Ferrit, ato ngjisin shkallët e gjera , ashtu të lehta të lehta si zogjitë, duke përshëndetur me ekzekutimin e disa piruetave elegante te rrafshi përpara hyrjes, ndonëse jo të veshura me paçka e pa puante, por me pantallona xhins dhe athlete ; bravo bravo vajza !

I hidhen në qafë Ferrit dhe humbin në sallë; ah, çfarë adrenaline përdezen !

Dhe tani disa plane nga brendia e sallës që gumëzhin nga gjallëria. Ja, tryezat në anë me librat e firmosur nga autori, ja dhe të ftuarit, që ndahen grupe – grupe sipas njohjeve dhe profesioneve dhe, zënë vend, por mbërriti sakaq kryeministri, të nderuar shikues të televizionit tonë ! Ja, i veshur casual, teksa zonja e tij paraqitet gjithë korrektesë me një kostum blu, të qepur si përherë nga Xhilda, stilistja e saj shqiptare, që s'e ndërton .

Ferri i përqafton miqësisht, (sepse, jo më kot nuk kanë vënë kravatë) dhe i shoqëron , tek llafosen, gjer te tryeza e tyre, e ngulitur në mes të sallës...

Sakaq kanë mbërritur fiks n'orarin e përcaktuar në ftesë edhe ambasadorët: ai i Francës, i Kosovës dhe Italisë...

Ja edhe dy zonja deputete, sigurisht, të së njëjtës forcë politike, që nuk ndahen nga njëra – tjetra , a thua se janë motra siameze !

Ato shkëlqejnë nga bizhutë dhe, ashtu të gëzuara shkelin tapetin e kuq tek mbajnë në dorë çantat Gucci. Oho, çanta Gucci, veshje Gucci dhe parfum Gucci, por ja tek afrohet edhe Adel krahu për krahu me Gridën; çfarë mikesh të pandara! Ekstravagante, por njëherësh edhe gjithë klas, ato ngjisin shkallët, tek spërdridhen paksa sensualisht. Fustani u hapet ritmikisht dhe u zbulon gjithashtu ritmikisht këmbët e gjata me shkëlqim mermeri . Këto zonja nuk do të plaken kurrë !

Pas u vinë bashkëshortët e tyre, shik dhe të buzëqeshur, biznesmenët vizionarë, të cilët dinë ta kryejnë shkëlqyeshëm vetë rolin e shefit të reklamave dhe, gratë, përveçse si të tilla, i kanë edhe partnere të shkathta. Po ku janë kamerat këtë moment ? Megjithatë, një puthje së largu,

gjej gabime drejtshkrimorë ! Po mirë, ky Ferri, së pari miku ynë, që Zoti deshi ta bëjë me pare, nuk gjeti dot një korrektor për të qenë, pale një redaktor, sepse me kaq sa lexova unë, mund të them me bindje se, libri nuk i është nënshtruar një disipline gramatikore të domosdoshme. Me këto gabime humbet serioziteti dhe të vete tërë puna dëm; ja ja, do ta lexoni vetë. Mua ore, të ma kishte dhënë t'ia redaktoja dhe korrigjoja ! Për shembull : fjalën mecenat e hasa nja pesë herë të shkruar mecene, ju betohem ! Më ndihu konteksti i paragrafëve përkatës, përndryshe zor se do ta merrja vesh se ç'ishte kjo mecenia...

Ç'thua ? Ja, i ka që në krye të librit edhe emrin e korrektorit edhe të dy emrat e redaktorëve, shikoji...

Siç duket i kanë marrë lekët, por asqë kanë denjuar t'i hedhin një sy librit, të cilin Ferri kurrsesi nuk duhet ta kishte dorëzuar për botim pa e kontrolluar më parë vetë; s'mund të kesh besim te njeri sot.

Këtë të bënte dhe, jo të na tregonte se, historia dhe legendat orale të krijuara mbi të vërtetat e saj, u dashka të mbijetojnë së bashku paralelisht; ehu...

Tryeza 10

Ç'ke Adel?

Sapo më dërgoi një sms një shoqja ime, ku më thotë shkurtimisht se, po e ndjek këtë promovimin e librit, por mua dhe Gridën nuk na ka parë ende gjëkund. A jeni apo s'jeni në sallë, pyet në fund ajo. Të drejtë ka kjo shoqja ime të shqetësohet ; ja, asnjë kamera nuk na është afuar ende. Madje edhe te shkallët , kur kaluam mbi tapetin e kuq, nuk kishte asnjë kamera të kthyer nga ne.

Poo, ranë përmbys duke nxjerrë ato fyrfyçkat e spektakleve dhe gazetarkat, ato aguridhet, koleget e tyre ! – shpërtheu Grida.

Me ato do të merren kryesisht, - i ndërhyri i shoqi – sepse ato do të përgatisin kronikën e mbrëmjes, apo edhe ndonjë reportazh të zgjeruar më pas.

Vështrojeni pak atë këngëtare që s'po ia kujtoj dot emrin, sesi zgërdhihet tërë kohës për të tërhequr vëmendjen ! Ka veshur një copë tyli, po po, një copë tyli të zi dhe s'ka poshtë tij as reçipeta e as mbathje, dëgjoni ç'ju them, sepse ne femrat ia njohim ca marifete njëra – tjetrës. E poshtra, rri enkas e përthyer në mes dhe, ua tregon të gjithëve bythë! Shiheni, shiheni! Por ç'po them edhe unë; ju burrat tanë atë po shihnit tërë kohës. Ju dolën sytë nga vendi

E moj Grida, që s'të shpëton gjë !

Vura re këta bandillët tanë, që s'ia ndanin sytë dhe u bëra kureshtare.

Epo, vërtet po e shihnim; sot t'i kthesh prapancën një mashkulli nuk do të thotë aspak se, po tregohesh e pasjellshme, përkundrazi, do të thotë se po tregohesh bujare, hahaha ! Por, ç'po them, se mos ka qenë ndonjëherë ndryshe...

Ajo farë këngëtare, që unë ende s'po ia gjej emrin, është e gjitha produkt i kirurgjisë estetike.

Jo, jo, është fare e re dhe unë prirem të besoj tjetër gjë, atë që ajo e harxhon tërë kohën e lirë në palestër. Megjithatë, ne burrat...

Ç'i do llafat, ajo duket që është një ordinere dhe ka!

Trendin e prapancave e shpikët vetë ju, femrat. Sot, shpreheni për sigurta ju, nuk ke ku vete pa një palë bythë për të qenë dhe, mjerë ajo që s'ka ! Kështu, pothuaj të gjitha fotot që postoni në rrjetet sociale, kanë në plan të parë doemos prapancat. Dhe, bëhet fjalë për bythë të kolme, të tonuara plot merak dhe të gjera aqsa i bëjnë të duken të ngushtë supet. Vetë e keni injoruar dhe poshtëruar veten ju femrat; a keni apo jo, fytyrë sot ? Shumë – shumë nato fotot që postoni pa u përmbajtur, sheh veçse prapancat dhe, rrallëherë edhe ndonjë çerek profili të portretit. Pa hë...

Hahaha; dhe jeni pajisur me dy dekolte, një e prapancave dhe një e gjoksit, hahaha...

Sa s'ju shkon ju burrave tanë, madje meshkujve në përgjithësi, ky leksion mbi moralin dhe etikën ! Ç'po shihnit deri tani, aman! Ju plasni bam, po nuk kthyet kokën pas, për të shijuar tundjet e shkundjet e një gruaje.

Hahaha...

Mirë, mirë, por ajo e poshtra ahengçie provokon gjithë agresivitet dhe, mësojeni prej meje se, po vazhdoi edhe ca të kalamendet , do të shkrehet në orgazmë. Dhe, hajde mbaje ! Shih, shih, po i marrin edhe një intervistë duke shfletuar kinse me interes librin e Ferrit ! E ç'mendime mund të shprehë ajo? Ka apo nuk ka kritikë letrare në këtë sallë, ka shkrimtarë , poetë...

Ja, do të vijë Ferri me gotën e shampanjës në dorë që të na falënderojë personalisht dhe ta urojmë edhe ne nga ana jonë, siç e kërkon

mirësjellja; do të vijë me gjithë kamerën që e ndjek nga pas, prandaj përgatituni.

Ne? Ç' thua, asqë duam...
Tryeza 7
Shumë të shijshme dhe shumë pikante këto antipastat e Ferrit!

Pikante si Benua vetë. Ku i porosit i paudhi? Ku i porosit? Sot ç' nuk ka, aman; hidh paratë dhe, hopa, të vjen ç' ke dëshiruar në pjatë! Si me urdhrin e Peshkut të Artë...

Përse hipi natë podiumin ndanë sallës Ferri, kur ligjëroi, përse i lypsej ai qëndrim i distancuar nga ne të ftuarit, miqtë dhe kolegët e tij. Nuk më pëlqeu kur kërceu mbi ato dërrasa për të na parë të gjithëve nga lart poshtë. Për Zotin, u pozicionua ex cathedra, si për të na e kujtuar edhe një herë, se është i pagabueshëm.

Emo, ç' podium ishte ai, as tridhjetë centrimetra mbi dyscheme, apo i mjaftonin edhe aq...

Tryeza 5
Hiqe atë libër nga dora, se na vdiqe! Këtu në sallë ke vendosur ta lëçitësh të gjithin?

E lashë, e lashë. Ky libër sqenkësh as mish as peshk: pra, as historit e njemendte e as fiction. O gazetarë, poetë, prozatorë, na e lini ne, historianëve profesionistë ta shkruajmë historinë; ja gëzuar dhe ju të tryezës, t'i çikim gotat për shëndetin tonë! Ne, ore historianëve na ka lezet ky mision; po them lezet meqë po përtypim ca proshutë të ftohtë, ca djathra fantastikë, duke u mallëngjyer me verë, gëzuar!

Ehu, historia, historia; sot kushdo mund të prononcohet për gjithçka, gëzuar, gëzuar...

Tryeza 10. Përsëri.

Ferri ia behu me kupën e verës në dorë, por pa kamerën nga pas, ç'i thoni ju kësaj? Unë po i ndjek me vëmendje planet që ndërrohen te ky ekran i këtu mbi ne dhe, asnjë herë nuk e pashë veten time apo Gridën, pale ju burrat tanë, biznesmenë të suksesshëm! – shfryu Adel.

Biznesmenë të suksesshëm the, he? Togfjalëshi sloganor i politikës, kur kërkon të lançojë një person që i rrotullon ashtu siç duhet paratë e shkreta. Po ç' na nevojitet ne televizioni në këtë rast? Ne po debatohet për problemat tona të pambarimta, gra të dashura, çka duhet t'ju interesojë njëherësh edhe juve, si partneret tona të paepura që jeni. Pastaj, a do të vemi, apo nuk do të vemi për pushime sivjet? E pra, hajt ta ndajmë mendjen se, ku do të vemi së pari, meqë jemi bashkë që të katër.

Më çmendi ajo shoqja ime; tri herë më ka telefonuar: Adel, Adel, vazhdon të jesh aty në sallë, po? Po ti me gjithë ato hire, ku i kanë sytë ata...

Rreth orës 24.00, miqtë u ndanë ngrohtësisht dhe hipën në makinat përkatëse, pasi hëngrën një darkë të stërholluar te Restoranti Crazy Horse, ku u rehatuan me t'u larguar nga Pallati Presidential. Rugës, tek ndalën te semafori, përpara urës te Hotel Dajti (hehe, tek ish Hotel Dajti!) Adel iu kthye të shoqit:

Tani po pyesja veten: e ç'dëshëm ne, pash Zotin, që u turrëm dhe mbajtëm frymën tek ai promovimi, a ç'dreqin ishte?

Kur tjetri të respekton...

Ai tjetri, pikërisht nuk na respektoi. Vërtet kam pirë verë sa desha, por mendjen ama e kam top; nuk trallisem kollaj unë.

Adel, kaluam për mrekulli, mos e zgjat. Sa njerëz takove, pa më thuaj?

Unë u përgatita gjithë përkushtim e seriozitet; fustan i ri i paparë, model flokësh sipas tendencës së fundit, make up fin, e të tjera gjëra të tilla, atëherë e si të mos shfaqesha unë gjëkund?

Hahaha, punë e madhe! Ja, atje në restorantin e mbushur tumllas, ty të vështroinin të gjithë, madje aq pa takt sa që unë u bezdisa dhe më pickoi xhelozia, hahaha...

Posi posi, uf sa qenkam llangosur rreth buzëve nga të ngrënët, si s'e vura re që në restorant?! Dale dale ta pastroj pak të kuqin, më dëgjon? Mirë që u kujtova...

Ç'pate që e nxore atë pasqyrën, ç'nevojë ke të ndreqesh, aman, a nuk po vemi në shtëpi?

Në shtëpi po vemi, pusho, por ja që s'e shoh dot veten të çrregullt unë, më quajnë Adel.

Adel, thjesht një emër është, ç' thua?

E sheh, unë thosha përse më është rënduar çanta? Hape pak krahu, zemra ime; hape dhe ndalo ja, pranë këtyre kazanëve të plehrave.

Ç'ke ndër mend të bësh, moj e marrë?

Një minutë, një minutë...

Dhe Adel uli xhamin e derës dhe, pasi nxori nga çanta librin voluminoz me diktatorët e paqes, e fluturoi mbi plehra, ja aty te trotuari, përpara ngrehinës së një universiteti të sapohapur...

Tapet i kuq...

(Vijon nga faqja 17)

**“Ora” dhe “Studenti në shtëpi”:
marrëdhënia atë-bir dhe qasja ndaj
anakronizmit**

Marrëdhënia e kontraktuar atë-bir në letërsinë shqipe jepet në mënyrë përfaqësuese edhe në novelën “Studenti në shtëpi” të Migjenit. Ashtu si tek “Ora”, në këtë novelë na paraqitet një raport kompleks mes babait dhe birit dhe qasjeve të ndryshme që kanë me kohën dhe traditën si konstruktive sociale. Sipas Sabri Hamitit, në novelën e Migjenit menjëherë në fillim krijohet njëri ndër relacionet themelore të veprës: *relacioni babë e bir, madje në një ambient ku mbretëron ligja patriarkale. Mirëpo, që këtu jipen shenjat e tejkallimit të kësaj ligje, apo konvence, sepse nënshtrimi i birit bëhet në mospajtim të heshtur, me një moskënaqësi*¹⁸.

*Mandej i ati iu paraftyronte Nushit, mbasi ai e ka shkruem letrën tue hymë nat shtëpi, në muzg të mbramjes, dhe tue prue natën me vete. Se mbas tij dera u mbyllte, dhe atëherë të hymet e të dalmet ishin jashtëzakonisht të rralla, dhe vetëm kur lajmonte kush ndoj lindje, ndoj vdekje ose vinte ndoj mik i papritun, çka ngjante shumë rrallë, u prishte kjo ligjë patriarkale. Ligjë, edhe çfarë ligje! Kush e shkelle at ligjë, gjith at natë do ta çonte në një ndjenjë si me pasë shkelë diçka të ftohtë, të rrëshqitshme si gjarpni. E syt e t'et që të përshkojnë me ftohtësi përftojshin tamam një aso ndjenje te Nushi. Si me pasë shkelë gjarpnin.*¹⁹

*Ky relacion babë e bir është krijuar, tematizuar dhe profilizuar edhe më si një ftohje, si një mospajtim në heshtje, sepse baba mundohet që nga biri të krijojë, të “riprodhjë” pikturën e vet.*²⁰

*Nushi nuk dinte ç'ka me thanë. Nuk dinte me fole me t'anë. Kur ishte femi, e kuptonte shumë ma mirë. Por kaloi ajo kohë, kur n'imagjinatë të tij baba ishte diçka ma tepër se babë, ishte një ideal, ideal i andrrimeve feminare. E sot, e din Nushi, se baba i tij asht një prej qindra – në mos dhe mija – etnish të qytetit tonë, njëni prej atyne etëve që nga fmia i vet duhen me bamë një njeri anakronik, pikturën e vet, trashigimtarin e dej të një të kalueme të gjymtë.*²¹

Ashtu si tek “Ora”, edhe te “Studenti në shtëpi” jepet pikërisht kjo tendencë drejt së shkuarës, drejt anakronikes. Megjithatë, nëse babai te tregimi i Pashkut nuk largohet dot nga e shkuara sepse ndjen një lidhje të fortë me të dhe nuk largohet dot nga kujtimi i të parëve të tij, babai te novela e Migjenit jepen si një figurë autoritare patriarkale, “viktimize” dhe

¹⁸ Hamiti, Sabri. *Letërsia moderne shqipe*, Tiranë, UET Press, 2013, f. 468.

¹⁹ Migjeni. *VEPRA. Vargjet e lira dhe Novelat e qytetit të veriut* (mbledhur dhe redaktuar nga Skënder Luarasi), Migjeni, Tiranë, shtypur në “Gorenjski tisk storitve” në Slloveni, 2011, f. 171.

²⁰ Hamiti, Sabri. *Letërsia moderne shqipe*, Tiranë, UET Press, 2013, f. 468.

²¹ Migjeni. *VEPRA. Vargjet e lira dhe Novelat e qytetit të veriut* (mbledhur dhe redaktuar nga Skënder Luarasi), Migjeni, Tiranë, shtypur në “Gorenjski tisk storitve” në Slloveni, 2011, f. 173.

njëkohësisht “mbështetës” i këtij ligji patriarkal që e ka kthyer atë në një qenie të tillë që synon nënshtrimin e anëtarëve të tjerë të familjes jo aq nga frika e përjashtimit vetjak dhe të kthyerit në njeri pa vlerë sa nga frika e “koritjes”, ndaj dhe disforia në rastin e Nushit dhe babait është shumë më e theksuar se ajo mes babait dhe birit te tregimi i Pashkut. Anakronizmi te Pashku del si një fatalitet i jetës njerëzore prej të cilit njeriu e ka të vështirë të shpëtojë e që për më tepër lidhet me pamundësinë njerëzore për t'u larguar nga e shkuara dhe kujtimet. Ndërsa te Migjeni, teksti i të cilit prirret drejt një *njësie të njohjes*²², autori e funksionalizon përplasjen mes anakronikes dhe sinkronikes për të formësuar realizmin e tij kritik, duke denoncuar dhe “ndëshkuar” prirjet patriarkale dhe shtypëse si ligje të pashkruara, konvenca më saktë, të një shoqërie që jo vetëm nuk sjell “asgjë të re”, por vret edhe grimën më të vogël të së resë që përbën një kërcënim ndaj pushtetin të konvenës. Qasje kjo gati-gati mesianike teksa kujtojmë veprimet “blasfemuese” dhe “jokonvencionale” të Jezu Krishtit kundrejt farisenjve dhe saducenjve në Dhjatën e Re.

Pastaj u tregoi këtë shëmbëlltë: «Askush nuk pret një copë prej një robe të re për të arnuar me të një rrobë të vjetër, sepse copa nga rroba e re do të grisët e nuk do t'i përshatet së vjetrës.

Askush nuk hedh verë të re në kacekë të vjetër, se vera e re do t'i çajë kacekët e do të derdhet, ndërsa vetë kacekët do të shkojnë dëm. Prandaj vera e re hidhet në kacekë të rinj.

Askush nuk dëshiron të pijë verë të re pasi ka pirë verë të vjetër, sepse thotë: “E vjetra është më e mirë”. [Luka 5:36-39]²³

*E trajtuar si një novelë me në qendrën përplasjen mes brezave dhe mentaliteteve përkatëse mes Nushit dhe babait të vet si përfaqësues, përkatësisht Nushi simbol i progresit dhe babai simbol i konservatorizmit, duket sikur në çdo sekuencë narrative kërkon të nxjerrë në pah këtë antagonizëm mes subjekteve në rëfëm*²⁴ shkruan studiuesi Eljon Doçe.

E Nushi ndëgjon. Don me qenë djali i mirë. Si mos me ndëgjuë babën i cili e lindi, e rriti dhe e bani kaq! Pale mos ndëgjo. Megjithëse kundra ndërgjegjes së vet, Nushi ndëgjon. Nga fjalët e t'et i shtrembnohet fytyra, por me dëgjuë – ndëgjon. Ndëgjojnë edhe vllaznit e motrat, të cilët kanë ndejun përreth edhe të gjithë janë bamë vesh. Pale mos ndëgjo. Ndëgjon dhe nana në dhomë të zjarrit fjalët e burrit të vet dhe me një frigë çuditet për ditunin e madhe të bashkëshortit. Tanë një familje, e mbyllun mbrenda mureve të shtëpis dhe mbrenda një ambienti patriarkal, përgatitet për jetën qytetare të nesërme. “Mos të më korisin, – mendon kryetari i familjes, tue i shikue me rend të gjith pjestarët. Mos të më korisin, prandaj shtrëngo frenat, shtrëngo sa të mundësh, e nse nuk mund

²² Shih: Hamiti, Sabri. *Letërsia moderne shqipe*, Tiranë, UET Press, 2013, f. 467.

²³ Besëlidhja e Re, Ungjilli sipas Lukës, *Bibla, shkrimi i shenjtë* (përkth. Joan Leka, Marian Paloka, Oldi Morava, Zefjan Nikolla; përgat. për bot. Altin Hysi), Fondacioni “Shoqëria Biblike Ndërkonfesionale e Shqipërisë”, Tiranë, 2020, f. 1227.

²⁴ Doçe, Eljon. *Kangë në vete*. Migjeni: poetika e prozës së shkurtër, “Albas”, Tiranë, 2022, ff. 139-140.

*të marrin frymë – të pëlcastin. Sa vështirë asht me rritë femi në kohë të soçme! Sa vështirë asht me i ruejtë varzat! Eh, kohët e kalueme!*²⁵

Këtë lidhje të fortë e të pazgjdhshme të atit me të kaluarën duket se Nushi arrin ta kuptojë:

*Nushi ndëgjon. Të gjithë ndëgjojnë. Pale e mos ndëgjo! Nushi ndëgjon dhe mendon. Ndoshta jeta e ka bamë këtë njeri kaq të reptë.*²⁶

Ashtu si te tregimi i Pashkut, edhe te novela e Migjenit biri arrin të vetëdijësohet për “rëndesën e padurueshme të së kaluarës” mbi të atin dhe vështirësinë e tij për t'i shpëtuar vargonjve të së shkuarës. Ndaj edhe këtu gjejmë shenja të fatalitetit të anakronizmit si fat tragjik i qenies. Kjo e bën komplekse qasjen e Nushit ndaj babait, metonimikisht, përplasjen sin/prokronizëm-anakronizëm:

[Nushi] *urren të kaluemen që asht aq e afërme, si baba i tij. Baba asht i afërm, si babë, por i largët si përfaqësues i shoqnis, si person. E gjith mosmarrëveshja, të gjitha moskuptimet vijjnë ngase të gjith kemi nëpër shtëpira, nëpër votra, ka një ose ma tepër të këitillë të dashtun dhe t'urrejtun përnjëherësh. [...] Nushi e din që edhe baba i tij s'ka faj se asht i tillë; rrethanat dhe shoqnia e krijuen. Prandaj dhe ka mbetun dashunia birnore në Nushin, pse din t'arsyetojë. Por vllaznit e tij, motrat, a thue do ta dojnë babën? Kujtohet se kur ishte femi, kundrejt babës ma parë ndiente frigë së dashuni. E tash motrat dridhen para babës, e vllaznit nuk e kanë aspak në qejf shoqnin e babës; kur vjen baba, ata zhduken.*²⁷

Ashtu si tek “Ora”, biri arrin të kuptojë peshën e vargonjve të anakronikes mbi babain, ndaj dhe disforia nuk përbën tërë raportin baba e bir, duke na dhënë një marrëdhënie komplekse njerëzore që në një rrafsh tjetër paraqet marrëdhënien mes së shkuarës dhe së tashmes/së ardhmes, dhe prirjet ndaj tyre brenda vetë njeriut. Në këtë përplasje tendecash brenda qenies, njeriu mbetet pasiv, i paafë për të vepruar e për të vendosur, viktimize e kësaj kontradikte qeniesore. Nushi është *tejet i kthjellët për pamundësinë e ndryshimit të gjërave në mënyrë aktive*²⁸, ndaj *paradoksalisht i shndërron gjërat në mënyrë pasive*²⁹. Personazhet e Migjenit kthehen në personazheve vëzhguese, pasive, abstenuese, *Programi Narrativ* i të cilave bëhet pikërisht abstenimi/mosveprimi³⁰, se mbase duke mos vepruar atëherë të paktën, duke mos qenë më dot simbole të ndryshimit, kthehen në simbole të qëndrësës, duke mos u pajtuar me kontekstin dhe rrethin social që i kufizon. Kështu, novela mbyllet me monologun e brendshëm të Nushit, i cili revoltohet jo ndaj të atit, por ndaj tërë shoqërisë fajtoare për këtë anakronizëm të kthyer në normë:

*Unë jam pa moral, koncepti i em menduer – mos me thanë ideologjik – nuk pajtohet me moralin, të cilin mue kjo shoqni ma imponon. Por unë e marr moralin e saj për sy e faqe, nsa mbrapa ia loz lojën kur të due. Kështu si unë ia lozin lojën shoqnis me qinda veta në vendin tonë. Prandaj, shoqni, po deshe të mos lozin në kurriz tand, ndrro format. Hiqi bragashat.*³¹

Orhan Pamuk shprehet se *gjëja për të cilën bën thirrje letërsia e mirëfilltë, nuk është forca jonë e gjykimit, është aftësia jonë për ta vënë veten në vend të një tjetri*³², dhe këtë e dëshmojnë më së miri këta dy autorë.

²⁵ Migjeni. *VEPRA. Vargjet e lira dhe Novelat e qytetit të veriut* (mbledhur dhe redaktuar nga Skënder Luarasi), Migjeni, Tiranë, shtypur në “Gorenjski tisk storitve” në Slloveni, 2011, ff. 173-174.

²⁶ Po aty, f. 174.

²⁷ Po aty.

²⁸ Doçe, Eljon. *Kangë në vete*. Migjeni: poetika e prozës së shkurtër, “Albas”, Tiranë, 2022, f. 140.

²⁹ Po aty.

³⁰ Shih po aty, ff. 138-143.

³¹ Migjeni. *VEPRA. Vargjet e lira dhe Novelat e qytetit të veriut* (mbledhur dhe redaktuar nga Skënder Luarasi), “Migjeni”, Tiranë, shtypur në “Gorenjski tisk storitve” në Slloveni, 2011, f. 187.

³² Pamuk, Orhan. *Në Kars dhe Frankfurt* (përkthyer nga Hysen Voci) në “Baulja e babait”, Skanderbeg Books, Tiranë, 2014, f. 69.



HEDHJE NË TË KALTËR

Ti e doje këtë hedhje të çmendur,
 ëndërroje për rrobat e hedhjes drejt asgjësë.
 E ke një parashutë, por parashutat jo gjithnjë hapen.
 Këtu jemi vetëm, ne dhe qielli, dy gurë që biem.
 Unë trembem për ty. Dua ta dish sa të dua.
 Ti të jesh e kthjellët, lumturia do të bëjë të mos harrosh.
 Kjo rënie është e shkurtër,
 sa një kapsallitje sysh.
 Unë të flas, edhe pse e di se ti nuk më dëgjon,
 vetëm dorën ma tund me ledhatime.
 Mbahem me ty tek biem shpejt.
 Dëborë mbi malet, mjegulla në luginat, të gjitha ngjiten lart,
 vijnë të na përpijnë. Unë ta tund dorën. Edhe pak.
 Edhe pak e rrotullimi i tokës, heshtat e maleve
 do vijnë më shpejt. Unë ta tund dorën tri herë. Tani
 do jemi më vete. Ji e lumtur, lumturia të bën të mos harrosh.
 Tërhiqe fillin dhe hape parashutën.
 Qiellit këtu i vjen fundi rrufeshëm, si goditje rrufeje.
 Unë të dua, mos harro ta tërheqësh fillin!
 Unë i kam sytë tek ti.
 E di, edhe ti trembesh për mua.
 Unë jam gati! O, Zot,
 bekoje këtë lumturë që zbret kaq rrufeshëm me ne.

KOPSHTI IM

Kopshti im, i frikës, i bukurisë, i zemrës
 A je aq i bukur si ç'të lashë, para se të shkoja të flija?
 Kam frikë t'i hap sytë, a do gjej po ato valle ngjyrash,
 si vajza që lahen të dielave buzë lumit?
 Tani në fundverë deri në makth i dua lulet e tua.
 Ç'ishin ata të dërguar që fluturonin mbi lulet e tua si
 plumba?
 Një pyetje si shigjetë afrohet sikur do më vrasë.
 Pse aty ka më shumë kopshtarë se lule?
 Me ju jam në ëndërr, me ju kam qarë duke qeshur!
 Por tani druham t'i hap sytë,
 A jeni po ato, po aq të bukura sa ishit para se të fle

ÇAPAT MAGJIKË

Pyll' i vjetër i ndjen çapat magjike
 e rrëqethet. Pylli i vjetër ka shpirt,
 dritëhijet e agimit nëpër gjethe janë kujtime.
 Edhe mua, mikut të afërt, më pëshpërit e rrëfen
 për fëshfërimën e një gërshti të lëshuar në gushë,
 për dy sy që e përshkojnë tejpertej trupin e tij
 dhe e zgjojnë edhe për njëqind vjet.
 Diku era rrëzon trungjet,
 diku klithma e sharrës që pret, i dridh
 gjethet e trishtuara me shikim nga Dielli që po ikën.
 Atëbotë pylli i vjetër ka një këngë të mekët,
 fëshfërin sikur dridhet, dridhet sikur fëshfërin.
 Por prapë zgjohet nga çapat magjike,
 vëren vezullimet e gërshtetit nëpër pikëla vese
 dhe nis e këndon ndryshe, sikur është marrë vesh me dritën
 e me botat e lartme
 edhe për njëqind vite të tjera.

KALI IM I BUKUR

Atë ditë kur të bie nga kali im i bukur,
 ai s'do të ikë, s'do largohet me shalën zbrazët.
 Vetëm vonë, kur Dielli, si dhembje e ndezur të ulet në
 perëndim
 e rrëqethja e erës do fryjë mbi kodrat,
 ai do bierë në gjunjë mbi të zot, do nuhasë erën e
 njohur,
 përsëmbami do hingëllijë fort, do shkroftëj me hidhërim
 e do marrë rrugën me trokthin e lëndimit për shtëpi.
 Shumë e dua kalin tim të bukur, ai din të kthehet.
 Me turi do trokasë tek druri i portës, me shalën zbrazët,
 trokitje pa të zot, me flamurth dashurie në cullufet,
 pa këngë të butë mëllenjash në buzëqeshjet.
 Digat e dashurisë do çahen, do t'i përmytin shpirtërat.
 Edhe Diellit do t'i dhembë, i pikëlluar do ulet, çdo ditë i
 pikëlluar,
 do t'ia përkëdhelë ballin dhe krifën kalit tim të bukur,
 që edhe larg kur ngelet, me shalën zbrazët
 din ta gjejë rrugën për në shtëpi.

Ç'ËSHTË KJO QETËSI?

Ç'është kjo qetësi, kjo ëndërr e keqe?
 Merre fyellin vëlla, na gëzo, ose na jep ca trazirë lajmesh.
 Nëse fyellin s'e gjen dhe lajme s'ka
 thërrit, qaj, dënesu për një që aq shumë e deshe dhe e
 humbe.



TAIP SULKO

Shpirtëra
të arratisur

Tregim

Nëse shkretëtirë e drunjtë të ka pushtuar e as qesh e as qan,
 merr një shkop e bieri dërrasave, edhe ato dinë të klithin.
 Ose më mirë lutu që të shkrepë ndonjë rrufe,
 ato ta shkundin qënien dhe aq mirë dinë t'i trembin korbat
 e qetësisë.

Ti po i ngre sytë lart dhe më jep shenjë se do ketë shi?!
 Le të jetë shi! Le të bierë i heshtur, apo me psherëtima si
 rrjedhje lotësh

Edhe muzikën e tij e dua, më pëlqen ta prek, të lagem i gjithi,
 E ashtu, duke u dridhur, duke qeshur, duke kënduar të
 ndjehem prapë i gjallë

E VOGLA IME!

T'i morën të gjitha lulet? Si harabelkë e vrarë ke rënë?
 Ngashërehu, e vogla ime! Hiqe peshën e helmit.
 Vetëm e lehtë do të fluturosh përsëri!

ËNDËRR

Hej, ti, me atë vizatim buzëqeshjeje si me laps vetëtime!
 Ty të bëzaj, të këlthas me sa mundem,
 Të thërras, zili e yjeve, ç'pret? Kthehu,
 eja, detin e trazuar të ankthit ta kthesh në përqaftim!

MARTESË ME KËMBËT PËRPJETË

Aty hyhet vetëm këmbëpërpjetë,
 shalët e kolme luhaten si pyllnajë.
 Dallojnë veçmas, si dëngje, vithet e rënda të eprores.
 Gratë mahnitëse, me këmbët lart,
 shkumë e qeshjeve përmyt gjithë shpirtërat.
 Këmbët përkulen hijshëm, hapen, atje çahen, flasin.
 Eprorja i kishte rruajtur shalët e trasha.
 Mos e tundni shumë bishtin, qortonte, bythët tuaja tregoni.
 Këtë këngë e dinte mirë, e këndoi gjithë kohën në martesë.

NJË FLAMUR I HUAJ

Një flamur i huaj më vërvitet para hundëve
 Nuk është as i pari, që e kam në zemër,
 as i dyti, që e kam hedhur supeve.
 Është flamur i huaj, veten kërkon brenda meje,
 S'do të ikë, loz me mua, ma vërvit flladitjen
 si një toreador që ia valëvit cohën e kuqe zemërimit të demit.
 Mos pret që të nxjerr shkrepën e ta djeg?
 Ah, mor i mjerë, valëzbrazët, unë jam gjethe, fije bari.
 Vetëm kam frikë se nxehem, digjem, marr flakë
 e me flakë do ta përqafoj shtizën tënde, valëvitjet e tua.

YJET DHE DASHURIA

Yjet ishin larg, por dashuria ime ishte me ta,
 Edhe kur mendimet u tretën, si re të harruara,
 si shuarje e drithërimave ndër gjethe.
 Edhe kotjet e mbrame të Diellit mbi det ikën,
 edhe hijet e tingujve të lareshës në pyll.
 Të gjitha u tretën, si jehonë kënge që shargon larg,
 pëshpërimë gjetesh që kurrë s'u bë shpirt...
 Vetëm dashuria ngeli me ta,
 deri në fund, gjersa mori po ato drithërima, si ata, si yjet,
 që duke u djegur, duke ikur, mbjellin më shumë dritë

POEZIA

Mos e përmba zemrën, kur dashuron si e çmendur,
 kur don të dalë rrugëve lakuriq.
 Vargjet ndonjëherë do të rrinë në qafë, si zinxhirë të rëndë,
 derisa të merren këmbët, të ndjesh se je i dehur.
 Vetëm kur je ajër të beson,
 kur e thith sa herë merr frymë, mbase do ta kesh të dashur.
 Si ti, si një foshnje, ajo ngjizet nga dashuria,
 kur rritet është vajzë e bukur
 pret të mbledhësh trëndafila të kuq në buzët e saj të bukura
 dhe mos e pengosh zemrën të dalë rrugëve lakuriq.

PREDHA E LULEVE, E SHPRESËS DHE PRANVERËS

Mos ai nuk është lindur as nga trupi, as nga shpirti?
 Mos është plumb, predhë e një shtjelle zjarri?
 Shtrëngatë zërash, marrëzi gjetesh në erë
 Copëra të bardha qeshesh që ndjekin shtrëngatën?
 Çdo bëhet? Ku do qëllojë ajo predhë stuhie?
 Askush s'e di! Si të gjithë, kryet kam ulur e lutem.
 Përreth hovet uturima fishkëllenjese,
 S'i heq dot sytë nga flurudha me tymra, erë dhe qeshje.
 Ku do godasë? Kë do qëllojë?
 Ah, o Zot, qoftë predhë e luleve, e shpresës dhe pranverës!


SHPIRTËRA TË ARRATISUR

Miku im, ne të dy jemi ushtarë të heshtjes,
 unë ruaj i heshtur, ti fshin i heshtur. Kafënë e hidhur
 e pijmë në heshtje në qetësinë e trishtë të katit të poshtëm,
 ku na merr malli për ato që s'flasin,
 për re të trembura, pemë të prera,
 për një grua që ecën ndanë rrugë e këndon.
 Në heshtje pijmë kafe të hidhur dhe vështrijmë nga dritarja
 fluturimet gri të guguftuve që vërviten si gjethe të heshtura
 në qiell
 me përhedhje të ndritura, si ftesa të ardhura nga larg.

KËNGA QË E PUSHTON MBRËMJEN

Shikimi im si zog i etur zhytet e humb
 në mëngjesin kaltërosh të syve të tu të mëdhenj.
 Goja ime synon buzët e tua të mbushura,
 pakëz të hapura, si trëndafil,
 ngaldim i liqenit, kur Dielli hedh me mijëra copa
 diejsh mbi të.
 S'duam që buzët tona të digjen,
 të shkumbosen nga pritja.
 Lëshohemi në krahët e frymës së njëri-tjetrit.
 Dorëzohemi tek ajo që veç me një prekje magjepsëse,
 na kthen në ajër, në hare të tejpashme që s'prishet.
 Buzët e tua po shkruajnë poezinë e jetës time.
 Një këngë që ende s'është thënë
 po shkruaj dhe unë mbi këtë fushë trëndafilash.
 Të uth në qafë, e ndjej rrahjen ftuese të damarëve të tu.
 Kurrë nuk më ka pushtuar një trup kaq i bukur sa i yti.
 Kurrë nuk e kam vënë gjuhën në thimka kaq të etura për uthje.
 Kurrë s'jam gjendur kaq pranë një gjeratoreje bukurie,
 si lëmimi i ndritshëm i barkut tënd,
 si ndemja kaq ftuese të kofshëve të tua të mbushura.
 S'e di kur ka filluar kjo ëndërr,
 më ngjan vetja i pavdekshëm kur jam me ty.
 Puthemi në buzë dhe na përfshin flaka që brof prej së thelli,
 Të shikoj në kaltërsinë e syve dhe bëhem i tejdukshëm si ata,
 Edhe i tokës jam, edhe asaj që është frymë mbi lulet.
 Tek mëngjesi dhe mbrëmja, tek fëshfërima e gjetes,
 tek kënga e zogut të fshehur, tek hapësira e paanë,
 tek doçkat dhe buzët e tua zbuloj një qëllim të madh.
 Kurrë s'do jem më si më parë,
 s'e di si do duroj të eci si njeri.
 Jam bir i magjisë tënde këtej e tutje.
 Emrin ma ver ti, largoji pak buzët e mbushura dhe thuaje.
 Unë aty i kam sytë, tek ai trëndafil pak i hapur.
 Me atë emër do rilindem, me atë emër dua të vdes!

Karikaturë nga Arben Mexsi



Ecja pothuajse gjithmonë e tradhton Ecmoshën e njeriut. Kur është i vogël, ecën gjithë shend e kërshëri; ngrihet majë gishtave herë pas here, për të parë diçka që i fshihet prej shtatit. Zakonisht, askush nuk është kundër, derisa shtati i tij rritet në një metër e gjysmë. Pas kësaj, për një çast, ecja bëhet paksa rrugaçerore dhe arrogante, ose anasjelltas, e shtruar, me një përkulje të mezidukshme përpara. Kjo, sigurisht, nuk u pëlqen të gjithëve, madje u ngjall edhe frikë kalimtarëve: ku i dihet se çfarë mund të bëjë një njeri me një ecje të tillë?! E më pas, varet nga rasti. Disa ecin drejt për njëzet vjet, të tjerë paksa anash; kjo tashmë varet nga qëndrimi ndaj jetës dhe shkalla e frikës. Megjithatë, ky rregull vlen vetëm kur ka dritë gjatë njëzetekatërorëshit. Natën mund të ecësh i shkëputur nga ecja e ditës dhe nga mosha. Nata shpengon. Sidomos nata mes shtatëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë shtatorit.

Zhurmat e hapave në këtë natë shtatori të vitit 2011 vinin si nga "Grushevski", si nga "Zelena", si nga "Fjodorovi", si nga "Zamarstinovska", ashtu edhe nga ana e parkut "Strijski", në pemët e të cilët prej kohësh kalojnë natën re sorrash të majme, që ditën denden në vendgrumbullimin e plehrave të qytetit pranë fshatit Griboviçi.

Këta ishin hapa "solo" njerëzish që ecnin më vete, të cilët kurrë, as në kohërat e sovjetizmit të përjetshëm, nuk kishin ditur të marshonin me hap rreshtor. Të guxonte ndonjë djalosh tamburist t'ua vinte në rregull hapin, do të merrte menjëherë "lëndime të lehta trupore". Për "lëndime të rënda trupore" këta njerëz ishin pozitivisht të paafte. Edhe nëse merrnin vesh se "djaloshi tamburist", veçse tashmë në një kuptim tjetër, jo fjalë për fjalë, ishte ndonjë nga të sapopranuarit në rrethin e tyre të ngushtë.

Në fakt, rrethi i ngushtë vetëm së fundmi ishte bërë vërtet i ngushtë. Më parë, nja njëzet e pesë a tridhjetë vite të shkuara, ai numëronte ende mbi pesëdhjetë veta dhe në mesin e çdo shtatori shtohesh ndjeshëm, duke u mbushur me bashkëmendimtarë që vinin me autostop, me trena apo që thjesht mbërrinin në këmbë.

Pranë manastirit të Shën Alfonsit të provincës së Urdhrit të Shpëtimtarit më të Shenjtë, hapat e një këmbësori u dëgjuan paksa me nervozizëm. Ndihej që ai po nxitonte. Rruga "Zamarstinovska", përgjatë së cilës po rrendte, mund të ishte zgjatuar dikur me krahun e saj prej tulle deri në Brjuhoviçi, por kushedi pse nuk e kishte bërë këtë. Gjatësinë e saj mund ta kishin zili edhe bulevardet e Parisit dhe po të ndahej në copa të barabarta e të riorganizohej në linja që kryqëzohen pingul me njëra-tjetrën, do të dilte një qytezë tipike gjermane dhe me një histori të lavdishme.

Sepse në të, në "Zamarstinovska", ç'nuk ka ndodhur në jetën e saj të gjatë, e që ende vazhdon. Rrugët jetojnë gjatë, u mbijetojnë njerëzve që i popullojnë, brez pas brezi. Në rrugën "Zamarstinovska" gjithnjë janë lutur shumë, kanë prodhuar e pirë vodka dhe likere; në arkivin e zyrës rajonale të shpërndarjes ruheshin filmat dhe menjëherë aty pranë ata shfaqeshin në kinemanë "Taras Shevçenko"; aty mësonin të mbillnin pemë e të rrisnin perime, mësonin të drejtonin makinën, madje edhe të mjekonin policë të sëmurë e të plagosur. Në fakt, ata vazhdojnë të mjekohen në këtë rrugë edhe sot. Edhe i mjekojnë, edhe i përcjellin me meshë në kapelën pranë spitalit ata që s'ia dolën të kthehen "në formacion". Gjithçka duhet të jetë sipas rregullave dhe çdo lëvizje duhet të mbajë në vete shenjën e një përfundimi të ardhshëm; ashtu si çdo fjalë, sado presje të ketë, është e detyruar të përfundojë me pikë, me trepikësh ose me ndonjë shenjë ndalese më emocionale.



ANDREJ KURKOV

Turneu i Xhimi Hendriksit në Lviv

Fragment nga romani

Ky këmbësor, i cili kishte jetuar në skajin tjetër të kësaj rruge gjatë gjithë viteve të tij mjaft të mbushura me ngjarje, e mbante "Zamarstinovskën" me vete kudo që shkonte. Ai e ndiente atë, ashtu siç i ndien një shofer i mirë përmasat e makinës së tij, pa i kushtuar vëmendje kushedi, duke e ditur paraprakisht se në cilën portë hyn e në cilën jo. Fytyra e tij ishte e mbuluar nga një kapelë lëkure me strehë të gjerë, ngjyrëkafë. Prej saj, mbi supe i binin flokët e gjatë me thinja. Pjesët e tjera përshkruese mund edhe të lihen mënjanë. Përjashtim bëjnë çizmet e larta, që ngjanin ushtarake, të lidhura fort, prodhim vendas, një model i sigurt për ecje, i njohur prej pesëdhjetë vjetësh si "shkelëset e mutit". Kinezët ende nuk kanë mësuar ta prodhojnë këtë model. Atyre u duket se kërkon shumë gomë të fortë e cilësore dhe mjaft lëkurë të trashë e të ashpër. Bastioni i fundit i prodhimit të "shkelëseve të mutit" mbeten ende Bjellorusia dhe Transnistria. Por edhe në Lviv kanë mbetur ende ustallarë që jo vetëm janë të zotë ta shpojnë me dorë, me gjilpërë të madhe, një copë të trashë lëkure derri, por edhe ta lidhin pjesën e sipërme të këpucës me të poshtmen aq fort, sa ç'nuk arriti Ushtria Sovjetike ta lidhte më 1939-n Ukrainën Perëndimore me atë Lindore. Madje, vetëm nga zhurma e hapave, një këpucar i mirë e kupton gjithmonë: a ka bërë hile prodhuesi apo e ka punuar këpucën me ndërjegje. Sepse të dyja shollat duhet të tingëllojnë në harmoni. Dhe në Lviv, në qytetin e kulturës së hollë të tingullit, kjo ka rëndësi të veçantë. Nuk shkon që taka e majtë të kërcasë mbi kalldrëm si e majtë, kurse e djathta si e djathtë! Ato duhet të tingëllojnë si çift. Si një çift i dashuruar me rrugën.

Në xhepin e këmbësorit ra celulari.

- Alik, je larg? - pyeti zëri i një miku të vjetër.

- Nuk jemi gjermanë, s'kemi pse ngutemi, - u përgjigj këmbësori. - Po ti, ku je?

- Në rrugën "Liçakovska".

- Kuptova, - tha Aliku. - Erdha.

Kur Aliku arriti te portat e mbyllura të varrezave të Liçakovit, nga poshtë pemëve që rriteshin aty pranë dolën rreth dhjetë veta. Dolën pa u ngutur, e rrethuan ndërsa ai po nxirrte çelësin nga xhepi për të hapur drynin e portës.

Çelësi sapo kishte rrëshqitur në bravë kur pas shpinës së të mbledhurve, duke vlarë veshin, u dëgjuan hapat "jo çift". Edhe Aliku ktheu kokën dhe pa një burrë dy metra të gjatë, paksa të kërrusur. Flokët e tij të gjatë e gështenj sikur thoshin: "Jam nga tanët."

- Labas vakaras! - pëshpëriti me zë të ulët. - Më falni, për pak u vonova!

- Audrius?! - shprehu habinë me zë Aliku, duke e matur gjigantim me sy nga koka deri te këpucët me majë. - Me tren?

- Po, përmes Kievit, - pohoi ai me kokë. Të gjithë u turrën ta përqafonin Audriusin.

- Ke munguar prej kohësh, - tha Aliku, që u kthye drejt portës, rrotulloi çelësin dhe harku i çeliktë i drynit doli nga vendi.

Ata ecën përmes varrezës në heshtje. Në majë të një kodre, vëzhguan vendin përreth. Aliku u bëri shenjë të gjithëve të afroreshin dhe u priu njëri pas tjetrit mes varreve dhe kangjellave.

Ata ndaluan pranë një kryqi të hekurit, që dukej sikur ishte fshehur qëllimisht pas trungut të një peme të vjetër dhe dy shkurreve të harlisura së tepërmi. Këtu nuk kishte kangjella. Njerëzit e mbledhur, flokëgjatë e të burrëruar, u grumbulluan rreth varrit modest.

As emri, as mbiemri nuk lexoheshin në pllakën e ndryshkur, të ngjitur në qendër të kryqit. Njëri nga grupi u ul galiç para tij, me gjunjtë që i nguleshin në buzë të dheut të varrit, dhe nxori një qese plastike nga xhepi i xhakëtës. E shpalosi. Vendosi në bar një kuti të vogël me bojë të bardhë. Një penel iu shfaq në dorë dhe i sigurt shkroi mbi pllakë gërmat e bardha: "Jimi Hendrix 1942-1970".

Një degëz krisi në heshtjen ku nuk pipëtinte era. Diku shumë afër. Aliku mprehu veshët. Krisma u përsërit. Gjethet e rena fëshfërinin me trishtim në këmbët

e një të huaji që po afrohej. "Roja?" - mendoi Aliku.

Atyre iu afrua një burrë me shtat mesatar e me kapele, i cili po ndiqte të njëjtin shteg si ata, mes varreve dhe kangjellave. Thjesht një i huaj i zakonshëm. Të mbledhurit te varri e vështruan tek po afrohej me shpërfillje. Kureshtja është lojë për të rinjtë, dhe të gjithë i kishin kaluar të pesëdhjetat.

- Më falni, ju lutem, - tha i porsaardhuri me zërin e prerë si të një spikeri lajmesh. Ai mbajti një distancë respekti. - Gjithmonë kam dashur... kam dashur të them diçka...

- Fol, - tha Aliku, qetësisht.

- Nuk po më njihni? - pyeti burri, duke hequr kapelën.

- Flisni, - i dha leje Aliku, me një zë të qetë.

- Nuk më njihni? - përsëdyti burri dhe hoqi kapelën nga koka.

Fytyra e të porsaardhurit, pavarësisht orës së natës, ndriçohej mjaftueshëm nga rrezet e hënës. Por ajo fytyrë, megjithëse e ndriçuar, nuk i thoshte asgjë Alikut. Një fytyrë e zakonshme, nga ato që bota i ka prodhuar me miliarda: veshë, hundë, sy - gjithçka sipas një standardi të vetëm shtetëror (GOST), pa defekte, pa ndonjë shenjë të veçantë që të linte mbresë apo të binte në sy.

Aliku tundi kokën në shenjë mohimi.

- Si jo, - zëri i njeriut me flokë të prerë shkurt u tingëlloi me njëfarë hidhërimi. - Kemi qenë afër. Kundër dëshirës suaj, sigurisht. Unë jam kapiteni i KGB-së, Rjabcevi.

- Oh, - i shpëtoi Alikut dhe ai picërroi sytë, duke e vështruar ende në fytyrë bashkëbiseduesin e papritur. - Po këtu çfarë bëni, kapiten? Tani, me siguri, jeni kapiten në pension?

- Kapiten rezervë, - Rjabcevi e korrigjoi Alikun. - Megjithëse, është e njëjta gjë... Doja të kërkoja falje... Dhe të them diçka.

- E po, kërkon falje! - ngriti supet Aliku. - Vetëm shpejt. Nuk jemi mbledhur këtu për t'ju dëgjuar juve, - dhe i bëri me kokë nga kryqi i hekurt me mbishkrimin e bardhë të freskët.

Kapiteni vuri kapelën, kroi paksa fytin.

- Në përgjithësi... më falni, shokë! Për mua... edhe për Mezencevin. E kam varrosur para ca kohësh... kancer i fshikëzës së urinës...

- E kemi për detyrë ta dëgjojmë? - pyeti i irrituar Penzeli, një burrë i fuqishëm, me flokë dhe mjekër të gjatë, i veshur me xhakëtë lëkure, që ngjante më shumë me një motorist sesa me hipi.

- Mirë, le ta dëgjojmë një minutë, - psherëtiu Aliku. - Eja, kapiten, bjeri shkurt! Djemtë po e humbasin durimin!

- Nëse flas shkurt, - filloi Rjabcevi më ngadalë dhe jo fort qartë. - Fillimisht, ju faleminderit që atëherë, tridhjetë e pesë vjet më parë, më njohët me Jimi Hendrixin! Ai ma përmbysi jetën. Për shkak të tij humba interesin për karrierën. Prandaj jam kapiten e jo kolonel... Dhe pikërisht për këtë arsye, në vitin 1978, së bashku me djemtë arritëm të siguronim për ju një pjesë nga trupi i tij; dorën e tij. Që Jimi të kishte një varr edhe këtu, në Lviv dhe që ju të kishit ku ta kujtonit përvjetorin e vdekjes së tij!

- Çfarë?! - sytë e Alikut u rrumbullakosën. - Po dorën e tij e sollën djemtë nga Baltiku dhe atyre iu ndihmoi diaspora lituane në SHBA! Thuaj, Audrius! E mban mend!

- Po, - pohoi Audriusi me kokë. - I mbaj mend ata djemtë. Jonas, Kjustutis, Ramunas...

- Sigurisht që ata jua dorëzuan dorën, por atyre ua dërguan njerëzit tanë nga Shtetet e Bashkuara, - kapiteni Rjabcev e shqiptonte sërish fjalën me vendosmëri dhe me kthjelltësi ushtarake, sikur jepet një udhëzim ose një urdhër me gojë.

- Moska nuk e dinte këtë. Ne, unë dhe Mezenzevi i ndjerë, e shpikëm këtu, në Lviv, operacionin special në SHBA për ekzumimin e pjesshëm të trupit të tij, ilegalisht. Pagesën e bëri Moska, por po ta kishin marrë vesh të gjithë të vërtetën, sot nuk do të isha këtu duke folur me ju...

Dikush nga dëgjuesit lëshoi një psherëtim të rëndë. Kapiteni e kërkoi me sy atë që psherëtiu dhe bëri një pauzë.

- Po jua tregoj këtë që të mos mbani mëri ndaj nesh. Ne nuk ishim bulldogë budallenj. Unë mund t'jua tregoj biografinë e Jimi Hendrix-it vit për vit që tani, po të doni. Mund t'jua recitoj tekstet e këngëve të tij në origjinal, përmendsh. Të këndo, s'mundem, më falni! Prindërit e mi nuk kishin para as për piano, as për kitarë. Në fëmijëri, kisha vetëm një instrument muzikor: një bilbil! Jam me fat që s'u bëra milic!

- Tani m'u kujtove, - tha Aliku me mendueshëm. - Nëse ajo që thua është e vërtetë, atëherë na duhet të gjejmë një tryezë, rreth të cilës ne të gjithë, - ai i përshkroi me dorë të mbledhurit, - mund të ulemi. Dhe na duhet të pimë e të kujtojmë më hollësisht të shkuarën.

- Gjithçka që thashë është e vërtetë, - tha kapiteni Rjabcevi. - Nuk kam pse t'ju gënjej. Nuk jam më në shërbim. Kanë kaluar pesëmbëdhjetë vjet që nuk jam më në shërbim.

Aliku shikoi poshtë, në këmbët e veta, heshti pak. Pastaj ia hodhi sytë sërish kryqit me mbishkrimin e freskët të bardhë.

- Jimi, po më dëgjon? - tha ai, duke iu drejtuar kryqit. - Përsëri organet janë futur mes nesh. Por ne nuk do ta rishqyrtojmë marrëdhënien tonë me ty. Nuk të kemi tradhtuar, as para 18 shtatorit 1970, as më pas. Nuk ka pasur vit që të mos jemi mbledhur këtu dhe të mos e kemi ndriçuar varrin tënd. Edhe atëherë kur donin me çdo kusht të na pengonin!

Diku aty afër, me një ulërimë të fortë, kaloi një ambulancë. Sirena u fashit gradualisht.

- E po, çfarë thoni, shokë? - tha Aliku me ton ftuesi. - Do ta filloj unë!

Ai nxori nga xhepi një fletë me konvalutë që përmbante luminal, mori një tabletë, u ul pranë varrit, e vendosi tabletën e bardhë mbi tokë dhe pasi priti një minutë, e shtyu me gishtin tregues thellë, nën rrënjët e barit.

- Fli i qetë, - pëshpëriti dhe u ngrit në këmbë.

Kapiteni bëri një hap pas, sikur të mos donte të pengonte. Por mbeti aty, i palëvizur, duke vëzhguar gjithçka.

Pranë varrit u ul në gjunjë burri me mjekër, Penzeli dhe në pëllëmbë kishte të përgatitur një tabletë gjumi. Rituali u përsërit. Më pas, u ul edhe Audriusi pranë varrit. Pëshpëriti diçka në lituanisht. Pastaj edhe ai e shtyu me gishtin tregues tabletën e bardhë në dheun mbi varr.

Qielli mbi varrezat e "Liçakovskës" u errësua. Filloi një shi i imët që binte mbi gjethet ende të parëna të pemëve dhe shkurreve. Gjethet filluan të fëshfërijnë, të pëshpëritin, duke sjellë me vete një ndjesi rreziku të fshehur.

Aliku hodhi sytë lart.

- Si një vit më parë, - tha ai. - Është koha...

U nisën përsëri drejt daljes, duke zbritur nga kodra, anashkaluan varret dhe rrethimet, kriprat dhe përmendoret.

Sytë e Alikut kapën në errësirë një kryq të madh prej guri me një Krisht të kryqëzuar. Fytyra e Krishtit, për një çast, iu duk Alikut e lumtur.

Kur portat ishin mbyllur me dry, papritmas përballë Alikut u shfaq kapiten Rjabcevi. Ishte një kokë më i shkurtër se Aliku.

- E po, çuna, a shkojmë të kërkojmë një tryezë të madhe? - pyeti Aliku dhe pa pritur

përgjigje, u kthye djathtas dhe nisi të ecte përgjatë rrethimit prej tulle dhe hekuri të varrezave. Të tjerët e ndoqën pas. I fundit, si gjithmonë, ishte kapiteni.

Shpejt rrethimi i varrezave mbeti pas. Në të dyja anët e rrugës tashmë shtriheshin shtëpitë e përgjumura të rrugës "Meçnikov". Aliku ndjeu papritur një dobësi në këmbë. Ishte ai që po ecte përpara, ai që po u tregonte rrugën miqve të vjetër - të cilët dikur e kishin marrë për në komisariatit e ROVD-së - dhe ndërkohë mendonte se atje, përpara, nuk kishte asnjë tryezë të madhe të veçantë. Por ajo tryezë i duhej aq shumë tani. Dikur, në kohët e këqija jo aq të vjetra të sovjetëve, edhe një tryezë e vogël katrore kuzhine, e rrethuar me stola, dukej e madhe. Në ato kohë edhe ato tryeza kishin një "të kaluar të dyfishtë": një shekull tjetër dhe një shtet tjetër. Tani ta donte zemra një karrige të mirëfilltë; siç duket, me kalimin e viteve, të ndenjurat kishin nisur të kërkonin butësi dhe rehati. Dhe butësia e rehatia nuk gjenden në çdo hap.

- Ndoshta te "Zhorzhi"? - fryma e ngrohtë e mikut ia mbushi veshin. - Atje është Gjeniku rojë, do të na lërë të hymë...

Aliku nuk e ngadalësoi hapin dhe e pa vëngër atë që foli.

- Jo, më mirë... - nisi të fliste dhe ndali sakaq. Aliku nuk arriti të propozonte diçka të vetën. Papritur i dhembti koka dhe dobësia në këmbë u ndie edhe më fort. Para syve, ajri i errët u trazua, sikur dikush të kishte lëshuar në të një shtëllungë tymi cigaresh.

- Po bie mjegulla, - tha kapiten Rjabcevi, që u shfaq në të djathtë, midis Alikut dhe

murit të shtëpisë. - Është mjegull e ulët, - shtoi ai me zërin e dikujt që e di mirë se ç'thottë. - Do të na përfshijë tani... Më mirë të ndalemi.

Aliku ndaloi. U ndalën edhe të tjerët. Nën tabelën e zbehtë të ndriçuar me llambë të vogël, ku shkruhej "Liçakovska 84-A", errësira nisi të mbushej me qumështin ajror të mjegullës. Në gojë, në gjuhë e në qiellzë Aliku ndjeu një ëmbëlsi të lehtë.

"Fabrika 'Svitoç'?" - mendoi Aliku. - "Kjo mjegull vjen qartazi andej... mbetje ajrore të çokollatës me qumësht?" - dhe qeshi me ironi me mendimet e tij prej kalamani.

Ia nguli sytë tabelës së shtëpisë që po zhdukej para syve të tij.

- Alik, unë do të iki, - u dëgjua zëri i kapiten Rjabcevit. - Herës tjetër.

- Herës tjetër, kur? - pyeti Aliku.

- Ti s'ke ndërruar shtëpi asnjëherë, - foli miqësisht kapiteni. - Adresën tënde e di që nga vitet shtatëdhjetë. Do të kaloj, do të t'i tregoj të gjitha. Mbase që nesër.

Çunat u përshëndetën dhe u tretën në atë mjegull të papritur nate. Pranë mbeti vetëm Audriusi; ai rrinte në këmbë, thuafe duke prekur supin e Alikut.

- Eja tek unë, - i propozoi Aliku mikut të vet lituan. - Kam pak balsam.

- Edhe unë kam, dy shishe "Trekëndëshi i nëntëshave", - ia ktheu ai.

Aliku nxori celularin. Formoi numrin e një kompanie taksish, por askush nuk iu përgjigj në qendrën e thirrjeve. E provoi një tjetër; e njëjta gjë. Dhe papritmas dëgjoji zhurmën e një motori. I kujtohej që po qëndronin afër rrugës. Me majën

e këpucës preku bordurën, u përqendrua nga drejtimi ku po u afrohej makina që ende nuk dukej, por dëgjohej. Doli në asfalt, duke ngritur që më parë dorën e djathtë.

Nga mjegulla prej qumështi dolën dy drita të verdha, krejt pranë. Aliku bëri edhe një hap që të dukej më mirë. Dhe pikërisht atëherë rënkoji frenimi dhe makina rrëshqiti mbi kalldrëmin e lagur drejt Alikut. E verdha e djathtë e fenerit e goditi paksa në gju dhe ai u spraps, tundi krahët duke u munduar të gjente baraspeshën dhe të qëndronte në këmbë, por nuk u mbajti dot.

Makina u ndal. Brenda në kabinë u ndez drita dhe në atë ndriçim Aliku pa dy fytyra të trembura. Njëra i përkiste një djali të ri, ndoshta rreth të tridhjetave dhe tjetra një burri nja dhjetë vjet më të madh. Maja e hundës dhe mustaqet e rregulluara me kujdes të pasagjerit më të moshuar e tregonin si të huaj, ndoshta polak.

I riu hapi derën, doli jashtë. Duart po i dridheshin. Ishte shokuar.

- Jeni mirë? - e pyeti ai Alikun, që tashmë ishte ngritur në këmbë dhe fërkonte gjurin e mavijosur.

- Asgjë, asgjë, - përsëriste Aliku. - Audrius, je aty? - u kthye ai.

- Këtu jam, - u përgjigj shoku i tij, duke iu afruar më shumë makinës.

- Ndoshta doni t'ju çojmë diku? - pyeti ende me zë të dridhur shoferi i "Opelit" të vjetër.

- Pikërisht, po përpqesha të kapja një makinë, që të shkoja, - tha Aliku disi i shpërqendruar. - Në "Zamarstinovska", deri në fund...

- Hipni! - tha shoferi duke hapur derën e pasme dhe tashmë në sytë ende të trembur nuk mungonte njëfarë kurioziteti teksa e shikonte këtë dyshe miqsh flokëgjatë e të moshuar.

Makina u nis dhe filloi të lëvizte përmes qumështit të mjegullës, si një nëndetëse në ujëra të errëta, të thella dhe të padepërtueshme.

- Ju, rastësisht, nuk jeni hipi? - i pyeti shoferi i ri pasagjerët e papritur.

- Pse "rastësisht"? Jemi hipi krejt jorastësorë! - iu përgjigj prerazi Aliku.

- Kam parë një film për ju! - vazhdoi bisedën shoferi.

- Për ne? - Aliku dhe Audriusi u panë me habi.

- Për ne nuk ka film, - tha Audriusi me një theks të butë lituan.

- Jo për ju, personalisht, por për hipitë!

- e korrigoj mendimin e vet shoferi. - Për ata hipitë amerikanë që u shpërngulën në Indi dhe ndërtuan diçka si qytet për një jetë të lumtur! Ndoshta ai qytet tani është zhdukur krejt! Kjo ka ndodhur kushedi se kur!

- Po kur paska qenë kjo?! - përsëriti thuafe i indinjuar Audriusi.

- S'ka kaluar dhe aq kohë!

- Çfarë, kujton se jemi tetëdhjetë vjeç? Kemi ende jetë përpara! Na duhen edhe dhjetë a pesëmbëdhjetë vjet deri në pension, madje!

Shoferi tërhoqi kokën mes supeve dhe heshti, duke u përqendruar në rrugën që tashmë ishte mjegulluar deri në maksimum.

- Si mendon, a foli të vërtetën Rjabcevi? - Aliku pyeti Audriusin.


Audriusi ngriti supet. Nuk donte të përgjigjej dhe s'kishte ndonjë përgjigje të gatshme gjithsesi.

Udhëtuan rreth gjysmë ore dhe papritmas, në një kthjellim të beftë të mjegullës, u shfaqën trungjet e pishave dhe rrethimi i njohur i spitalit të policisë.


- Ja ku mbërritëm, - tha i lehtësuar shoferi. - Doni më tej?

- Jo, këtu afër e kemi tashmë, - Aliku pohoi me kokë.

Përktheu nga origjinali në rusisht: Bujar Hudhri



Të gjithë librat shqip nga Alblibris do t'i gjeni në panair!



VATRA CHICAGO PRESENTS

ALBANIAN BOOKFEST 2026

Join us for a cultural celebration of literature, language, and community!

★ Some of the Authors Present:

- Visar Zhiti
- Mirela Kanini
- Dr. Pashko Camaj
- Dr. Ernest Nasto

📅 **DATE:** April 18, 2026

📍 **5825 St. Charles Rd
Berkeley, IL 60163**

🕒 **TIME:** 10:00 AM – 6:00 PM

PAYMENT INFO: Zelle® | Cash

Hosted by **VATRA Chicago**